

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

STUDIMI I TRAFIKUT INTERDOMAIN BAZUAR NË PROTOKOLLIN BGP, RAST STUDIMOR NË SHQIPËRI

Ledina Karteri Hoxha

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
`Informatikë, Matematikë & Statistikë` me profil `Menaxhim i sistemeve të
Informacionit`, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.As Anni Dasho

Numri i fjalëve: 61655

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se studimi është punë origjinale e imja. Siguroj që kam dhënë kontributin tim të plotë në të gjithë punimin në përdorimin e ideve, të të dhënave, ose të gjuhës së një subjekti tjetër duke kryer citimet dhe referencat specifike.

ABSTRAKT

Border Gateway Protocol (BGP) është protokoll i aktual i rrugëzimit inter-domain i aplikuar në Internet. BGP, fillimisht një protokoll i thjeshtë path-vektor, është ndryshuar përherë në mënyrë rritëse me kalimin e kohës përmes një numri të mekanizmave për mbështetjen e politikave, duke shtuar ndjeshëm kompleksitetin. Edhe pse performanca e Border Gateway Protocol është pranuar gjithnjë, përmasat, heterogjeniteti dhe ndryshueshmëria që e karakterizojnë Internetin sot, përbëjnë një sfidë për ruajtjen e cilësisë së shërbimit (QoS) duke vendosur kërkesa gjithnjë e në rritje për BGP në trafikun e shpërndarjes së paketave të të dhënave. Analizat e fundit të sigurisë të marra nga komuniteti i kërkimit kanë raportuar qartësisht karakteristikat e pakënaqëshme të BGP si integriteti i ulët dhe konvergjenca e ngadaltë përmes analizave teorike dhe matjeve empirike. Kështu është evidentuar që infrastruktura e rrugëzimit të internetit është mjaft e cënueshme. Keqkonfigurimi i ruterave shpeshherë sjell në injektimin e tabelave të mëdha të rrugëzimit në sistemin e rrugëzimit BGP. Në këtë punim shohim mekanizmat e detajuar të përgjigjes së ruterave kundrejt tabelave të mëdha të rrugëzimit. Disa prej ruterave shfaqin oshilime që kanë potencial për të shkaktuar dështim kaskadë. Disa të tjerë kërkojnë ndërhyrjen e operatorëve për tu rikuperuar. Po ashtu vërejmë se mekanizmat e kontrollit të resurseve të aplikuara janë pjesërisht të suksesshme në zbutjen e impaktit të tabelave të mëdha të rrugëzimit. Gjithashtu dizanji dhe kudogjendja e BGP ka frustruar përpjekjet e mëparshme për sigurimin e rrugëzimit interdomain. Simulimet e kryera lejojnë eksperimente më realiste e fleksibël se metodat teorike dhe kosto më të ulët se matjet në ambjente reale. Në punim përshkruhen teorikisht karakteristikat dhe problemet që lidhen me BGP dhe gjithashtu pritshmëritë e përdoruesve të sotëm të Internetit ndaj aplikacioneve në kohë reale (psh. Voice over IP). Evidentohen dhe implementohen elementët për të krijuar një ambjent të integruar simulimi për vlerësimin e ndikimit të konvergjencës së ngadaltë të BGP në këto aplikacione. Për të kënaqur kërkesat e këtyre aplikacioneve dhe për të përfutur cilësinë e shërbimit të kushtëzuar nga SLAs, ISP të ndryshme mbështeten në një proces të quajtur Inxhinierim Trafiku (Traffic Engineering, TE). Ky i fundit mbulon vlerësimin dhe përmirësimin e performancës së rrjetave operacionale. Vëmë re se ende nuk është gjetur një balancim i përshtatshëm midis sigurisë komprehsive dhe koston së zhvillimit. Së fundmi vlerësohet saktësia e ambjentit të krijuar përmes disa simulimeve në përmasa të vogla por që modelojnë pjesë të Internetit në ditët e sotme. Së fundmi pasqyrojmë rezultatet e anketës së zhvilluar ku reflektohen vlerësimet e përdoruesve të internetit ndaj ISP-ve operuese në vendin tonë. Në anketë studiohen qëndrimet që mbajnë përdoruesit e internetit ndaj QoS së ISP-ve shqiptare duke evidentuar pikët e forta të tyre dhe pakënaqësitë ku konsistojnë për secilin ofrues interneti duke u shërbyer si një udhërrëfyes për përmirësime të mëtejshme.

Fjalë-kyçe: AS, BGP, Traffic Engineering, QoS, Simulim, NS2.

ABSTRACT

“The study of interdomain traffic based on BGP protocol”

Border Gateway Protocol (BGP) is the actual routing protocol applied in the cross-domain Internet. BGP, originally a simple protocol path-vector, changes always so incrementally over time through a number of mechanisms to support policy and complexity. Although it is agreed that the performance of Border Gateway Protocol, the size, the heterogeneity and variability that characterize the Internet today, constitute a challenge to maintain the quality of service (QoS) of the located demand ever increasing BGP traffic distribution package of the database. Recent analysis obtained by the security research community have reported clearly unsatisfactory features of BGP as low integrity and convergence slow through empirical measurements and theoretical analysis. Thus it is evident that the routing infrastructure of the Internet is vulnerable enough. Misconfiguration of routers often brings injecting billboards routing BGP routing system. In this paper, we see detailed response mechanisms SE routers versus large routing tables. Some routers exhibit oscillations that have the potential to cause failure cascade. Others call for the intervention of operators to recover. Also note that the mechanisms of control of resources applied are partially successful in mitigating the impact of large routing tables. Also design and ubiquity of BGP has frustrated previous attempts for providing interdomain routing. Completed simulations more realistic experiments allow flexible methods of theoretical and lower cost than measurements in real environments. The paper theoretically describes the characteristics and problems associated with BGP and also the expectations of today's Internet users to real-time applications (RP, Voice over IP). Also identified and implemented elements to create an integrated simulation environment impact assessment convergence BGP slower in these applications. To satisfy the requirements of these applications and quality of service obtained conditional on SLAs, different ISPs rely on a process called (Traffic Engineering, TE). The Last covers assessing and improving operational performance networking. We notice that it is still not find a suitable balance between security setting Se comprehensive and development. It used recently estimated that the environment created through several small scale simulations that model but part of the Internet nowadays. Finally we reflect the results of the survey conducted reflecting the attitudes that keep Internet users to ISPs operating in our country. The survey examines the attitudes that internet users have on QoS of Albanian ISPs, highlighting their strong points and dissatisfaction with each of the internet providers, serving as a guide for further improvements.

Keywords: AS, BGP, QoS, Simulation, NS2.

DEDIKIMI

Këtë punim ia dedikoj babait tim dhe djemve të mi.

FALENDERIME

Falenderoj pambarimisht udhëheqësen time Prof.As Anni Dasho për ndihmën e çmuar në këtë studim.

Gjithashtu kam falenderime të veçanta për vlerësuesen metodologjike Prof.As Mimoza Durrësi dhe oponenten Prof.Adriana Gjonaj që më kanë ndihmuar dhe inkurajuar në ecurinë e këtij studimi. Po ashtu gjej rastin të falenderoj koordinatoren dhe kolegët për përkrahjen në punimin tim. Sigurisht që një vend special zë familja ime të cilën e falenderoj pamasë (mamanë, vëllanë, bashkëshortin) për mbështetjen morale që asnjëherë nuk ma kanë kursyer. Një falenderim i rezervoj dhe mikeshave të mia që gjithnjë më kanë dhënë krahë për vijueshmërinë e këtij punimi.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Lista e figurave	8
Lista e tabelave	10
Kapitulli I	14
Hyrje.....	14
1.1 Përcaktimi i problemeve dhe nënproblemeve.....	15
1.2 Motivimi dhe kontributi i temës.....	18
1.3 Burimet e informacionit.....	20
1.4 Popullata dhe kampioni i studimit.....	21
1.5 Metodologjia.....	21
1.6 Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre.....	22
1.7 Modeli teorik.....	23
1.8 Organizimi i kapitujve.....	24
Kapitulli II	
Border Gateway Protocol.....	27
2.1 Hyrje.....	27
2.2 Rrugëzimi në Internet.....	28
2.3 BGP: Një protokoll për rrugëzimin “inter domain”.....	31
2.3.1 Karakteristikat e funksionimit të BGP.....	32
2.3.2 Rrugëzimi i BGP.....	34
2.3.3 Konvergjencia e BGP.....	36
2.3.4 Paqëndrueshmëritë e BGP.....	38
2.4 Menaxhimi i sesionit ndërmjet `çifteve`.....	41
2.4.1 Shkëmbimi i informacionit të rrugëzimit.....	42
2.4.2 Përpunimi dhe gjetja e rrugës.....	42
2.4.3 Zhvlerësimi i një rruge.....	43
2.4.4 Reflektimi i rrugës.....	44
2.4.5 Përfundime.....	44
Kapitulli III	
Modelimi i rrugëzimit të një ISP.....	47
3.1 Modelimi i një sistemi autonom.....	47
3.1.1 Përmbledhja e konfigurimit të routerave.....	48
3.1.2 Përfaqësimi i topologjisë.....	49
3.1.3 Rrugëzimi i të dhënave.....	49
3.2 Modeli GEANT 75.....	52
3.2.1 Statistikat e trafikut.....	52
3.2.2 Modeli GEANT.....	52
3.2.3 Topologjia.....	53
3.2.4 Rrugëzimi i të dhënave.....	56
3.2.5 Statistikat e trafikut.....	49
3.3 Karakterizimi i rrugëzimit.....	57
3.3.1 Rrugëzimi Intradomain.....	57

3.3.2	Rrugëzimi Interdomain	59
3.3.3	Skenarët Çka – nëse	61
3.3.4	Peering i optimizuar	61
3.3.5	Dështimet e linqeve dhe ruterave	65
3.3.6	Ndikimi në trafik	68
3.4	Teknika TE Interdomain aktuale	71
3.4.1	Intradomain Engineering Traffic (ITE).....	72
3.4.2	Zgjidhje të bazuara në IP.....	72
3.4.3	Dështimet e linqeve dhe ruterave	72
3.4.4	Interdomain Engineering Traffic	73
3.4.5	Kufizimet e arkitekturës së rrugëzimit të Internetit të tanishëm	74
3.4.6	Karakteristikat e trafikut interdomain	75
3.4.7	Inxhinierimi i trafikut i bazuar në BGP	77
3.4.8	Kontrolli i trafikut dales	78
3.4.9	Kontrolli i trafikut në hyrje	79
3.4.10	Përhapja e rrugëzimit të kontrolluar nga komuniteti (Community)	81
3.5	Diskutimi.....	82
3.5.1	Vlerësimi i AS-Path prepending.....	83
3.5.2	Modeli i vlerësimit.....	84
3.5.3	Rëndësia e rregullave tie-breaking	86
3.5.4	Vlerësimi i AS-Path prepending.....	88
3.6	Vlerësimi i Komuniteteve	92
3.7	Qasjet duke mos u mbështetur në tweaking BGP	96
3.8	Cooperative Engineering Traffic	97
3.8.1	Peerings Virtual	98
3.8.2	Arkitektura dhe protokolli.....	100
3.8.3	Advertisement i adresave VPC.....	101
3.8.4	Krijimi dhe heqja e Peerings Virtual	101
3.8.5	Shpërndarja e rrugëve Virtual Peering brenda fushës domain	102
3.8.6	Konsiderata të sigurisë	103
3.8.7	Vendosja.....	104
3.8.8	Forca	104
3.8.9	Vlerësimi	105
	<u>Kapitulli IV</u>	
	Voice Over IP – VOIP.....	124
4.1	Hyrje	124
4.2	Pritshmëria e ndaj aplikacioneve VoIP në rrjet.....	126
4.3	Koduesit e zërit	128
4.4	Paketizimi	129
4.5	“Jitter buffer”	129
4.6	Matja e Cilësisë së VoIP	130
	<u>Kapitulli V</u>	
	Ambienti Eksperimental	133

5.1 Hyrje	133
5.2 Simulimet	134
5.2.1 Elementet e simulimit	134
5.2.2 Simulimet që varen nga koha	135
5.3 Simulimi i Rrjetit 2 (Network Simulator 2 – ns2)	135
5.3.1 Arkitektura e NS2	136
5.3.2 Direktoritë e ns2	137
5.3.3 Përdorimi i ns2	138
5.4 Modelimi i simulimit	140
5.5 Ndërtimi i modelit të rrjetit	141
5.5.1 Topologjia e rrjetit	142
5.5.2 Struktura njëdrejtimore e rrugëzimit ns2	143
5.6 Struktura njëdrejtimore e rrugëzimit ns2_BGP	145
5.6.1 Klasifikuesi IPV4.....	147
5.6.2 rtModule/BGP	147
5.6.3rtProtoBGP	147
5.6.4 TcpSockets	147
5.6.5 BGP_Timer	148
5.6.6 VecRoutes	149
5.6.6 VecRoutes	149
5.6.7 damp_reuse_timer.....	149
5.6.8 dampinfo	150
5.7 Gjeneratori i topologjisë GT-ITM.....	152
5.7.1 Modelimi i rrugëzimit	154
5.7.2 Ndërtimi I modelit të të dhënave	156
5.7.3 Gjendja e rrjetit dhe vlerësimi i performancës	156
5.7.4 Ndryshimet në model.....	156
5.8 Simulime dhe rezultate	157
5.8.1 Verifikimi i modelit të përzgjedhur të rrugëzimit	159
5.8.2 Simulimi i topologjisë Stub-Domain me trafik CBR	162
5.8.3 Rezultatet e simulimit	166
Kapitulli VI	
6.1 Realizimi dhe interpretimi i pyetësorit	168
6.2 Analiza e përgjigjeve për rastin e përdoruesve të cilët e konsiderojnë QoS në nivele maksimale në Shqipëri	178.
6.3. Analiza e përgjigjeve për rastin e përdoruesve të cilët e konsiderojnë QoS në nivele minimale në Shqipëri.....	199
Konkluzione	228
Bibliografia	238
Shtojca 1	242
Shtojca 2	244
Shtojca 3	245

Shtojca4	247
Perspektiva	253

LISTA E ILUSTRIMEVE

- Figura 2.1:** *Sistemet Autonome*
- Figura 2.2:** *Paraqitja e fushës së veprimit të protokolleve të rrugëzimit*
- Figura 2.3:** *Protokollet e rrugëzimit brenda dhe jashtë Sistemit Autonom*
- Figura 2.4:** *Protokollet e rrugëzimit në Internet*
- Figura 2.5** *Klasifikimi i AS-ve*
- Figura 2.6:** *Internal BGP (I-BGP) përkundrejt external BGP (E-BGP)*
- Figura 2.7:** *Pema e shtigjeve të AS*
- Figura 2.8:** *Funksionimi i BGP – Politikat e rrugëzimit*
- Figura 2.9:** *Shembull për përhapjen e një rifreskimi BGP*
- Figura 2.10:** *Shkëmbimi i mesazheve BGP*
- Figura 2.11:** *Zgjedhja e rrugës BGP*
- Figura 3.1:** *Përshkrimi i një modeli të një ISP-je.*
- Figura 3.2:** *Nje pamje e kufizuar e ruterave eBGP*
- Figura 3.3:** *Pamje e përgjithshme e hartës të GÉANT*
- Figura 3.4:** *Cluster-imi i prefikseve BGP*
- Figura 3.5:** *Cumulative Frekuenca e cluster-ave me numër të njëjtë prefiksesh.*
- Figura 3.6:** *Qendërzimi Betweenness i ruterave GÉANT*
- Figura 3.7:** *Qendërzimi Betweenness i linqeve GÉANT.*
- Figura 3.8:** *Ndarja e prefikseve nga numri i rrugëve të marra në GEANT .*
- Figura 3.9:** *Rëndësia e rregullave në GEANT*
- Figura 3.10:** *Ndikimi i shtimit / heqjes së peerings në shpërndarjen e trafikut përgjatë lidhjeve peering.*
- Figura 3.11:** *Ndikimi i shtimit/ largimit të peerings në koston e IGP të parë nga trafiku.*
- Figura 3.12:** *Ndikimi i shtimit / largimit të peering në vonesën e parë nga trafiku .*
- Figura 3.13:** *Analiza e dështimit të një linku të vetëm: ndikimi në BGP .*
- Figura 3.14:** *Analiza dështimi e një ruteri të vetëm : ndikimi në BGP .*
- Figura 3.15:** *Ndikimi i dështimit të R1-R3 mbi ngarkesën e lidhjeve.*
- Figura 3.16:** *Ndikimi i dështimit të R5-R6 mbi ngarkesën e lidhjeve.*
- Figura 3.17:** *Dështimi i një linku të vetëm më të ndjeshëm.*
- Figura 3.18-a:** *Shpërndarja kumulative e trafikut për secilin ISP të studiuar.*
- Figura 3.18-b:** *Shpërndarja Per-AS hop e trafikut për secilin ISP të studiuar.*
- Figura 3.19:** *Një Internet I thjeshtë*
- Figura 3.20:** *Shembull i rishpërndarjes së rrugëve të komuniteteve – kontrolluara(communities-controlled) .*
- Figura 3.21:** *Modeli i një AS me politikat.*
- Figura 3.22:** *Rëndësia e secilit rregull të procesit të vendimmarrjes BGP në nivele të ndryshme të hierarkisë së internetit .*
- Figura 3.23:** *Shpërndarja default relative e rrugëve nga ofruesit më pak të lidhur.*
- Figura 3.24:** *Përqindja e rrugëve në ofruesit më pak të lidhur për sasi të ndryshme të prepending .*
- Figura 3.25:** *Topologjia dhe politikat pengojnë efikasitetin e AS - Path prepending .*
- Figura 3.26:** *Topologjitë dhe politikat pengojnë efikasitetin e AS - Path prepending .*

Figura 3.27: Një pjesë e topologjisë interdomain parë nga YUCOM

Figura 3.28: Ndikimi i topologjisë dhe marrëdhëniet e biznesit në efikasitetin e Komuniteteve

Figura 3.29: Rëndësia e marrëdhënieve të ndryshme të biznesit në 2 AS HOPS nga multi-homed stub domains.

Figura 3.30: Skica e qasjes

Figura 3.31: Topologjia e rrjetit Interdomain

Figura 3.32: Diversiteti i rrugëve të përfuara gjatë multihoming në RouteViews ose RIPE peers.

Figura 3.33: Disbalancë e trafikut Inicializues ($\alpha = 0.5$).

Figura 3.34: Konvergenca e algoritmit evolucionarizues për stub-ë 3- dhe 4-homed.

Figura 3.35-a: Numri i Virtual Peerings për të krijuar ($\alpha = 0.5$).

Figura 3.35-b: Çekuilibri fillestar i trafikut ($\alpha = 0.25$).

Figura 3.35-c: Number of Virtual Peerings to establish ($\alpha = 0.25$).

Figura 3.36: Shpërndarja kumulative e vonesës për rrugët BGP.

Figura 3.37: Vonesa përgjatë rrugës BGP kundrejt vonesës përgjatë rrugës më të ulët.

Figura 3.38: Shpërndarja e përmirësimit të vonesës absolute

Figura 3.39: Shpërndarja kumulative e përmirësimit të vonesës absolute për stub-ët homed.

Figura 4.1: Komunikimi VoIP

Figura 4.2: Skema e aplikacionit VoIP

Figura 4.3: Skema e aplikacionit VoIP

Figura 4.4: Manaxhimi i jitter përmes jitter buffer

Figura 5.1: Arkitektura Bazë e ns-2

Figura 5.2: Struktura e direktorive të ns2

Figura 5.3: Hapat e përdorimit të ns2

Figura 5.4: Objektet e regjistrimit në një link

Figura 5.5: Diagrama rrjedhëse e metodologjisë së simulimeve

Figura 5.6: Topologjia në nivel AS dhe topologjia në nivel ruteri

Figura 5.7: Struktura njëdrejtimore e rrugëzimit në ns-2

Figura 5.8: Struktura njëdrejtimore e rrugëzimit në ns2-BGP

Figura 5.9: Struktura unicast e ns-BGP

Figura 5.10: Struktura e modulit të VoIP

Figura 5.11: Topologjia e rrjetit

Figura 5.12: Topologjia e rrjetit sipas modelit stub-domain

Figura 5.13-a: Dërgohet paketa e parë CBR

Figura 5.13-b: Dërgohet informacioni i rrugëzimit

Figura 5.13-c: Shpërndahet informacioni rrugëzimit

Figura 5.13-d: Shpërndahet informacioni rrugëzimit

Figura 5.14: Humbjet në paketa

Lista e tabelave

- Tabela 1:** *Procesi i vendimmarrjes BGP*
- Tabela 2:** *Veprimet tipike të rishpërndarjes së rrugëve në dispozicion me komunitetet*
- Tabela 3:** *Përmbledhja e RouteViews dhe RIPE datasets.*
- Tabela 4:** *Përmbledhja e metodave të inxhinierimit të trafikut*
- Tabela 5:** *Krahasimi i karakteristikave të koduesve të zërit*
- Tabela 6:** *Vlerat tipike të faktorit A*
- Tabela 7:** *Ekuivalenca midis faktorit R dhe MOS*
- Tabela 8:** *Parametrat për koduesit e ndryshëm të VoIP*
- Tabela 9 :** *Adresat IP*
- Tabela 10 :** *Karakteristikat e grafit*
- Tabela 11-48:** *Përmbledhjet e të dhënave të pyetësorit*

Kapitulli I

Hyrje

Në pak vite, interneti ka evoluar me shpejtësi nga një rrjet kërkimor që i shërben një pjese të vogël të përdoruesve në një ndërlidhje të madhe prej rreth 350 milionë hostesh [ISC05]). Në këtë mënyrë, interneti është sistemi më i madh i shpërndarë i ndërtuar ndonjëherë. Interneti është i organizuar në një numër të rrjeteve administrative të pavarur të quajtur domaine ose Sisteme autonome (AS). Për shembull, një AS mund të jetë një Internet Service Provider (ISP), një kampus universitar ose një rrjet i korporatave. Në kohën e këtij shkrimi, ka më shumë se 54.000 AS në internet [Hus06]. Gjatë kësaj infrastrukture të madhe, ka një tendencë në rritje për të vendosur aplikime të reja të tilla si transmetimin e Zërit ose video mbi IP dhe shërbime të reja të tilla si rrjetet private virtuale (VPN). Këto aplikacione dhe shërbime të reja kërkojnë garanci më të mirë apo të rrepta të cilësisë, ndërsa interneti është projektuar për të siguruar një shërbim best-effort. Ky evolucion vë shumë presion mbi ISP-të për të cilët aftësia për të ofruar më mirë se shërbimi best-effort apo mbështesin fortë marrëveshjt të nivelit të shërbimit (SLAs) [FE04] është çelësi si faktor diferencimi. Inxhinierët e rrjetit mbështeten në Inxhinierinë e Trafikut (TE) për të përshtatur konfigurimin e rrjetit të tyre për të mbështetur evolucionin e kërkesës trafikut dhe SLAs të konsumatorëve. Sot protokollin Border Gateway Protocol konsiderohet si standardi de-facto për rrugëzimin e paketave në Internet. Objektivi i tij kryesor është shkëmbimi i informacionit ndërmjet Sistemeve Autonome mbi lidhjet ekzistuese dhe aftësinë për të mbërritur një destinacion në një rrjet. Edhe pse performanca e Border Gateway Protocol është pranuar gjithnjë, përmasat, heterogjeniteti dhe ndryshueshmëria që e karakterizojnë Internetin sot, përbëjnë një sfidë për ruajtjen e cilësisë së shërbimit (QoS) duke vendosur kërkesa gjithnjë e në rritje për BGP në trafikun e shpërndarjes së paketave të të dhënave. Analizat e fundit të sigurisë të marra nga komuniteti i kërkimit kanë raportuar qartësisht karakteristikat e pakënaqëshme të BGP si integriteti i ulët dhe konvergjenca e ngadaltë përmes analizave teorike dhe matjeve empirike. Kështu është evidentuar që infrastruktura e rrugëzimit të internetit është mjaft e cënueshme. Ndaj përmes këtij punimi synohet që të vihet në dukje ndikimi që ka mbi performancën e rrjetit të internetit rifreskimi i këtij protokollin. Studiohen karakteristikat si heterogjeniteti, ndryshueshmëria dhe integriteti i ulët i këtij protokollin. Po ashtu përmes anketimit testohet kënaqshmëria e përdoruesit shqiptarë kundrejt cilësisë së shërbimit të internetit të ofruar nga ofruesit respektivë shqiptarë. Aty mund të nxirren në pah anët pozitive dhe mangësitë e QoS të internetit në Shqipëri.

Kapitulli i dytë është i natyrës teorike ku portretizohet protokollin BGP sëbashku me karakteristikat e tij të implementimit.

Kapitulli i tretë përfshin aplikimin e C-BGP që të modelojmë një domain të vetëm interneti. C-BGP lejon një operator rrjeti për të ndërtuar një model të rrjetit të tij dhe të injektojë konfigurimin, rrugëzimin dhe trafikun e të dhënave me qëllim të hetimit të skenarëve çfarë-nëse. Ne përshkruajmë çështjet teknike që lidhen me këtë modelim.

Kapitulli i katërt shtjellon elementët kryesorë VoIP dhe metodat e vlerësimit të cilësisë së thirrjeve VoIP si një aplikacion në kohë reale duke analizuar disa prej pritshmërive ndaj aplikacioneve VOIP në rrjet.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Kapitulli i pestë dhe kapitulli i gjashtë janë kapituj metodologjik që sigurojnë disa njohuri të nevojshme mbi simulimet dhe simulatorin e rrjetit ns-2. Gjithashtu në këtë kapitull përshkruhen dhe dy modulet e nevojshme për realizimin e ambjentit të integruar eksperimental dhe nga ana tjetër kapitulli i gjashtë përfshin studimin e anketës së zhvilluar, rastit studimor që është marrë në shqyrtim për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të internetit të ofruar nga Internet service provider-at shqiptare. Së fundmi trajtohen konkluzionet e nxjerra nga realizimi i këtij punimi.

1.1 Përcaktimi i problemeve dhe nënproblemeve

Përmasat e Internetit në ditët e sotme kanë sjellë nevojën e organizimit në Sisteme Autonome (AS) ku çdo sistem nga ana e tij përfaqëson interesa biznesi të ndryshme dhe shpesh konkurruese me të tjerët. BGP konsiderohet sot si standardi *de-facto* për komunikimet ndërmjet Sistemeve Autonome dhe “ngjitësi” që e mban këtë strukturë kaq komplekse të lidhur. Duke marrë në konsideratë natyrën dinamike të Internetit, performanca e BGP mbetet një çështje e hapur studimi veçanërisht për sa i përket kohës së konvergjencës së këtij protokollit. Studime të ndryshme kanë treguar ndikimin që ka kjo çështje performance e BGP në cilësinë e shërbimit të një rrjeti. Studime të tjera janë përqëndruar në cilësinë e aplikacioneve ndërtuar mbi infrastrukturën e Internetit. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar aplikacioneve VoIP në një kohë kur ekspertët e industrisë presin që kjo teknologji të zëvendësojë pjesën më të madhe të lidhjeve tradicionale telefonike.

Ky punim synon që përmes një ambjenti të integruar simulimi të mundësojë identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve që kanë faktorët e performancës së BGP në cilësinë e aplikacioneve të Internetit. Debati akademik që behet tani në vende të ndryshme të Europës dhe në USA, është integrimi i politikave të protokollit BGP (Border Gateway Protocol) Duke qenë se duhet të integrohen politika rrjetash në shtete të ndryshme implementimi i këtij protokollit has vështirësi të mëdha sidomos në nivelin e sigurisë (Imagjinoni disa e-maile nga Shtëpia e Bardhë në USA që duhet të kalojnë në disa vende të lindjes së mesme duhet të kalojnë nga vende të tilla si Iran, Irak, Siri etj).

A duhet të enkriptohet informacioni? Në ç`nivel duhet të jetë ai? Duhet të enkriptohet deri në nivele hardware informacioni? Si është raporti i BGP me TPM (Trusted Platform Module). A mund të integrojnë BGP rrjeta me platforma sigurie të ndryshme?

Këtu ne trajtojmë një anketë e cila përfshin si kampion popullatë përdorues të internetit studentët e Universitetit European të Tiranës. Ata kanë plotësuar plot 524 anketa rezultatet e të cilave janë reflektuar për të dhënë një pasqyrë të QoS të perceptuar nga kjo kategori e përdoruesve e cila na jep dhe një parashikim mbi një popullatë më të gjerë lidhur me këtë aspekt.

Ka këto kontribute kryesore në këtë tezë:

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

- Vlerësimi i një rasti studimor në Shqipëri mbi disa ISP-ë në lidhje me QoS dhe faktorët që ndikojnë në raportin kosto-performancë.
- Hartimi dhe zbatimi i një mjeti modelimi BGP, C-BGP. Është e mundur të llogariten rrugët BGP në topologjinë e rrjetit në shkallë të gjerë me anë të dy aplikimeve kryesore. Ai mund të përdoret nga operatorët e rrjetit ISP për të kuptuar më mirë rrugëzimin e tyre. Ai mund të përdoret edhe nga studiues për të studiuar karakteristikat makroskopike të rrugëzimit në internet.
- Një metodologji për të vlerësuar skenarët e rrugëzimit çfarë-nëse në rrjetet e ISP. Për shkak të ndërveprimit midis dy llojeve të protokolleve të rrugëzimit (link-state dhe path-vector), parashikimi i ndikimit në rrugëzim i një rrjeti ISP i ndryshimeve topologjike dhe të konfigurimit është një detyrë komplekse. Është treguar se si C-BGP mund të trajtojë një pjesë të madhe të këtij kompleksiteti.
- Një vlerësim i performancës në shkallë të gjerë së teknikave të tanishme të inxhinierisë së trafikut me bazë BGP. Së pari janë studiuar mekanizmat e kontrollit të rrugëzimit ekzistues të bazuar në BGP. Pastaj, duke përdorur C-BGP në një topologji Internet-shkallë, u vlerësuan dy prej këtyre mekanizmave: AS-Path prepending dhe Rishpërndarja e Komuniteteve. Është treguar se këto mekanizma janë të ashpër dhe jo-përcaktuese.
- Është propozuar Peerings virtuale, një mekanizëm të ri për inxhinierinë e trafikut të shkëmbyer në mes të dy ISP-ve bashkëpunuese, por jo të afërta. Ky mekanizëm është determinist, i shkallëzuar dhe është pothuajse gati i dislokueshëm. Është vlerësuar përdorimi i peerings virtuale për të zgjidhur dy objektivat e inxhinierisë së trafikut: ngarkesë-balancimin dhe përmirësimin e vonesave fund-më-fund.

Objektivat e studimit

Studimi ka këto objektiva:

- a) Studimi i QoS së internetit në Shqipëri.
- b) Njohja e protokollit dinamik të rrugëzimit BGP.
- c) Studimi i cilësisë së shërbimit të ISP-ve kryesore në Shqipëri.
- d) Studimi i topologjive të ndryshme të rrjetit dhe raportet e mesazheve mes kostove të ndryshme dhe cilësisë.
- e) Implementimi i politikave të sigurisë dhe rrugëzimit në nyjet e rutimit.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Hipotezat e këtij punimi janë:

1. QoS e internetit të ofruar nga ISP-të vendase në Shqipëri është në nivele optimale.
2. QoS e internetit në Shqipëri varet nga ISP e zgjedhur.
3. Interneti i cili ka heterogjenitet, përmasa shumë të mëdha, ndryshueshmëri të vazhdueshme ndikon në protokollin e rrugëzimit interdomain Border Gateway Protocol që shfaq konvergjencë të ngadaltë në nivel performance, dhe paraqet integritet të ulët.

Pyetjet kërkimore të shtruara për zgjidhje janë:

1. Varet QoS e internetit në vendin tonë nga karakteristika si besueshmëria, shpejtësia, shkëputjet e sinjalit?
2. Ka ndikim në QoS e internetit të vendit tonë operatorët dhe profesionalizmi i tyre ndaj shërbimit të klientit?
3. Ndikon lloji i ISP-së së zgjedhur në QoS e përgjithshme të internetit në Shqipëri ?
4. A do të rritet performanca e komunikimit midis kostove, pavarësisht topologjisë së lidhjes dhe fizionomisë së tyre (llojeve të paketave video, data etj)?
5. Niveli i përdorimit të një aplikacioni në kohë reale si VoIP ndikohet nga konvergjenca e ulët e BGP po aq sa ndikohet dhe nga mbingarkimi i rrjetit?
6. A ndikojnë momentet e rifreskimit të BGP në QoS e rrjetit të ISP-ve?
7. Pse ka rëndësi studimi i lidhjes që ekziston midis cilësisë së thirrjeve VoIP dhe rifreskimeve BGP, në nivel përdoruesi?

Avantazhet dhe disavantazhet

Së pari, ky studim merr përsipër të analizojë gjendjen e cilësisë së shërbimit në vendin tonë. Studimet në nivel përdoruesi mungojnë paraprakisht dhe pikërisht për këtë qëllim ky studim sjell një panoramë të përgjithshme të cilësisë së shërbimit që ofrohet në vendin tone nga ISP –të respektive.

Së dyti, krahas portretizimit të gjendjes aktuale të QoS në vend, studimi paralelisht analizon dhe një tjetër aspekt hibrid të cilësisë së shërbimit të internetit që është edhe shërbimi ndaj klientit duke parë në vija të përgjithshme evolumin e tij nga ISP-te operuese.

Së treti studimi në fjalë mund të shërbejë si një indikator për të parë cilët janë ISP-të më të parapëlqyera në vendin tone, pra kush prej tyre ka përthithur më shumë klientë-përdorues në treg.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Së katërti ky studim u vjen në ndihmë studiesve shqiptarë apo dhe atyre të huaj , për të mundësuar krijimin e perceptimit të situatës konkrete mbi gjendjen e internetit në Shqipëri, cilësinë e shërbimit të kompanive më të mëdha që mbulojnë këtë lloj shërbimi në treg sikurse është ofrimi I internetit në Shqipëri, dhe mbi këtë bazë të mbështeten për krijimin e studimeve të reja më të thelluara në të ardhmen.

Tema ka avantazhe pasi tentohet integrimi i rrjetave hibrid nën ombrellën e një protokollit të vetëm.

Avantazhi i kësaj teme është se tenton të shtojë QoS psh në transmetimet VOIP në rrjeta hibride të ndryshme si edhe shtimi i disa karakteristikave të sigurisë në të.

Element sfidues është transferimi i sistemeve video, të cilat mbështeten në QoS. Literatura për këtë është shumë e gjerë dhe fokusimi i saj është shumë i vështirë nga ana praktike.

Një sfidë tjetër është siguria, sidomos siguria duke kaluar nga niveli aplikacioni në nivelin hardware fizik.

Aktualisht ka një mungesë të theksuar të studimeve të kësaj natyre në vendin tone.

Disavantazhi apo problematika që mund të haset është implementimi i sigurisë nga niveli poshtë – lart në rrjeta hibride, për të cilën nuk ka një literaturë të mirëfilltë në botë.

1.2 Motivimi dhe kontributi i temës

Interneti përbën sot një mjet thelbësor komunikimi dhe informimi, por natyra dinamike dhe përmasat e tij bëhen shpesh shkak për degradimin e performancës. Nga ana tjetër kërkesat për shërbimet e ofruara dhe cilësinë e tyre në Internet vjen gjithnjë duke u rritur. Ky zhvillim ka hapur shtegun për studime të komponentëve të ndryshëm të tij si në nivel rrjeti ashtu dhe aplikacioni. Ndër aplikacionet që mbështeten në teknologjinë e Internetit, *Voice over IP* (VoIP) dhe *Video on Demand* (VOD) po fiton gjithnjë e më shumë interesin e përdoruesve por dhe të studiuesve të shumtë. Shpesh përdoruesit përdorin si model referimi për krahasimet e performancës së thirrjeve VoIP rrjetin tradicional telefonik, por Interneti i sotëm, i cili ofron shërbim “best effort”, duket se nuk është ende gati të ofrojë mbështetjen e duhur për cilësinë e thirrjeve VoIP dhe VOD.

BGP është protokollit “de facto” i rrugëzimit *inter – domain* në Internet sot, por ai shfaqet me një natyrë komplekse dhe me çështje performace ende të pazgjidhura. Vetë përmasat e Internetit dhe natyra heterogjene e tij i rrisin vështirësitë me të cilat duhet të përballlet ky protokoll.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Për këto arsye, realizimi i një punimi që ka si objekt kryesor studimin e trafikut në një nga aplikacionet e përhapura, VoIP, dhe protokollin BGP, si lidhësin kryesor në Internet, përbën interes në ditët e sotme.

Objektivi im është të studioj një rast në Shqipëri që përfshin aplikimin e këtij protokollin nga ISP-te respektive dhe të vlerësoj parametrat e cilësive së shërbimit dhe faktorët paralele që kontribuojnë në të duke faktuar rezultatet e përfuara nga simulimet e kryera në kushte laboratorike përmes NS-2.

Qëllimi kryesor i kësaj teze është të realizohet një studim i lidhjes që ekziston mes cilësisë së thirrjeve VOIP dhe rifreskimeve BGP si dhe të studiohet zgjedhja e gjerë e rrugëve në Internet të kryera nga BGP dhe performanca e tanishme e teknikave të kontrollit të rrugëzimit të bazuara në BGP që mund të mbështesin `interdomain Traffic Engineering`.

Në këtë punim janë përdorur simulimet si një metodë me kosto efektive për kërkimet në fushën e rrjetave kompjuterike. Një ambient eksperimental, në themel të të cilit qëndrojnë simulimet, ofron mundësinë e riprodhimit të rezultateve, për të garantuar kështu saktësinë e interpretimeve të tyre. Duke marrë parasysh që simulimet bartin kompleksitet të madh në përcaktimin e topologjive dhe modelime, ngritja e një ambienti të tillë, krijon një bazë për kërkime të mëtejshme mbi një strukturë të provuar. Në aplikojmë C-BGP që të modelojmë një domain të vetëm interneti. Në përshkruajmë çështjet teknike që lidhen me këtë modelim. Pastaj, në aplikojmë metodologjinë tonë në një rrjet ISP të vërtetë. Në vlerësojmë dy skenarë të ndryshëm çfarë-nëse.

Në ndërtojmë kërkesat për një teknikë të tillë të re: ajo duhet të jetë e parashikueshme, e shkallëzuar dhe e dislokueshme në internetin e sotëm. Në propozojmë Peerings Virtual të cilët janë një mjet për dy rrjete bashkëpunuese për të kontrolluar më mirë shtigjet mes njëri-tjetrit. Peerings Virtual kanë përparësitë e mëposhtme. Së pari, ata ofrojnë një kontroll determinist në shtigjet interdomain. Së dyti, ata mund të vendosen në internetin e tanishëm pasi ata janë transparentë në domaine të ndërmjetme.

Diskutimet rreth peshës së madhe që ka sot interneti dhe risitë dhe përparësitë që sjell përdorimi i tij janë të shumta. Pa dyshim që rëndësia e tij është e padiskutueshme. Kur flasim për internetin një aspekt tepër i çmuar është cilësia e shërbimit ose QoS. Pashmangshmërisht kjo lidhet me internetin dhe benefitet që përfitojmë prej tij. Kur gjuajmë internetin që ofrohet nga përgjegjësit përkatës sikurse janë ofruesit e tij ISP (internet service provider) pikëmbështetja është pikërisht QoS. Ky studim është fokusuar në kompanitë e mëdha që operojnë në një vend të vogël në zhvillim, siç është Shqipëria. Për këtë arsye, ky studim sjell kontribute të rëndësishme e me impakt që do t'i shërbejë jo vetëm kompanive operuese të vendit, por edhe studiuesve shqiptarë etj.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Duke qenë një shërbim dhe një drejtim I ri që po lulëzon ne treg ndeshen boshllëqe në plotësimin e studimit me element paraprijës që të kenë pararendur këtë drejtim studimi dhe për këtë arsye I gjithi studimi ka qenë një punë individuale e mirëfilltë.

Ka mjaft rëndësi që për një vend të ri në zhvillim si Shqipëria jonë, të merret në konsideratë si pjesë shembujsh dhe krahasimesh e studimesh prej sa më tepër studiuesish mbarë shqiptarë e të huaj në mënyrë të tillë që me anët positive e negative sepse në fund të fundit e gjitha kjo mund të shërbejë duke na çuar drejt zgjidhjes së problemeve ekzistuese. Duke e pare në periudhë afatgjate, rezultatet e këtij studimi e marra në konsideratë do të mund të përmirësoheshin ndjeshëm duke shtyrë në përmirësimin paraprakisht të aftësive konkurruese të kompanive të mëdha shqiptare brenda vendit si dhe do të nxitet niveli I bashkëpunimit midis bizneseve, qeverisë e universiteteve.

1.3 Burimet e informacionit

Njohuritë e përgjithshme mbi këto koncepte janë përftuar nga hulumtimi i literaturës bashkëkohore në këtë drejtim që shprehin bazat teorike mbi rrjetat, mënyrën e lidhjes mes tyre, sigurinë, protokollet e rrugëzimit të informacionit, besueshmëria në shpërndarjen e paketave etj. Kam studiuar librat me peshën më domethënëse në këtë fushë, si dhe vizituar faqet e portalet e disponueshme që ofrojnë materiale të bollshme për sfondin teorik të temës. Po ashtu një kontribut të vyer për mua kanë dhënë edhe shfletimi i artikujve mbarëbotërorë të cilët ofrojnë studimet e tyre dhe rezultatet me vlerë për zgjerimin e diapazonit të njohurive të përfshira me këtë temë. Zhvillimi i eksperimenteve praktike është realizuar në kompani private ku kam implementuar matjet ne nivel simulimi për hulumtimin e temës. Burimet ku jam mbështetur për hulumtimin e temës përfshijnë Internetin, vëllimet Tanenboun, literaturë mbi rrjetat, computer networks James Curoso, artikuj mbi protokollet BGP, konferencat me IEEE, ACM, USENIX, revista shkencore.

Pra dy burimet bazë të shfrytëzuara për hulumtimin e temës do ti gruponim në:

-Burimet parësore

a) Të dhënat e mbledhura drejtpërdrejt nga anketat e shpërndara drejt përdoruesve të internetit, të cilat janë 524 të plotësuar në total.

Këto të dhëna janë mbledhur nga një pyetësor i përgatitur online enkas për këtë studim ku secili përdorues regjistrohet automatikisht adresa e tij elektronike e kompjuterit dhe nuk kishte mundësi për një plotësim të dytë të anketës, pra të dhënat e grumbulluara janë autentike.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

b) Të dhënat e mbledhura drejtpërdrejt nga simulimet e kryera në kushte laboratorike për matjen e vonës dhe faktorëve që ndikojnë në cilësinë e shërbimit të internetit në aplikacione në kohë reale.

-Burimet dytësore

a) Të dhënat e grumbulluara nëpërmjet literaturës ku përfshihen librat, artikuj, revista shkencore.

b) Interneti dhe mediat elektronike respektive që lidhen me këtë temë.

1.4 Popullata dhe kampioni i studimit

Në fokusin e këtij studimi janë vetëm kompanitë e mëdha që operojnë në Shqipëri, qofshin ato me pronësi shqiptare, të huaj ose të përbashkët në rolin e aktorëve si ofrues të shërbimit të internetit. Lista e plotë me ISP-të operuese në vend është paraqitur në trajtë tabele në vijimësi dhe jep një përmbledhje të kompanive që gjenden në tregun shqiptar për të ofruar këtë lloj shërbimi.

Përsa i përket studimit pra janë marrë në shqyrtim liderat që dominojnë tregun në lidhje me mbulimin e shpërndarjes së internetit drejt përdoruesve vendas. Anketa i është drejtuar për plotësim studentëve të UET si përdorues të internetit.

Ata përbejnë dhe kampionin e popullatës ku prej tyre e kanë plotësuar në mënyrë të 524 prej tyre duke i dhënë përgjigje të tetë pyetjeve të parashtruara për përgjigje.

Pavarësisht nga fakti që popullata është e fundme, kampioni i këtij studimi është kampionim rasti i shtresëzuar.

Për mbledhjen e të dhënave është blerë një sistem anketimi elektronik i cili gjeneron anketat, i administron, i përpunon të dhënat në trajtat e dëshiruara për studim të mëtejshëm. Për mbledhjen e të dhënave janë shfrytëzuar databaza me kontaktet e studentëve të cilët kanë plotësuar anketën në fjalë.

Përsa i përket simulimeve në kushtet laboratorike në shqyrtim si kampion është marrë moduli BGP i instaluar në simulatorin elektronik të rrjetit NS-2. Përmes këtij simulatori është evidentuar efektshmëria që ka updatimi i protokollit BGP të internetit në cilësinë e tij si shërbim të ofruar nga ISP dhe konkretisht jemi fokusuar tek një aplikacion në kohë reale siç është VOIP.

1.5 Metodologjia

Ky punim bazohet në metodën e hulumtimit, metodën e analizës përshkruese, metodën e përpunimit matematikor të të dhënave si ngritja e algoritmave në protokollin BGP, pavarësisht hibridizimit të nënrrjetave. Qendra e temës së punimit është protokollin BGP dhe sfidat e tij. Satelitë të tij janë: QoS, Siguria në nivelin e ulët dhe të lartë, shfrytëzimi i sistemeve operative të ndryshme dhe raporti i tyre me protokollin BGP. Tematika është e gjerë pasi përfshin:

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Sistemet e rrugëzimit të paketave në sisteme hibride dhe integrimi i tyre, matja e vecorive QoS në të, siguria e informacionit, implementimi në sisteme operative të ndryshme. Po ashtu ky punim mbështetet në metodën krahasuese ku rezultatet përballen njëri-tjetrit për ti dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore të parashtruara. Rezultatet paraqiten në trajtë grafike.

Paralelisht me anën laboratorike kemi dhe pyetësorin që perfaqëson një rast studimor konkret për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të internetit që ofrohet në Shqipëri nga ISP-të. Duke qenë se variablat kanë natyrë përshkruese i klasifikojmë si variabla kategorikë dhe si rrjedhojë mund të kryejmë analizën respektive duke identifikuar numrin e elementeve të frekuencës së përgjigjeve të tyre për çdo pyetje, përqindjet e këtyre frekuencave të përgjigjeve, grafikët përkatës si dhe të gjykohet pavarësia midis variablave, a kanë apo jo ndikim tek njëri tjetri.

Ky punim ka karakter vlerësues përse i përket korrelacionit midis variablave. Një pjesë të rëndësishme të analizës e zë analiza përshkruese e cila krahason rezultatet dhe na jep një ide konçize mbi vërtetimin e hipotezave të parashtruara.

Padyshim që krahas metodave të lartpërmenduar kemi dhe atë që përfshin krahasimin e të dhënave sasiore që rrjedh nga rezultatet e simulimeve me analizat statistikore të raportuara me të dhënat cilësore të studimit empirik që u siguruan nga pyetësorët e shpërndarë tek lista e përdoruesve. Të dhënat janë përpunuar nëpërmjet programit të blerë SurveyMonkey, Gretl, Excel dhe me anë të NS-2.

1.6 Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre

Pyetësori

Të dhënat i përkasin periudhës 2016-2017. Këto të dhëna janë mbledhur përmes një pyetësori i cili përbëhej prej 8 pyetjesh.

Kategoritë e pyetjeve mund ti ndanim në 3 ku përfshihen:

- pyetje të cilat lidhen me cilësinë e shërbimit të internetit,
- pyetje të cilat lidhen me cilësinë e shërbimit të operatorëve ndaj klientit,
- pyetje të cilat lidhen me shpërndarjen në zotërim të tregut prej kompanive ISP në vend.

Në pjesën më të madhe të rasteve përgjigjet e pyetësorëve janë të përshkallëzuara në 4 raste duke nisur nga shkëlqyer, shumë mirë, kënaqshëm e deri në të pakënaqur. Ky pyetësor është një kombinim i disa pyetësorëve në vendet e huaja të cilat zhvillohen me qëllim të vlerësimit të QoS të internetit.

Pyetësori jep një informacion të përgjithshëm mbi qasjen që ka përdoruesi në lidhje me cilësinë e shërbimit të internetit të ofruar nga ISP-të në Shqipëri.

Simulimi

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Të dhënat i përkasin periudhës 2015-2017. Janë zhvilluar simulime laboratorike nëpërmjet simulatorit të rrjetit NS-2 në kohë reale të cilat fokusohen në faktorët që lidhen me cilësinë e shërbimit të internetit nga updatimi i protokollit të internetit BGP.

Pra shohim konkretisht si funksionon interneti nëpërmjet ndërhyrjes që ne kryejmë në protokollin e tij të pasqyruar në aplikacion në kohë reale si VOIP.

Përpunimi i të dhënave

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit janë automatikisht të përpunuara nga programi analizues i anketimit survey monkey. Më pas kalojmë në analizën përshkruese statistikore. Këtu ne përdorim programet statistikore për analizë të mëtejshme. Duke qenë se kemi të dhëna që janë variabla kategorikë , variabla cilësore, klasifikimi atëherë ne mund të vlerësojmë tre pika ku përfshihen numri i elementeve, përqindja e frekuencës së përgjigjeve për secilën kategori respektive si edhe të ndërtojmë grafikët përkatës. Kjo lloj analize përshkruese statistikore jep një vizion të përmbledhur mbi rezultatet e punimit. Këtu ne shohim përgjigjet e mbledhura të studimit në trajtë përqindjesh. Përmes saj mundësohet identifikimi paraprak i disa prej variablave më me peshë të rëndësishme si dhe shpjegimi i variablit kryesor të varur që në situatën tonë është cilësia e shërbimit të internetit, QoS. Nga përfundimet që nxjerrim mund të shohim dhe pavarësinë mes variablave. Pra a ndikon një variabël tek një tjetër. Gjithashtu mund të shohim nëse kemi apo jo variabla të kushtëzuar.

Nga ana tjetër në lidhje me simulimet laboratorike përsa i përket pjesës eksperimentale përpunimi është realizuar nga programi që ekzekuton kodet NS-2 i cili në bashkëpunim me Nam, interpretuesi vizual i topologjisë të rrjetit (Network Animator) i cili bën interpretime të rrjetit duke ofron animacion të nivelit paketë dhe grafikë (grafe) të protokolleve specifike për të ndihmuar në hartimin dhe kontrollin e gabimeve (debugging) e protokolleve të reja të punës në rrjet (net-work). Duke marrë të dhëna nga simulatorët e rrjetit (si Ns-2) ose prej rrjeteve dretpërdrejt (live), Nam ishte një nga mjetet e para për qëllimin e përgjithshëm për të siguruar vizualizimin e animuar të rrjetit dhe të nivelit të paketave. Nam tani integron subjekte të ngjarjeve në kohë tradicionale të veprimeve të protokolleve dhe aftësive redaktuese të skenarëve. Ai ofron interpretim vizual të rrjetit dhe topologjisë dhe ekzekutim të drejtpërdrejtë të skriptit Tcl. Po ashtu mjet i dytë për simulim me Ns-2 është përveç Nam edhe gjuha e skriptimit AWK e cila është një gjuhë programimi procesimi testesh duke e kthyer në një mjet ndihmës për performimin e punëve procesuese të teksteve të thjeshta e komplekse.

1.7 Modeli teorik

Performanca e BGP (si elementi kryesor lidhës për Internetin) mbetet dhe sot një çështje e hapur studimi veçanërisht për sa i përket kohës së konvergencës. Griffin *et. al* [1] e kanë cilësuar mundësinë që një grup AS-sh të shkëmbejnë pafundësisht mesazhe

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

rrugëzimi BGP, pa konvergjuar në një bashkësi rrugësh të qëndrueshme, si “*problem i konvergjencës së BGP*”. Labovitz *et. al* [2], [3] matën ndryshimet në rrugëzim në Internet dhe treguan se mund të ekzistojë një vonesë e konsiderueshme në konvergjencën e BGP dhe se një nivel i lartë i luhatjes të rrugës gjatë një konvergjence të zgjatur ka një ndikim të madh në trafikun *end-to-end*, duke shkaktuar humbje paketash dhe të lidhjes. Gjithashtu Wang *et. al* [4], [5] kanë treguar se ngjarjet e rifreskimit të BGP lidhen ngushtë me periudha humbjesh paketash dhe vonesash. Këto punime kanë studiuar ndikimin e momenteve të rifreskimit të BGP në cilësinë e rrjetit megjithatë asnjëra nuk ka patur në fokus ndikimin e “problemit të konvergjencës” në aplikacione të ndryshme.

Nga ana tjetër VoIP përbën një fushë aktive kërkimore në drejtim të cilësisë së thirrjeve “cross domain”. Tobagi *et. al* [6] shtruan një pyetje konkrete dhe ende bashkëkohore: “A është interneti gati për VoIP dhe VOD?!”. Matjet e realizuara prej tyre në rrjeta *backbone* të Internetit evidentuan se disa prej tyre shfaqin karakteristika të padëshirueshme që nuk mund të trajtoheshin me masat ekzistuese. Amir *et. al* [7] në një studim të mëvonshëm thekson nevojën për përmirësimin e aplikacioneve VoIP si rrjedhojë e faktit se modeli ekzistues i shërbimit në Internet nuk ofron garanci për cilësi shërbimi. Ky studim, si dhe të tjerë para tij [8], [9], [10], [11] ofrojnë disa zgjidhje për përmirësimin e performancës së VoIP por rezultatet e përfuara i mbështesin në vlera statistikore në nivel paketash, si vonesat dhe humbjet. Ka plot studime mbi temat që lidhen me VoIP në lidhjet “cross-domain” por ajo që synohet të realizohet në këtë punim është një studim i lidhjes që ekziston midis cilësisë së thirrjeve VoIP dhe rifreskimeve BGP, në nivel përdoruesi.

Kushman *et. al* tek [12] kanë treguar se niveli i përdorimit të VoIP ndikohet nga konvergjenca e ulët e BGP po aq sa ndikohet dhe nga mbingarkimi i rrjetit. Ky studim ndryshe nga të më sipërmir bazohet në simulime. Bacioccola *et. al* [13] kanë treguar se përlllogaritja e performancës në nivel IP (siç ndodh rëndom në ns-2) nuk rezulton gjithmonë e saktë dhe kanë ofruar një modul për ns -2 që lejon vlerësimin e performancës së VoIP në nivel përdoruesi. Nga ana tjetër në [14] tregohet se moduli ns-BGP i krijuar për simulimin e BGP në ns2 ka algoritma dhe struktura të brendshme të dhënash që janë të përshkallëzueshme në terma numri lidhjesh të palëve dhe përmasa të tabelave të rrugëzimit.

Të dy këto module dhe ambjenti i ns2 përbëjnë bazën mbi të cilën do të realizohet modelimi i sistemit.

1.8 Organizimi i kapitujve

Vazhdimi i këtij punimi është i organizuar si më poshtë vijon:

Kapitulli 2 siguron njohuritë bazë në lidhje me protokollin e rrugëzimit në Internet, BGP. Ai jep një tablo të disa nga tiparet karakterizuese me kyçe të tij duke na njohur paraprakisht me ndërtimin, strukturën dhe strategjinë e funksionimit të tij dhe Shohim tipet e rrugëzimit dhe në veçanti mënyrën si kryhet konkretisht rrugëzimi me këtë

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

protokoll specifik. Evidentojmë paqëndrueshmëritë e tij dhe gjithashtu trajton një nga çështjet kryesore të lidhura me performancën e tij, kohën e konvergencës.

Kapitulli 3 ne aplikojmë C-BGP që të modelojmë një domain të vetëm interneti. C-BGP lejon një operator rrjeti për të ndërtuar një model të rrjetit të tij dhe të injektojë konfigurimin, rrugëzimin dhe trafikun e të dhënave me qëllim të hetimit të skenarëve çfarë-nëse. Ne përshkruajmë çështjet teknike që lidhen me këtë modelim. Pastaj, ne aplikojmë metodologjinë tonë në një rrjet ISP të vërtetë. Ne vlerësojmë dy skenarë të ndryshëm çfarë-nëse. Në rastin e parë, do të hetojmë ndikimin e shtimit ose heqjes së peerings në rrugëzim. Në skenarin e dytë, ne vlerësojmë ndikimin e lidhjes së vetme dhe dështimet e routerit të vetëm në rrugëzim. Bazuar në një studim të tillë, një operator i rrjetit mund të përcaktojë se cilat lidhje duhet të mbrohen në mënyrë që të sigurojmë një shërbim elastik për dështimet. Në pjesën e tretë të tezës, ne nuk e kufizojmë modelimin në një domain të vetëm, por shtrihet tek një ndërlidhje e madhe të rrjeteve. Ne aplikojmë mjetin e modelimit në një rrjet të internetit, për të studiuar efikasitetin e teknikave aktuale të inxhinierisë së trafikut të bazuar në BGP. Ne përshkruajmë se si është kryer sot inxhinierimi i trafikut. Ne shpjegojmë se kontrollimi i trafikut që lë një ISP është i mundur meqë vetëm një kontroll lokal është i nevojshëm. Në të kundërt, kontrolli i trafikut që vjen në drejtimin e kundërt është më i vështirë pasi rrugëzimi në domain-e të largët duhet të ndikohet. Në bazë të simulimeve në shkallë të gjerë të BGP, ne tregojmë se shumë vendime rrugëzimi në modelin e internetit janë marrë rastësisht. Përveç kësaj, një rrjet në internet ka një pamje shumë të kufizuar të të gjithë topologjisë. Kjo kufizon zbatueshmërinë e teknikave inxhinierike të trafikut të tilla si AS - Path prepending ose rishpërndarja komuniteteve. Ne konkludojmë se nuk është kështu një nevojë për të zhvilluar një mekanizëm të ri inxhinierie trafiku. Ne propozojmë Peerings Virtual të cilët janë një mjet për dy rrjete bashkëpunuese për të kontrolluar më mirë shtigjet mes njëri-tjetrit.

Kapitulli 4 trajton elementët kryesorë VoIP dhe metodat e vlerësimit të cilësisë së thirrjeve VoIP. Veçanërisht, për matjen e cilësisë së VoIP, trajtohet Modeli E dhe MOS. Këtu në këtë kapitull analizohen disa prej pritshmërive ndaj aplikacioneve VOIP në rrjet, jepen disa njohuri bazë mbi koduesit e zërit, rrugën si kryhet paketizimi, po ashtu trajtohet koncepti i Jitter buffer me njohuri të përgjithshme dhe së fundmi ndalemi tek matja e cilësisë së VOIP.

Kapitulli 5 siguron disa njohuri të nevojshme mbi simulimet dhe simulatorin e rrjetit ns-2. Gjithashtu në këtë kapitull përshkruhen dhe dy modulet e nevojshme për realizimin e ambientit të integruar eksperimental. Në këtë kapitull trajtohen simulimet duke përfshirë elementet, simulimet që varen nga koha, trajtohet simulatori i rrjetit ns-2, arkitektura e tij, direktoritë e përfshira dhe po ashtu përmendet përdorimi i ns-2.

Ne përshkruajmë përpjekjet për të ofruar një model sa më të përshtatshëm simulimi dhe eksperimente sa më të plota për të treguar se trafiku i VoIP ndikohet nga koha e konvergencës së BGP. Ai trajton modelin e simulimit duke dhënë strukturimin e ndërtimit të rrjetit. Po ashtu këtu preket shkurtimisht topologjia e rrjetit, ashtu sikurse dhe struktura njëdrejtimore e rrugëzimit ns-2 si edhe struktura njëdrejtimore e rrugëzimit ns-2-BGP. Në këtë kapitull gjejmë të përmendur klasifikuesin IPV4, rmodule BGP,

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

rtProtoBGP, TcpSockets, BGPTimer, VecRoutes, dampreuse-timer, dampinfo, gjeneratorin e topologjisë GT-ITM. Këtu është trajtuar modeli i rrugëzimit, ndërtimi i modelit të të dhënave, gjendja e rrjetit dhe vlerësimet e performancës dhe së fundmi vihen në dukje ndryshimet në model.

Këtu përmbledhim rezultatet e simulimeve të realizuara dhe interpretimet përkatëse. Ne shohim që jepet verifikimi i modelit të përzgjedhur të rrugëzimit, kryhen disa simulime të topologjisë Stub-Domain me trafik CBR dhe shpalosen rezultatet e simulimit.

Kapitulli 6 përfshin studimin e anketës së zhvilluar, rastit studimor që është marrë në shqyrtim për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të internetit të ofruar nga Internet service provider-at shqiptarë. Jepet një analizë e të dhënave të grumbulluara nga përdoruesit shqiptarë të përfshirë në pyetësor dhe listohen edhe të gjitha përgjigjet në përballjen e dy grupeve të ekstremiteteve në kategoritë e përgjigjeve. Pra kemi dhe renditjen e përgjigjeve të filtruara të grupit të shkëlqyer kundrejt atyre të pakënaqur me QoS e internetit.

Konkluzione përshkruan konkluzionet e arritura përmes këtij punimi dhe shtron disa drejtime të mundshme për punë të ardhme kërkimore, në këtë fushë.

Kapitulli II

Border Gateway Protocol – BGP

2.1 Hyrje

Që nga koha kur është krijuar interneti ose siç njihet ndryshe World Wide Web (WWW), ka pësuar ndryshime si në aspektin e topologjisë por gjithashtu edhe në shkallëzueshmërinë e tij. Në ditët e sotme mund të jenë me miliarda nje të vogla që komunikojnë me njëra-tjetrën duke shkëmbyer të dhëna. Për të përballuar gjithë këtë ngarkesë duhet të aplikohen protokolle të fuqishme rrugëzimi për të garantuar Cilësinë e Shërbimit (QoS). Ka disa mënyra komunikimi në internet: one-to-one ose *Peer2Peer*, one-to-many ose *multicast*, one-to-all ose *broadcast*. Çfarëdo protokollit rrugëzimi të përdoret 2 nga funksionalitetet kryesore të tij do të jenë: 1) Gjetja e rrugës optimale për në destinacion, si dhe 2) Dërgimi i informacionit të dëshiruar data.

Nisur nga përmasat e Internetit sot do të ishte shumë e vështirë për një autoritet të vetëm ta manaxhojë atë. Për këtë arsye Interneti është strukturuar në formën e një federate të gjërë *Sistemesh Autonome (AS)* siç paraqitet në mënyrë të thjeshtuar në figurën më poshtë:




Figura 2.1: Sistemet Autonome

Çdo AS administrohet në mënyrë të pavarur nga një autoritet i vetëm, si një universitet, një kompani ose një agjenci shtetërore. Në mënyrë të përgjithëshme dhe nga këndvështrimi i kësaj teme, mund të thuhet se një AS është një bashkësi ruter-ash që ndajnë të njëjtat politika rrugëzimi dhe janë nën të njëjtin autoritet administrative.

Në ditët e sotme BGP konsiderohet si standardi de-facto për rrugëzimin e paketave në Internet. Objektivi i tij kryesor është shkëmbimi i informacionit ndërmjet Sistemeve

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Autonome mbi lidhjet ekzistuese dhe aftësinë për të mbërritur një destinacion në një rrjet. Interneti në ditët e sotme përbëhet nga mijëra Sisteme Autonome të lidhur me njëri-tjetrin, të cilat mund ti përcaktosh si një set router-ash dhe rrjetesh që ndodhen nën të njëjtin administrim. Një sistem autonom tipik është një rrjet universiteti, korporate ose një ISP. Një AS identifikohet nga një numër 16-bit. Ky numër jepet nga autoritetet e numërimit në të njëjtën mënyrë sesi shpërndahen adresat IP. Rrugëzimi në internet varet nga rrugëzimi ndërmjet AS si dhe nga rrugëzimi brenda këtyre sistemeve.




Fig 2.2 – Paraqitja e fushës së veprimit të protokolleve të rrugëzimit

Brenda të njëjtit sistem router-at aplikojnë *Interior Gateway Protocols* (IGP) për të zbuluar dhe për të shkëmbyer informacion rreth rrjeteve të brendshme me të cilat janë lidhur direkt. Router-at nga AS të ndryshme përdorin *Exterior Gateway Protocols* (EGP), për të shkëmbyer informacione mbulimi dhe për të përcaktuar rrugën nga fillimi në fund për paketa që kalojnë ndërmjet disa sistemeve. Në kufij të çdo AS, router-at fundorë të BGP shkëmbejnë informacion mbi blloqet e adresave IP, të cilat quhen ndryshe *prefikse*. Çdo prefiks konsiston nga një adresë 32-bit dhe një gjatësi maske që tregon madhësinë e rrjetit. Për shembull, 192.168.1.0/24 përfaqëson një bllok prej 256 adresash që fillojnë me 192.168.1.0 dhe mbarojnë me 192.168.1.255.

Protokolli BGP i përdorur në Internetin e ditëve të sotme është BGPv4 [15].

2.2 Rrugëzimi në Internet

Ruterat në një rrjet mbështeten në protokolle rrugëzimi për të zbuluar dhe përpunuar shtegun më të mirë për shkëmbimin e informacionit. Protokollet e rrugëzimit në Internet mund të ndahen në dy 2 kategori protokollesh rrugëzimi ku përfshihen të gjitha protokollat e sotme:

- 1) *Interior Gateway Protocols* (IGP) - mundësojnë rrugëzimin brenda një AS-je (*intra domain*), ku përfshihen Routing Information protocol (RIP),

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Open Shortest Path first (OSPF), Enhanced Interior Gateway Protocol (EIGRP) dhe Intermediate System to Intermediate System (IS-IS). Të gjitha këto protokolle funksionojnë brenda një Sistemi Autonom (AS).

2) **Exterior Gateway Protocols (EGP)** - mundësojnë rrugëzimin ndërmjet AS-ve të ndryshme (*inter domain*), ku edhe BGP bën pjesë pikërisht në këtë grup protokolle.




Fig 2.3 – Protokollat e rrugëzimit brenda dhe jashtë Sistemit Autonom

Më sipër paraqitet figura ku tregohen llojet e protokolleve gateway si dhe fushën e veprimit të tyre. Siç tregohet BGP është protokollin që vepron midis sistemeve autonome, të cilat zakonisht janë ISP.




Figura 2.4: Protokollat e rrugëzimit në Internet

Rrugëzimi *inter domain* është një komponent i rëndësishëm i rrugëzimit në Internet, me që një sasi e madhe e trafikut përshkon më shumë se një AS. Për më tepër, fakti se çdo AS manaxhohet nga një autoritet i ndryshëm e komplikon situatën krahasuar

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

me rrugëzimin *intra domain*. Në këtë të fundit, të gjitha burimet administrohen nga i njëjti autoritet. Ky autoritet mund të përdorë të gjitha burimet brenda një AS-je dhe qëllimi kryesor është rrugëzimi i paketave në mënyrën më efektive të mundshme (ky rrugëzim zgjidhet përmes një protokollit IGP). Por, në rrugëzimin *inter domain*, autoritete të ndryshme mund të kenë interesa të ndryshme që mund të lidhen dhe me konkurrencën në biznes. Këto ndryshime kanë një impakt të madh në rrugëzim (për këtë arsye nevojitet një protokoll kompleks i tipit EGP –*Exterior Gateway Protocol*).

Për shembull: Zakonisht AS-të nuk duan të tregojnë topologjitë e brendshme të rrjetit apo politikat e përdorura, dhe zakonisht zgjedhin politika rrugëzimi që nga të cilat mund të përfitojnë më shumë vetë. Si rrjedhojë, rrugëzimi *inter domain* është i komplikuar me që duhet të reflektojë karakteristikat e mëposhtme:

- Çdo AS duhet të jetë në gjendje të shprehë politikat lokale që reflektojnë interesat e biznesit të saj.
- Protokollin ka nevojë të jetë i përshkallëzueshëm. Në terma përshkallëzimi, protokollin duhet të marrë në konsideratë numrin e madh të AS-ve, prefikseve IP dhe shtegjeve potenciale të pranishme në Internet. Së pari, numri i AS-ve të lajmëruara në Internet është gjithmonë në rritje. Së dyti, çdo AS mund të lajmërojë prefikse të ndryshme dhe numri i prefikseve kohët e fundit po rritet më shpejt se ai i AS-ve. Së fundmi, çdo AS mund të mësojë më shumë se një shteg për çdo prefix, kështu që numri i shtegjeve në Internet rritet edhe më shumë.
- Privatësia e çdo AS duhet respektuar. Në Internetin aktual, rrugëzimi ndahet në *intra domain* dhe *inter domain*, në mënyrë që një AS mund të shmangë ndarjen e detajve të brendshme me të jashtëmit. Kjo ndarje jo vetëm që përmirëson sigurinë por dhe ndihmon në kufizimin e efekteve të dështimeve të brendshme.

Më sipër përmendëm që Interneti është i organizuar në AS (ose *domain*-e) që mund të kenë një, dy ose qindra nyje dhe janë të lidhura me njëri tjetrin. Por një karakteristikë tjetër e Internetit është se këto nyje i nënshtrohen një hierarkie të imponuar që vjen nga klasifikimi i AS-ve në “*AS fundore*” dhe “*AS tranzit*”. Një AS është i tipit të parë nëse shtegu që lidh çdo dy nyje u ose v mbetet në atë AS vetëm nëse u ose v janë në të njëjtin AS. Qëllimi i AS tranzit është që të ndërlihdë AS fundore dhe nuk i nënshtrohen kufizimit të mëparshëm. AS tranzit përfshin një bashkësi nyjesh kryesore mbështetëse që zakonisht janë të lidhura shumë mirë menjëra-tjetrën. Secila nga këto nyje lidhet me një AS fundor përmes nyjeve ndërmjetëse (*gateway*). Disa prej këtyre nyjeve mund të lidhen dhe me AS të tjera tranzit. E gjitha kjo ilustron në figurën më poshtë:

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 2.5 Klasifikimi i AS-ve

AS fundore mund të klasifikohen në “single homed” ose “multi-homed”. Këto të fundit kanë lidhje me më shumë se një AS tranzit ndërsa të parët lidhen vetëm me një AS tranzit. Disa fundore lidhen dhe me AS të tjera fundore.

2.3 BGP: Një protokoll për rrugëzimin “*inter domain*”

Border Gateway Protocol (BGP) është thjesht një protokoll tjetër rrugëzimi, por me një rol shumë të ndryshëm nga të tjerët me që shërben si lidhësi që mundëson funksionimin e Internetit. Për më tepër, fakti se çdo AS manaxhohet nga një autoritet i ndryshëm e komplikon situatën krahasuar me rrugëzimin *intra domain*.

BGP implementohet në ruter-a dhe mesazhet shkëmbehen përmes një lidhjeje të qëndrueshme TCP midis dy ruter-ave (duke thjeshtuar kështu kompleksitetin e implementimit të besueshmërisë së transportit).

Ruter-at që ekzekutojnë një process rrugëzimi BGP njihen si *folësa BGP*. Dy folësa BGP që krijojnë një lidhje TCP me njëri tjetrin, me qëllim shkëmbim informacion rrugëzimi, cilësohen si *fqinjë* ose *palë* në komunikim.

Trafiku që kalon nëpër një AS klasifikohet në *trafik lokal* ose *trafik tranzit*. Trafiku lokal vjen nga ose përfundon në AS ku gjendet adresa IP e burimit ose destinacionit. Çdo trafik tjetër që përshkon këtë AS përbën “trafik tranzit”. Një qëllim i rëndësishëm i BGP në Internet është pikërisht *zvogëlimi i trafikut tranzit*.

Nisur nga sa thamë për trafikun, mund të pohojmë se një ruter BGP mund të komunikojë me ruter-a të tjerë BGP që ndodhen në të njëjtën AS me të (njihet si I-BGP) ose në AS të tjera, të ndryshme (njihet si E-BGP).

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Të gjithë ruter-at që “flasin” I-BGP Brenda të njëjtit AS duhet të krijojnë lidhje me njëri-tjetrin sipas modelit “*fully connected mesh*”. Këto lidhje jo detyrimisht duhet të jenë fizike, mjafton që këto rutera të kenë të ngritur një kanal komunikimi të besueshëm, TCP, mes tyre. Me që nuk ka një mekanizëm për detektimin e cikleve të pafunda në I-BGP, ruter-at që “flasin” I-BGP nuk duhet të përcjellin informacion rrugëzimi të palëve të treta ndaj fqinjëve të tyre. Ruter-at E-BGP, ndryshe nga të mëparshmit, mund të lajmërojnë informacion të palëve të treta tek fqinjët e tyre E-BGP.

Figura në vijim tregon ruter-at R1, R2, dhe R3 që përdorin I-BGP për shkëmbimin e informacionit të rrugëzimit brenda të njëjtës AS, dhe çiftet e ruter-ave R4-R2, R3-R5, dhe R4-R5 që përdorin E-BGP për shkëmbimin e informacionit të rrugëzimit mes AS-ve.




Figura 2.6: Internal BGP (I-BGP) përkundrejt external BGP (E-BGP)

Siç kemi thënë më sipër, BGP është një protokoll i përdorur për të mirëmbajtur informacionin e rrugëzimit midis AS-ve. Pjesa më e madhe e protokolleve të rrugëzimit *intra-domain* bazohen në algoritmin Dijkstra. Por BGP, është një protokoll që bazohet në “vektorin e shtegut” (*path-vector*) që nënkupton se informacioni i rrugëzimit përmban një vektor me ASN (çdo AS-je i vihet në dispozicion një numër në rendin 0 – 65535) që tregojnë shtegun e AS-ve që përshkon një prefiks i caktuar (çdo AS zotëron gjithashtu një rend adresash IP të cilat mund të vendosë ti ndajë në grupe më të vogla që përmbajnë disa adresa IP të vazhdueshme të njohura si Prefix IP.). Bazuar në informacionin e shkëmbyer mes ruter-ave BGP ndërtohet një graf Sistemesh Autonome (i njohur dhe si *pemë*).

2.3.1 Karakteristikat e funksionimit të BGP

Për sa i përket BGP:

I gjithë Interneti është një graf AS-sh, lidhjet midis dy AS-ve vормojnë një shteg, koleksioni i informacionit mbi shtegjet formon një rrugë drejt një destinacioni specific

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

dhe rrugëzimi brenda një sistemi autonom realizohet përmes IGP. Figura 2.3.2 ilustron konceptin e pemës së shtigjeve:




Figura 2.7: Pema e shtigjeve të AS

Katër tipa mesazhesh janë të specifikuar për BGP [16]:

- *Mesazhi i hapjes* – janë mesazhet e para që dërgohen dhe hapin një seksion komunikimi me s palëve
- *Mesazhet e rifreskimit* – sigurojnë rifreskimet mbi rrugëzimet duke lejuar ndërtimin e një pamjeje të qëndrueshme mbi topologjinë e rrjetit. Këto mesazhe bëjnë të mundur dhe shfuqizimin e rrugëve të papërshtatshme dhe lajmërimin e rrugëve të reja. Shfuqizimet e rrugëve dërgohen kur një ruter mer një vendim të ri lokal që një rrjet nuk është më i arritshëm. Një lajmërim rruge tregon që një ruter ka mësuar për lidhjen e një rrjeti të ri ose ka ndryshuar politikën duke zgjedhur një rrugë të re të preferuar për një rrjet destinacion. Pas marrjes së mesazhit çdo nyje vendos se çfarë do bëjë me të (psh. të ndryshojë tablën e rrugëzimit) dhe në se do ta përhapë më tutje këtë mesazh. Të dyja këto vendime meren në përputhje me politikat e AS
- *Mesazhet e lajmërimit* – Dërgohen në rast gabimesh për të informuar pjesmarrësit në seksionin aktiv mbi arsyet e mbylljes së këtij seksioni.
- *Mesazhi “mbaje-gjallë”* - i lajmëron palët BGP se një pajisje është active dhe seksioni nuk duhet mbyllur. Ruter-at BGP nuk kanë një pamje të plotë të topologjisë të rrjetit. Çdo ruter di vetëm si të arrijë fqinjët direkt dhe veçanërisht përmes kujt fqinji në veçanti mund të arrihet një Prefiks Rrjeti.

2.3.2 Rrugëzimi i BGP

Pjesa më e madhe e protokolleve të rrugëzimit marrin informacione rrugëzimi, e përdorin atë për të ndërtuar tabelat e rrugëzimit dhe i ndajnë këto tabela (ose pjesë të tyre) me ruter-a të tjerë në rrjet. Ajo që e bën BGP një protokoll unik është aftësia e tij për të zbatuar politika ndaj informacionit të përmbajtur në mesazhet e rifreskimit, dhe për rrjedhojë përzgjedhja e informacionit rifreskues bazuar në atributet e vetë informacionit. Politikat e rrugëzimit përcaktojnë mënyrën se si manaxhohen rrugët e mara nga nyjet BGP dhe si ja dërgon këtë informacion këtyre nyjeve. Në shumë raste, politikat e rrugëzimit konsistojnë në filtrimin e rrugëve, pranimin e disa rrugëve, pranimin dhe modifikimin e rrugëve të tjera dhe kundërshtimin e disave. Kur mesazhet e rifreskimit meren nga një ruter BGP, ato i nënshtrohen një procesi përpunimi në përputhje me një seri politikash të cilat përcaktojnë se si dhe ku do të ruhet informacioni. Në mënyrë që të lejohet ky kontroll mbi përzgjedhjen e rrugës, lajmërimeve të BGP i janë shtuar disa attribute që lejojnë ndryshimin e vendimeve në bazë të vlerave të tyre. Ruter-i krahason vlerat e këtyre attributeve për çdo rrugë, sipas një liste të renditur dhe përzgjedh rrugën që ka vlerat më të pranueshme për atributin. Nëse vlerat janë të njëjta, kalon tek atributi pauses. Rruga e përzgjedhur do jetë ajo që do përdoret për të përcjellë paketat. Përmes attributeve bëhet e mundur që një rrugë më e gjatë (që kalon nëpër më shumë AS) të përzgjidhet ndaj një më të shkurtër (këto attribute janë shumë të përdorshme në rrjetat e ISP-ve).

Koncepti i funksionimit të BGP mund të përmblihet në figurën më poshtë:




Figura 2.8: Funksionimi i BGP – Politikat e rrugëzimit

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Një folës BGP vetëm një shteg (rruga e preferuar) mund të përdoret për një destinacion dhe është e ndaluar të përhapen rrugë të ndryshme nga ajo e preferuara në përdorim. Kur merret një lajmërim i ri, shfrytëzohen politikat e implementura të rrugëzimit për të parë nëse rruga e re është më e mirë se ekzistuesja. Nëse ky është rasti, rruga e vjetër zëvendësohet me atë të marrë së fundmi. Më pas, nëse politikat e lejojnë, rruga i lajmërohet fqinjëve.

Psh. një ruter mund të ketë një politikë që përcakton se ai nuk do të aksesojë kurrë rrjetin 165.113.0.0 përmes AS 1159. Kështu që nëse një mesazh rifreskimi përmban informacion për arritshmërinë nëpër një shteg drejt 165.113.0.0 përmes AS 1159, ky informacion nuk do të lejohet nga mekanizmi i politikave që të arrijë tabelën e rrugëzimit duke shkaktuar që ruter të mos ta përdorë asnjëherë këtë shteg. Politika mund të mos jetë tërësisht diskriminuese duke e përcaktuar një rrugë jo të papërdorëshme por thjesht të pa dëshirueshme duke bërë të mundur që procesi i rrugëzimit ta konsiderojë destinacionin përmes këtij shtegu, shumë të largët. Këto që përmendëm njihen si politika të hyrjes. BGP lejon gjithashtu edhe implementimin e politikave të daljes (psh. “mos dërgë asnjë informacion mbi 165.113.0.0 tek AS47.”) ose të ndryshojnë atributet e rifreskimeve bazuar në informacionet e politikave të përcaktuara. Pra politikat mund të konsiderohen si një mënyrë për të filtruar rrugët brenda dhe jashtë sistemit.

BGP është një protokoll *rritës (inkremental)*. Kur një ruter lidhet për herë të parë me një fqinj, transmetohet tabela e plotë e rrugëzimit BGP. Pas kësaj, nuk dërgohen rifreskime të rregullta mbi informacionin e rrugëzimit përveç rastit kur ka ndryshime në rrugë. Në teori mesazhet duhet të dërgohen vetëm kur lajmërohet një rrugë e re, rifreskohet (pasqyrohen ndryshimet) apo shfuqizohet një rrugë. BGP kërkon që çdo ruter të ruajë informacionin e marrë nga çdo fqinj si dhe informacionin që i ka dërguar fqinjëve të tjerë.

Në mënyrë që të rrugëzohet një paketë të dhënash në një rrjet të caktuar, nevojitet identifikimi dhe përcaktimi i vendodhjes të rrjetit destinacion. BGP përdor *rrugëzimin me Prefiks* për të adresuar rrjetat. Prefiksi i një rrjeti bazohet në idenë e përcaktimit të një identifikuesi për çdo rrjet në mënyrë që për çdo paketë të dhënash të jetë e qartë nëse destinacioni ndodhet brenda një rrjeti të caktuar. Prefikset nuk japin asnjë informacion mbi mënyrën se si arrihet rrjeti destinacion. Ky informacion duhet të përftohet nga përdorimi i protokollit BGP. Në kontekstin e BGP, të mirëmbash informacionin mbi lidhjet do të thotë të jesh në gjendje të identifikosh mënyrën se si një paketë të dhënash rrugëzohet për në destinacion.

Përveç rrugës të paracaktuar, duhet të ruhen dhe gjithë rrugët alternative që çojnë në një prefix të caktuar rrjeti, nga fqinjët e tjerë. Arsyeja e kësaj është nevoja për të rivendosur lidhjen sa më shpejt nëse rruga e paracaktuar bëhet e padisponueshme. Kur kjo ndodh AS mund të përdorë një rrugë tjetër për të rrugëzuar paketat dhe për të mbajtur lidhjen edhe kur një link dështon ose ka ndryshuar topologjia e rrjetit.

2.3.3 Konvergjenca e BGP

BGP ekzekutohet njëkohësisht në ruter-a të vendosur në AS të ndryshme dhe për këtë arsye, procesi i zgjedhjes së një rruge në Internet plotësohet në mënyrë të shpërndarë. Rezultati i një algoritmi të shpërndarë mund të varet nga gjendja fillestare e sistemit dhe rendi i ekzekutimit gjatë procesit. Në disa raste, një algoritëm i shpërndarë mund të most arrijë një gjendje të qëndrueshme edhe pse gjendjet e qëndrueshme janë të arritshme në se një tjetër gjendje fillestare apo rend ekzekutimi do ishte zgjedhur. Kur një ruter ndryshon rrugën e tij më të mirë, mund të formohen laqe të mbyllura, të përkohëshme dhe mund të humbin paketa. Në se procesi i përzgjedhjes së rrugës në BGP nuk konvergjon, disa ruter-a mund të vazhdojnë të ndryshojnë rrugën e tyre më të mirë pafundësisht, çka mund të ketë një ndikim shkatërrues në trafikun e Internetit. Për këtë arsye, konvergjenca e protokollit është një çështje e rëndësishme në projektimin e protokolleve të rrugëzimit *inter domain*.

Si pjesa më e madhe e specifikimeve të protokolleve të rrugëzimit, BGP përfshin një “kronometër” për çdo lajmërim për të kufizuar rendin e rifreskimeve të BGP. Pa një element kufizues, një palë do ti dërgonte rifreskime fqinjëve të saj sa herë që rruga më e mirë ndryshon, edhe kur rruga për një prefix ndryshon disa herë Brenda pak sekondave.

Në BGP, ky “kronometër” quhet *Minimum Route-Advertisement Interval timer (MRAI)* [15].

Një “kronometër” i tipit *jittered* nënkupton përdorimin e vlerave që ndryshojnë në mënyrë rastësore. Vlera tipike e MRAI është 30 sekonda. Në se do përdreshin ekzaktesisht 30 sekonda për çdo ruter, do kalohej në vetë-sinkronizim të ruterave. Kjo nga ana e saj implikon dërgimin e mesazheve të rifreskimit në të njëjtën kohë, çdo 30 sekonda [19]. Ky është një efekt i padëshirueshëm për BGP. Kjo mund të evitohet pikërisht duke e modifikuar intervalin e “kronometrit” në mënyrë rastësore, për çdo ruter por duke e implementuar në mënyrë të tillë që të arrihen vlera midis 25 dhe 30 sekondave.

MRAI mund të shkaktojë dërgimin e rifreskimeve të shumëfishta në një seksion komunikimi mes palësh siç tregohet në **Figura 2.2**: AS1 ka shtuar një prefix të ri P dhe për këtë arsye po dërgon një mesazh rifreskimi BGP drejt AS2 dhe AS3 për P me shteg: AS1. Ky rifreskim meret nga AS2, shtohet në tabelat e rrugëzimit, dhe i dërgohet AS4 me që AS2 nuk ka dërguar ndonjë rifreskim drejt AS4 brenda 30 sekondave të fundit. AS4 mer rifreskimin, shton prefixin në tableë dhe ja dërgon rifreskimn AS5. Edhe AS3 e ka marë informacionin dhe ka rifreskuar tableën, por nuk ja dërgon dot AS4 për sa kohë nuk ka përfunduar intervali MRAI. Pasi AS4 mer rifreskimin nga AS3, kupton që ky është një shteg më i mirë dhe rifreskon tableën e rrugëzimit për këtë prefix me informacionin e ri e i dërgon një rifreskim tjetër për prefixin P , AS . Siç vihet re, në një shembull kaq të thjeshtë, AS1 shërbeu si burim për një rifreskim për prefixin P dhe AS4 pati nevojë të dërgojë dy rifreskime për të njëjtin prefix.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 2.9: Shembull për përhapjen e një rifreskimi BGP

Shpërndarja e mesazheve të rifreskimit varet kryesisht nga topologjia dhe numri i rrugëve alternative.

Punë të mëparëshme me BGP kanë treguar se nëse nuk vihet asnjë kufizim, njëjtë tentojnë të shkëmbejnë një numër të madh rifreskimesh për rrugët e paqëndrueshme (*flapping routes*). Përmes mekanizmit *Route flap damping* [20] tentohet të evitohet që një rrugë e paqëndrueshme të bëjë mbingarkimin e Internetit me mesazhe rifreskimi. Ideja kryesore pas saj është që të mbahet një histori rifreskimesh për një prefix të caktuar dhe të refuzohet të besohen rifreskimet që kapërcejnë disa parametra të paracaktuar. Për shembull, një numër i caktuar rifreskimesh për një ore mund të jetë tepër i lartë.

BGP është një protokoll inkremental që dërgon rifreskime vetëm nëse ka ndryshime në lidhje me topologjinë dhe/ose arritshmërinë. Në teori ndryshimi ndiqet nga disa mesazhe rifreskimi dërguar mes nyjeve. Pasi palët kanë rivendosur rrugët e tyre të preferuara, bota e BGP kthehet sërisht e qetë. Koha ndërmjet ndryshimit dhe kohës kur të gjitha palët kanë zgjedhur rrugët e reja të preferuara përfaqëson konceptin e konvergencës. *Procesi i konvergimit përfundon kur të gjitha palët kanë vendosur rrugët e tyre të reja, të preferuara.*

Ky është koncepti naiv. Në realitet, si rrjedhojë e përmasave të Internetit (rreth 15 000 AS, 120 000 prefikse) dhe shumë faktorëve të tjerë, ka një zhurmë kostante në trafikun e BGP. Prandaj nevojitet që procesi i konvergimit të studiohet më në detaje.

Sa herë që aftësia për të arritur një rrjet ndryshon, duhet të ketë një arsye për këtë. Kjo njihet si *ngjarja e paqëndrueshmërisë*. Një listë e pjeshme e arsyeve të mundshme është si më poshtë:

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

- Dështim ose riparim i një linku fizik.
- Rindezja e një ruter (psh. për rifreskim softueri).
- Ndryshime në politika në AS-ve.
- Shtim/fshirje e prefikseve të rjetit.

Ngjarja e paqëndrueshmërisë mund të ndikojë në lidhjen brenda një AS-je ose midis AS-ve. Kur përfshihet lidhja e brendëshme e një AS-je, kjo trigeron procesin e konvergencës brenda AS, në protokollin IGP [21]. Lidhja e ngjarjeve IGP me BGP (rishpërndarja e IGP në BGP), është në kundërshtim me praktikat operacionale. Normalisht BGP nuk duhet të përfshihet në këtë ngjarje paqëndrueshmërie.

Kur një ngjarje paqëndrueshmërie ndikon lidhjet ndërmjet AS-ve, ajo shkakton shfuqizimin e një rruge të mëparëshme ose lajmërimin e një rruge alternative. Në se shohim efektet e paqëndrueshmërisë në BGP dallojmë momentin e ngjarjes së paqëndrueshmërisë të ndjekur nga rifreskimi i parë i BGP dërguar nga nyja BGP e prekur nga ngjarja. Ky informacion i ri arritshmërie përhapet nëpër ruter-at BGP dhe shumë mundësisht, nuk do të ketë rifreskime të tjera dhe kjo është pika ku thuhet se rrjeti ka konvergjuar për sa i përket këtij prefiksi. Parë nga këndvështrimi i një ruter, ky mund të marrë një numër rifreskimesh nga çdo palë, të përlllogarisë rrugën e re më të mirë dhe tja lajmërojë palëve të tjera. E gjitha kjo procedurë do të quhet Procesi i konvergimit në BGP.

2.3.4. Paqëndrueshmëritë e BGP

BGP ka plotësuar shumë nga kërkesat e Internetit të sotëm por ka dhe shumë dobësi. Probleme të ndryshme si gabime programimi, sulme TCP ose mbingarkimi i rrjetit mund të shkaktojnë paqëndrueshmëri në tabelat e rrugëzimit të ruter-ave BGP.

- a. Fenomeni i “vrimës së zezë” - Një nga problemet më klasike të BGP njihet me emrin fenomenin “vrimës së zezë”. Në këtë problem, një gabim, një sulmues ose një konfigurim i gabuar shkakton që një ruter BGP të lajmërojë gabimisht se përmes AS ku bën pjesë, psh AS X, ka shtegje drejt disa rrjetave me kosto të ulët. Kjo nga ana saj shkakton që shumë ruter-a BGP të rifreskojnë tabelën e tyre të rrugëzimit me këtë informacion. Si rezultat, një sasi e madhe trafiku do të kalojë përmes AS X. Ky trafik i papritur shkakton nga ana e tij paqëndrueshmëri të tabelave të rrugëzimit, sasi të mëdha paketash dhe burimesh rrjeti të humbura dhe në fund një rënie nga mbingarkesa tek AS X. Në literaturën e BGP ka disa instanca të mirëdokumentuara të fenomenit “vrima e zezë” që mund të gjenden në [16], [17], [18].
- b. Dobësitë nga TCP - Një tjetër dobësi e rëndësishme e BGP lidhet me protokollin e transportit të përdorur nga BGP, që është TCP. Ky protokoll është vulnerabël ndaj

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

disa llojeve të sulmeve DOS, gabimeve në programim dhe mbingarkesës së rrjetit në linjat e përdorura. Psh. një sulm i tipit “SYN flooding” ndaj një server, mund të shkaktojë që lidhjet e parashikuara midis palëve BGP të mos vendosen dhe ato ekzistuese të humbin, në se trafiku i krijuar nga sulmi shkakton mbingarkim të rrjetit.

- c. Mbingarkimi i rrjetit – Mbingarkimi i rrjetit mund të jetë patologjik për BGP dhe të shkaktojë paqëndrueshmëri në tabelat e rrugëzimit. Për shembull, në se një sasi shumë e madhe trafiku është paracaktuar të kalojë përmes një AS-je specifike, ka gjasa që linqet që lidhin këtë AS me botën e jashtme të jenë të mbingarkuara dhe si rrjedhojë mund të ndodhi që mesazhet KEEPALIVE që shkëmbehen përmes një lidhjeje të vendosur TCP të humbin ose dhe vetë lidhja TCP të shkëputet. Në këtë rast fqinjësia mes dy ruter-ave BGP do të humbë.
- d. Luhatja e rrugëve (*Route flapping*) - Paqëndrueshmëria e rrugëzimit mund të përshkruhet si një ndryshim i shpejtë i informacionit mbi informacionin mbi arritshmërinë e destinacionit dhe topologjisë në rrjet. Kur një rrugë lajmërohet, shfuqizohet dhe pastaj rilajmërohet thuhet se ajo luhetet. Rrugët e paqëndrueshme janë me kosto të lartë sepse ruterat duhet të përllogarisin rrugë të reja sa herë meret një mesazh i ri. Kjo shkakton ngarkesë të lartë në ruter dhe mund të {ojë deri në një dështim (*crash*) të tij.

Janë zhvilluar disa teknika për të përmirësuar paqëndrueshmëritë e BGP. Dy më kryesoret janë:

Route flap damping –Në rastin e rrugëve që luhaten, disa implementime të BGP, përdorin një mekanizëm të njohur si “shuarja e rrugës” (*route damping*) – një rrugë që luhetet i vihet në përkatësi një vlerë *ndëshkim* dhe në se kjo vlerë kapërcen një kufi të caktuar, kjo rrugë konsiderohet si e pavlefshme. Vlera e ndëshkimit zvogëlohet me kalimin e kohës. Në se rruga ndërpret luhatjet, ajo rilajmërohet dhe ndëshkimi që i ishte vendosur, shfuqizohet.

Message aggregation shpesh ka një lidhje ndërmjet mesazheve të rifreskimit dhe atyre të shfuqizimit. Zakonisht, kur një rrugë shfuqizohet, mesazhi i shfuqizimit shoqërohet direkt me një mesazh lajmërimi – rruga mund të jetë subject i ndryshimeve ose i një sjelljeje patologjike. Për të zvogëluar volumin e trafikut konsiderohet me interes që mesazhi mos përhapet menjëherë pas gjenerimit, por të ruhet për një farë kohe dhe informacioni të agregohet. Në se rruga është shfuqizuar dhe më pas rilajmërohet po njëjloj, është e saktë të anulohen të dyja mesazhet me që gjendja në përgjithësi mbetet e njëjtë. Kjo metodë zvogëlon vëllimin e trafikut dhe përpunimet në ruterat BGP.

Për fat të keq të dyja këto metoda fusin vonesa në përhapjen e rrugëve. Kështu që pavarësisht se protokollin dhe rrugët stabilizohen, koha e konvergencës vjen duke u rritur.

2.4 Menaxhimi i sesionit ndërmjet “çifteve”

Kur router-at që suportojnë BGP duan të hapin një sesion komunikimi, atëherë ata hapin një lidhje TCP në portën 179 me router-in “çift”. Pasi lidhja është krijuar, çdo entitet dërgon një mesazh *open* për të negociuar parametrat e sesionit të komunikimit. Në mënyrë që të ketë dijeni mbi vlefshmërinë e kësaj lidhjeje dhe për të monitoruar router-at komshinj, Router-at dërgojnë shpesh mesazhe *keep-alive*. Gjatë hapjes së shkëmbimit të mesazheve, router-at BGP përcaktojnë *kohën e pritjes*, maksimumi i kohës që duhet të presë para se të dërgojë mesazhin pasardhës. Mungesa e pranisë së një mesazhi brenda këtij intervali, tregon se entiteti tjetër nuk po funksionon normalisht. Nëse një entitet brenda këtij “çifti” komunikimi merr një mesazh të gabuar, të formatuar keq apo nuk merr asgjë brenda *kohës së pritje* atëherë i dërgon një mesazh të tipit *notification* entitetit fqinj, fshin të gjithë tabelën e rrugëve që ka marrë prej tij dhe me fatmirësisht mbyll sesionin TCP. Më poshtë tregohen hapat që përdoren për të arritur një sesion komunikimi BGP.




Fig 2.10 – Shkëmbimi i mesazheve BGP

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

2.4.1 Shkëmbimi i informacionit të rrugëzimit

Si fillim, para se të shkëmbejnë tabelat e rrugëzimit, 2 router-at BGP vendosin një sesion komunikimi. Më pas entitetet mund të shkëmbejnë të gjithë tabelën e rrugëzimit që disponojnë, nëpërmjet një serie mesazhesh (UPDATE). Router-at supozohet të memorizojnë të gjitha rrugët e ofruara nga entitetet e tjera në sesion. Mbasi të gjitha janë përfunduar router-at i dërgojnë njëri-tjetrit përditësime të pjesshme të rrugëve të reja në tabelat e tyre.

Mesazhet e tipit *Update* mund të mbulojnë 2 tipe informacionesh: 1) *Lajmërim* dhe 2) *Tërheqje*. Një *Lajmërim* e njofton marrësin e tij për një rrugë të re për filan prefiks destinacion, kurse një *Tërheqje* e anulon rrugën e lajmëruar më parë. Përveç informacionit të mbulimit, një mesazh *update* përmban një numër të ndryshueshëm atributesh rruge, të cilat përshkruajnë veçoritë e rrugës, nga të cilët mund të përmendim: *local preference*, *next-hop*, *origin type*, *AS path* dhe *multi-exit discriminator* (MED).

Le të shohim me rradhë se çfarë përshkruan secili prej tyre.

1) Atributi *AS path* përmban një listë të të gjitha Sistemeve Autonome që prefiksi ka përshkruar. BGP e përdor *AS path* si për të detektuar cikle ashtu edhe për të zgjedhur rrugën. Kur një router merr një BGP *update* atëherë ai ekzaminon vektorin e rrugës dhe nëse sheh numrin e Sistemit të tij Autonom atëherë ai e zhvlerëson këtë rrugë.

2) Atributi *next-hop* përfaqëson adresën IP të router-it që duhet të përdoret për të arritur rrjetin e dëshiruar.

3) Atributi *origin type* identifikon sesi Sistemi Autonom fillestar mësoi për rrugën: brenda Sistemit Autonom (konfigurimi statik), një versioni të vjetëruar *Exterior Gateway Protocol* (EGP) ose është injektuar nga një protokoll tjetër rrugëzimi. *Origin types* njihen si IGP, EGP ose e panjohur (INCOMPLETE).

4) Atributi *Multi-Exit Discriminator* inkurajon marrësin të përcaktojë se në cilën nga pikat dalje të orientojë trafikun drejt një Sistemi Autonom fqinj.

5) Atributi *local preference* mund të përfshihet në mesazhet iBGP (për të cilin do flasim më poshtë) për të ndihmuar marrësin të renditë rrugët e marra nga router-a të ndryshëm brenda të njëjtit Sistem Autonom.

2.4.2 Përpunimi dhe gjetja e rrugës

Janë dy tipe sesionesh BGP ndërmjet entiteteve: *external BGP* (eBGP) për entitete ndërmjet Sistemeve të ndryshme Autonome dhe *internal BGP* (iBGP) për entitete ndërmjet të njëjtit Sistem Autonom. Në figurën 2.3 shfaqen hapat për gjetjen e rrugës BGP.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Në fillim router-i aplikon politikat e importit për të filtruar rrugët e padëshiruara. Për shembull, një router BGP mund të pranojë lajmërimi nga një *AS path* që përmban një set të besuar Sistemesh Autonome. Më pas router-i thërret një proces vendim-marrjeje për të zgjedhur saktësisht një rrugë më të mirë për çdo prefiks destinacioni, duke krahasuar rrugën e re me të gjitha rrugët e tjera të njohura më parë për të njëjtin destinacion. Router-i aplikon një sekuençë hapash për të ngushutar setin e kandidatëve deri në 1 të vetëm. Rruga më e mirë e zgjedhur me këtë mënyrë do të instalohe në tabelën e forward-imit, ndërsa rrugët e tjera do mbahen për qëllime *backup*-i.




Fig 2.11 – Zgjedhja e rrugës BGP

Në përfundim, router-i aplikon politikat e eksportit për të manipuluar atributet dhe të vendosë nëse do ta lajmërojë këtë rrugë tek Sistemet Autonome fqinjë. Nëse po, router-i mund të modifikojë disa nga atributet e rrugës. Në fund do shtojë numrin AS të tij tek *AS path*.

2.4.3 Zhvlerësimi i një rruge

Nëse një router merr një informacion *tërheqjeje*, si fillim heq rrugën e zhvlerësuar nga rekordet e tij. Nëse rruga që hiqet është momentalisht rruga më e mirë, router-i kërkon në *backup*-et e tij për një rrugë të dytë më të mirë dhe nëse kjo nuk funksionon atëherë e quan destinacionin si të paarrtshëm. Nëse kjo e fundit aplikohet, një lajm zhvlerësimi *duhet* ti çohet çdo entiteti që mësoi rrugën nga lajmërimet e mëparshme.

2.4.4 Reflektimi i rrugës

Në implementimin standart iBGP, të gjithë router-at BGP brenda të njëjtit Sistemi Autonom janë të lidhur ngushtë kështu që informacioni për rrugëzim jashtë sistemit shpërndahet ndërmjet të gjithë router-ave brenda AS. Por ky model mund të krijojë problem me shkallëzueshmërinë kur AS ka një numër të madh *folësish* BGP. Reflektimi i rrugës krijon një mënyrë për të ulur kontrollin e trafikut të BGP, kjo duke minimizuar numrin e mesazheve *update* që dërgohen brenda sistemit Autonom.

Koncepti i reflektimit të rrugës është bazuar në idenë e krijimit të një nyjeje (router) përqëndrimi (reflektuese), e cila të funksionojë si një pikë kyçe për sesionet iBGP. Në reflektimin e rrugës, sistemet BGP organizohen në *tufa* (clusters). Çdo *cluster* konsiston nga të paktën një router që luan rolin e një reflektuesi rruge, së bashku me një numër çfarëdo entitetesh klientë. Entitetet që ndodhen jashtë *cluster*-it nuk quhen entitete klientë. Reflektuesit e rrugës rishpërndajnë informacionin e rrugëzimit tek çdo entitet, qoftë ai klient ose jo. Për arsye se reflektuesi i rrugës rishpërndan rrugët brenda *cluster*-it, Router-at BGP nuk është e nevojshme të jenë plotësisht të lidhur.

Kur një reflektues rruge merr një rrugë, ai zgjedh rrugën më të mirë. Më pas, nëse rruga vjen nga një entitet jo klient, reflektuesi e dërgon rrugën tek çdo entitet klient brenda *cluster*-it. Nëse rruga vjen nga një entitet klient, reflektuesi e dërgon rrugën drejt çdo entiteti jo klient si dhe entiteti klient përveç atij nga është gjeneruar. Gjatë këtij procesi, asnjë entitet klient nuk i dërgon rrugë njëri-tjetrit.

2.5 Përfundime

BGP kategorizohet si një *protokoll i vektorit të rrugës* (PV), një variant i *protokollit të vektorit të distancës* (DV). Në vend që të transferojë informacion mbi gjëndjen e lidhjes dhe koston, çon informacion mbi rrugën e plotë për të mënjeluar ciklet e tepërta. BGP përmban TCP si protokoll komunikimi në shtresën e transportit, që në anën e tij është protokoll i sigurt dhe eliminon nevojën që BGP të marrë përsipër ritransmetimin, aprovimin (ACK) dhe sekuencialitetin. Router-at që përdorin BGP si protokollin e tyre quhen BGP *folës*. Dy folës BGP që marrin pjesë në një sesion BGP quhen *fqinjë* ose *çift*. Router-at çift shkëmbejnë 4 tipe mesazhesh: *open*, *update*, *notification* dhe *keep-alive*. Nga të gjitha këto mesazhe vetëm *update* përmban informacion rrugëzimi ndërkohe që 3 të tjerët shërbejnë për menaxhimin e sesionit të komunikimit.

Duke u mbështetur nga çka përmendëm më sipër, karakteristikat e rrugëzimit në Internetin e sotëm mund të përmbledhen në parimet e përgjithshme të mëposhtme, në lidhje me shtegun midis dy nyjeve u dhe v :

- Nëse u dhe v janë në të njëjtin AS, shtegu ndërmjet tyre mbetet i gjithi brenda AS.
- Nëse u është në AS U dhe v është në AS V , shtegu mes u dhe v kalon nga U në zero ose më shumë AS tranzit.

Inicialisht, para se të shkëmbejnë tabelat e rrugëzimit, 2 router-at BGP caktojnë një sesion komunikimi. Më pas entitetet mund të shkëmbejnë të gjithë tabelën e rrugëzimit që

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

kanë, me anë të një serie mesazhesh (UPDATE). Router-at mendohet të memorizojnë të gjitha rrugët e ofruara nga entitetet e tjera në sesion. Pasi të gjitha janë përfunduar router-at i dërgojnë njëri-tjetrit përditësime të pjesshme të rrugëve të reja në tabelat e tyre.

Në fillim router-i aplikon politikat e importit për të filtruar rrugët e padëshiruara. Në vazhdim router-i thërret një proces vendim-marrjeje për të zgjedhur saktësisht një rrugë më të mirë për çdo prefiks destinacioni, duke krahasuar rrugën e re me të gjitha rrugët e tjera të njohura më parë për të njëjtin destinacion. Router-i aplikon një sekuencë hapash për të ngushtuar setin e kandidatëve deri në 1 të vetëm. Rruga më e mirë e zgjedhur me këtë mënyrë do të instalohet në tabelën e forward-imit, ndërsa rrugët e tjera do mbahen për qëllime *backup*-i.

Në përfundim, router-i aplikon politikat e eksportit për të manipuluar atributet dhe të vendosë nëse do ta lajmërojë këtë rrugë tek Sistemet Autonome fqinjë. Nëse po, router-i mund të modifikojë disa nga atributet e rrugës. Në fund do shtojë numrin AS të tij tek *AS path*.

Nëse një router merr një informacion *tërheqjeje*, si fillim heq rrugën e zhvlerësuar nga rekordet e tij. Nëse rruga që hiqet është momentalisht rruga më e mirë, router-i kërkon në *backup*-et e tij për një rrugë të dytë më të mirë dhe nëse kjo nuk funksionon atëherë e quan destinacionin si të paarrtshëm. Nëse kjo e fundit aplikohet, një lajm zhvlerësimi *duhet* ti çohet çdo entiteti që mësojë rrugën nga lajmërimet e mëparshme.

Në implementimin standart iBGP, të gjithë router-at BGP brënda të njëjtit Sistemi Autonom janë të lidhur ngushtë kështu që informacioni për rrugëzim jashtë sistemit shpërndahet ndërmjet të gjithë router-ave brënda AS. Por ky model mund të krijojë problem me shkallëzueshmërinë kur AS ka një numër të madh *folësish* BGP. Reflektimi i rrugës krijon një mënyrë për të ulur kontrollin e trafikut të BGP, kjo duke minimizuar numrin e mesazheve *update* që dërgohen brenda sistemit Autonom.

Koncepti i reflektimit të rrugës është bazuar në idenë e krijimit të një nyjeje (router) përqëndrimi (reflektuese), e cila të funksionojë si një pikë kyçe për sesionet iBGP. Në reflektimin e rrugës, sistemet BGP organizohen në *tufa* (clusters). Çdo *cluster* konsiston nga të paktën një router që luan rolin e një reflektuesi rruge, së bashku me një numër çfarëdo entitetesh klientë. Entitetet që ndodhen jashtë *cluster*-it nuk quhen entitete klientë.

Kapitulli III

Modelimi i rrugëzimit të një ISP

Hyrje

Shërbimi kryesor i ofruar nga Internet Service Providers (ISP-të) është një përpjekje e mirërealizuar best-effort. Sot, gjithsesi konsumatorët janë duke kërkuar për shumë më tepër se një shërbim best-effort s'rrugëzime do të ishte performanca dhe besueshmëria e garantuar. Shërbimet e reja të shpërndara gjerësisht të tilla si VPN ose VoIP apo VOD dhe IPTV kërkojnë rritjen e garancive të performancës nga rrjeti. Për këtë arsye, ISP- të janë shumë të ndjeshëm ndaj elasticitetit dhe performancës së rrjetit të tyre. Ata përpiqen të sigurojnë cilësitë për klientët e tyre me anë të Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit (SLAs) (FE04). Prandaj, ISP-të kërkojnë të ndërtojnë rrjete që do të strehojnë ngarkesa të ndryshueshme të trafikut dhe të jenë të fuqishme për lidhjet e linqeve si dhe ndaj dështimeve të router-ave. Për të kënaqur kufizimet e shtrënguara të SLAs, ISP e planifikojnë nga pikëpamja inxhinierike rrjetin e tyre për të siguruar performancat më të mira, si minimizimin e vonesës në të gjithë rrjetin, ose parandalimin e ngjeshjes (congestion) që ndodh në lidhjet e aksesit.

Në këtë kapitull, është prezantuar një qasje bashkëpunuese për inxhinierimin të trafikut interdomain. Kjo qasje mbështetet në Peerings Virtual. Një Peering Virtual është një tunel IP njëdrejtimësh midis një routeri kufitar e zgjedhur nga burimi AS dhe një router kufiri i zgjedhur nga AS destinacion. Zgjidhja jonë për të krijuar një Peering Virtual mbështetet në tre parime themelore. Së pari, ka një Peering Virtual Controller brenda secilit AS dhe IP adresa e tij është e bashkangjitur si komunitet i zgjeruar BGP për të gjithë reklamat BGP të krijuara nga AS. Së dyti, një seancë eBGP multi-hop është themeluar mes VPC-ve të burimit dhe AS-ve destinacion për të negociuar Virtual Peering-sët. Burimi AS zgjedh "head-end"-in e Peering Virtual në bazë të objektivave të vet të inxhinierisë së trafikut. Së treti, destinacioni AS zgjedh në mënyrë autonome "tail-end"-in e Peering Virtual. Një përparësi kryesore e qasjes sonë është se ajo mund të vendoset në mënyrë rritëse brenda AS-ve bashkëpunuese stub dhe nuk kërkon ndonjë ndryshim në AS-të tranzit. Duke pasur parasysh madhësinë e internetit global dhe numrin e rrugëve BGP, kjo vendosje në rritje është një problem kyç operativ që duhet të merret parasysh.

Ne kemi treguar se Peerings virtuale mund të përdoren për të zgjidhur problemet inxhinierike të trafikut interdomain. Ne vlerësuam ato në dy raste të veçanta, pra balancimi i ngarkesës së trafikut dhe uljen e vonesës së rrugëve interdomain. Kur përdoret për të balancuar ngarkesën e trafikut, Peerings Virtual janë një zgjidhje e shkallëzueshme meqënëse nga një numër i kufizuar i tyre do të jetë e nevojshme për të arritur një ekuilibër afër perfektës. Në mënyrë tipike, me 1000 burimet përgjegjëse për 95% të trafikut inbound, në rendin e 50 peerings virtuale janë të nevojshme për të balancuar trafikun. Në rastin e dytë, duke përdorur Peerings Virtual bëhet e mundur për të përcjellë trafikun në rrugë interdomain me një vonesë më të ulët. Ne krahasim me vonesën e marrë në rrugë të zgjedhura nga BGP të vërtetë (genuine) dhe rrugët e marra duke përdorur Peerings Virtuale tregohet se më shumë se 40% të palëve burim / destinacion ishte e mundur një përmirësim i vonesës. Kjo është në përputhje me punën paraardhëse nga Savage et al që tregojnë se 30-80% e shtigjeve fund-me-fund mund të përfitojnë nga një përmirësim i dukshëm në cilësinë e duke përdorur një rrugë alternative [SCH + 99].

Kapitulli IV

Voice Over IP – VOIP

4.1 Hyrje

Në ditët e sotme termi “Voice over IP” përfshin të gjitha mënyrat e mundëshme të realizimit të një bashkëbisedimi zanor përmes Internetit. Një bisedë e tillë mund të arrihet shumë thjesht përmes harduer dhe softuer përkates (psh. një komunikim në MSN ose Skype përmes një seti kufjesh dhe mikrofi).

Interesi mbi VoIP është rritur në mënyrë të vazhdueshme vitet e fundit por projektimi i një rrjeti VoIP kërkon një planifikim të kujdeshëm në mënyrë që të sigurohet ruatja e kualitetit të zërit në nivele të përshtatshme.

Në formën më të thjeshtë një komunikimi VoIP në ditët e sotme, mund të paraqitet si më poshtë:




Figura 4.1: Komunikimi VoIP

Sipas figurës më sipër kompjuterat, celularët, PDA-të etj. shërbejnë si terminalë IP dhe telefonatat mund të vendosen ndërmjet dy terminaleve IP, ndërmjet një terminali IP dhe një telefoni analog tradicional dhe anasjelltas. Skenarët e mësipërm të komunikimit bëhen të mundur vetëm në se zëri konvertohet nga analog në shifror tek ana e folësit, në mënyrë që të transmetohet në rrjetat IP, dhe anasjelltas tek dëgjuesi i informacionit zanor. Konvertimi nga analog në shifror arrihet përmes një procesi kampionimi dhe kuantizimi

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

të cilët implementohen në koduesit e VoIP. Nga ana e dëgjuesit informacioni zanor kthehet nga shifror në analog përmes procesit të dekodimit.

Nisur nga sa thamë, figura e më poshtme jep në terma të përgjithëshme skemën e një aplikacioni VoIP:




Figura 4.2: Skema e aplikacionit VoIP

Disa nga përbërësit kryesorë të VoIP mund të renditen si më poshtë:

- Nje burim audio, si psh. zëri i njeriut, një regjistrim zanor etj. dhe një konvertues i këtij informacioni zanor në një sinjal elektrik të vazhdueshëm dhe anasjelltas, si psh. një set me mikrofon dhe kufje.
- Një pajisje kampionuese dhe enkoduese në mënyrë që sinjali analog të mund të transportohet në një rrjet me të dhëna në formë paketë. Enkodimi dhe dekodimi i kampionëve të zërit ka hapur rrugën për krijimin e një sërë algoritmesh kodimi dhe dekodimi që njihen me emrin *codecs* (*kodues*) të projektuar me synimin për të përmirësuar parametra të ndryshëm si: përdorimi i kapacitetit në mënyrë efikase ose përshtatja me kushtet e ndryshueshme të kanalit.
- Media Transport Protocol (MTP) që bën të mundur transportimin e kampionëve të koduar në rrjetin e të dhënave. Në Internet, protokollin i zgjedhur për këtë qëllim është Real-time Transport Protocol (RTP) [22]. Kampionët e zërit enkapsulohen në RTP dhe UDP para se të dërgohen në formën e një *IP frame*.
- Një multipleksor që bën të mundur multipleksimin e disa *frame* në të njëjtën paketë duke reduktuar numrin e kokave MAC, të rrjetit dhe të transportit me kosto rritjen e vonës në transmetim. Pjesa e të dhënave të paketës VoIP është në thelb një enkapsulim në paketa RTP/UDP/IP.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

- Një *playout buffer* i cili detyron *frame*-t tek marrësi që të dekodohen në të njëjtin interval në të cilin janë enkoduar tek dërguesi. Për këtë arsye mund të bëjë rirenditje, vonesë ose dhe hedhje paketash që vijnë përtej kohës së pritur.
- Protokoll për manaxhimin e sesionit që nevojitet për të ngritur, negociuar dhe mbyllur seksionet ndërmjet palëve komunikuese. Një protokoll i tillë është SIP (Session Initiation Protocol) [23].
- Aplikacioni VoIP që përcakton qëllimin për të cilin informacioni zanor po transmetohet, si psh. në se kërkohet komunikimi mes dy njerëzve atëherë mund të përdoren aplikacione si Skype, MSN etj.
- Nyje të specializuara rrjeti të nevojshme për funksionimin e saktë të protokolleve të mësipërme dhe të arkitekturës komunikuese. Këto nyje kryejnë funksione të tipit: identifikimi i përdoruesve përmes identifikuesit të tyre VoIP, ruajtja e preferencave të përdoruesve, përkthimi i *codec* të përdorur nga njëra palë në atë të përdorur nga pala tjetër, etj

4.2 Pritshmëria ndaj aplikacioneve VoIP në rrjet

Përdoruesit e kanë kërkesat e tyre ndaj cilësisë në lidhje me telefonatat VoIP. Në mënyrë që këto kërkesa të vlerësohen nevojitet të përcaktohen shpjegimet e mëposhtme në lidhje me çfarë nënkupton QoS:

1. Aftësitë për, ose klasat e përcaktuara për të arritur, manaxhim preferencial të tipave të ndryshëm të trafikut në një rrjet *packet-switching*. Veçanërisht në gjuhën e Internetit QoS nënkupton përcaktimin e një klase preferenciale shërbimi të cilës i vihet në përkatësinë e transmetimit të caktuar. Klasa krijohet nga specifikimi i aftësive të veçanta të rrugëzimit që i vënë në dispozicion një tipi të caktuar trafiku prioritar përdorimin e gjerësisë së mundëshme të brezit.

2. *Cilësia vetiake e shërbimit (Intrinsic QoS)*. Kur trafiku kalon nëpër një rrjet *packet-switching*, me apo pa zbatimin e QoS, trafiku fiton një nivel të matshëm performance nën nivele të ndryshme kërkesë. Siguruesi i shërbimit mund të masë karakteristikat e trafikut pa patur nevojë ti referohet perceptimit të klientit për cilësinë. Këto karakteristika që konsiderohen vetiake janë:

- *Latenca* - koha që i duhet paketës për të arritur në destinacion
- *Jitter* – ndryshueshmëria në latencë të paketave
- *Niveli i paketave të hedhura* - frekuenca me të cilën paketat nuk e arrijnë destinacionin në kohë për tu përdorur.

Për çdo klasë trafiku këto karakteristika do të varen nga gjerësia e disponueshme e brezit dhe nga niveli i kërkesës.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

3. *Kualiteti i perceptuar i shërbimit*. Nënkupton cilat janë rezultatet pas përdorimit të rrjetit dhe përcaktohet nga çfarë shikon përdoruesi si rrjedhojë e *QoS veti*ake, gjatë aktiviteteve të komunikimit, dhe si reagojnë ndaj kësaj në përputhje me pritshmëritë e tyre.

Përcaktimi i këtij kualiteti të perceptuar fillon pikërisht nga përshkrimi i shqetësimeve të përdoruesit në lidhje me QoS. Përdoruesi diskuton kualitetin e asaj që dëgjon duke shtruar çështjet e kuptueshmërisë së fjalëve, efektit eko, natyralitetin e zërit, ruajtjen e intonacioni, etj.

Marrëdhënia ndërmjet kualitetit të perceptuar të shërbimit dhe atij veti ak përkundrejt cilësisë së lidhjes do të përcaktohet nga tre karakteristika kryesore të sistemit:

1. *Koduesi i zërit (kodues/dekodues)*, përcakton mënyrën se si sinjali zanor konvertohet në shifror për transmetim
2. Skema e paketizimit, përcakton gjatësinë e segmenteve të të dhënave zanore të transmetuara në çdo paketë dhe madhësinë në *bit*-e të kokave të paketave.
3. Madhësia e *jitter buffer*, që përcakton aftësinë për të rifituar sinjalin original kundrejt ndryshimeve në vonesat në transmetim.

Ajo çka i vështirëson punët për VoIP është se për të vlerësuar shërbimin e ofruar, kundrejt këtyre shqetësimeve, një përdorues përdor eksperiencat e mëparëshme të tija në transmetim zëri, që shpesh nënkupton se përdor si bazë krahasuese eksperiencën me telefoninë tradicionale. .

Përvç çështjeve që kanë të bënë me cilësinë e asaj që dëgjohe (cilësinë e zërit), perceptimi mbi cilësinë e shërbimit nga ana e një përdoruesi përfshin dhe karakteristikat e mëposhtme të shërbimit:

- *Aksesueshmërinë*, aftësinë për të filluar një lidhje kur dëshirohet;
- *Shpejtësia e rrugëzimit*, shpejtësia me të cilën vendoset lidhja;
- *Besueshmëria e lidhjes*, besueshmëria e procesit të vendosjes së lidhjes;
- *Besueshmëria e rrugëzimit*, besueshmëria e procesit të rrugëzimit të lidhjes në destinacionin e duhur;
- *Vazhdueshmëria e lidhjes*, aftësia për të mbajtur një lidhje me cilësi deri kur nuk është më e nevojshme;
- *Besueshmëria e shkëputjes*, besimi se përgjigja e sistemit ndaj kërkesës për të ndërprerë njëthrrje dhe gjithashtu dhe procesin e faturimit për të.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Kuptohet që përdoruesi nuk i referohet këtyre karakteristikave në formën e lartpërmendur por përmes pyetjeve të tipit: “sa kohë duhet që të kuptoj se lidhja është vendosur dhe a është kjo kohë e parashikueshme?”, “A do qëndrojë lidhja ime e ngritur deri sa të vendos unë ta mbyll?”, etj.

4.3 Koduesit e zërit

Transformimi i zërit analog në kampionë diskretë të koduar dhe që mund të transportohen në një rrjet paketash është një process i komplikuar. Një pjesë e informacionit gjatë konvertimit të informacionit original humbet dhe nuk mund të rekuperohet më (siç tregohet dhe në figuren më poshtë).




Figura 4.3: Skema e aplikacionit VoIP

Për këtë arsye është e rëndësishme që të zgjidhet rendi i përshtatshëm i kampionimit dhe shkalla e përshtatshme e kuantizimit me që ato ndikojnë në mënyrë direkte në cilësinë e sinjalit në dalje. Si rrjedhojë janë zhvilluar algoritma të ndryshëm kodimi. Në thelb secili prej tyre duhet të kalojë këto hapa kryesorë:

1. Transformimi i sinjalit të vazhdueshëm, analog në një sekuencë kampionësh diskretë me hapësirë të njëjtë. Rendi i kampionimit përcaktohet sipas Teoremës së Nyquist-it, i cili thotë se në mënyrë që të bëhet e mundur kthimi i sinjalit original nga ai i koduar duhet të kampionohet në një frekuencë të barabartë me dyfishin e gjerësisë së brezit të tij. Edhe pse zëri i njeriut përfshin brezin 0 - 20.000 Hz, zakonisht kufizohet me ndihmën e një filtri në 0-3400 Hz dhe rendi tipik i kampionimit përcaktohet 8000 Hz.
2. Amplituda e kampionëve mund të marrë vlera nga më të ndryshmet. Si rrjedhojë në mënyrë që ti vendoset një vlerë diskrete çdo kampioni e cila më pas do të kodifikohet në një fjalë binare, do të duheshin një numër gjigand bitesh. Për të kufizuar këtë numër përcaktohet një bashkësi vlerash standard dhe gjithë vlerat e ndërmjetme rrumbullakosen në to. Si rrjedhojë e kësaj futet një masë gabimi që njihet me emrin zhurma e kuantizimit. Për ta evituar përdoret kuantizimi jouniform. Kjo nënkupton se vlerat standard për vlera amplitudash të vogla zgjidhen që të kenë më pak diferencë (zhurma e kuantizimit ndjehet më shumë në rastin kur përdoren tonalitete të ulëta të zërit dhe amplitudat janë të ulët).
3. Së fundmi, vlera e kampionëve rezultues mund të dërgohen nëpër rrjet.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Koduesit e zërit projektohen sipas standardeve të International Telecommunication Union (ITU) standards, që përcaktojnë se si do të kodohen në rrjedha të dhënash shifrore sinjalet analoge zanore. Projektimi i një koduesi të tillë përfshin përcaktimin e numrit të byte-ve që mund të përfshihen në një paketë zëri dhe rendin e përshtatshëm të bit-ëve të të dhënave në mënyrë që të transmetohet sinjali zanor shifror përmes teknikave të ndryshme të kodimit.. Tabela 3.3 tregon psh. karakteristikat e 3 koduesve më të përdorur për ngritjen e shërbimeve VoIP.

Tabela 5: *Krahasimi i karakteristikave të koduesve të zërit*

Koduesi	Teknika e kodimit	Gjatësia e segmentit të zërit	Data rate (bit/s)
G.711	PCM (Pulse Code Modulation)	0.125	64.000
G.723.1	MP-MLQ (Multiple maximum-likelihood quantization)	30	6.3000
G.723.1	ACELP (Algebraic-code-excited linear prediction)	30	5.3000
G.729	CELP (Code-excited lineas prediction)	10	8.0000

Që të tre këto tipa koduesish bazohen në një rend kampionimi prej 8000-hertz (Hz) për sinjalin analog të zërit. Sidoqoftë, siç tregohet në tabelën më sipër ndryshimet në teknikat e kodimit krijojnë diferenca rrënjësore në gjatësinë e segmentit dhe sasinë e të dhënave të transmetuara. Këto karakteristika nga ana e tyre ndikojnë drejt për së drejti në karakteristikat e sinjaleve zanore të dëgjuesit në përdoruesi në një lidhje VoIP: vonesa dhe besnikëria ndaj sinjalit original.

4.4 Paketizimi

Një tjetër karakteristikë e sistemit që ndikon në mënyrën se si humbja e paketave në rrjet do ndikojë në shtrembërimet në komunikim të perceptuara nga përdoruesi është mënyra se si paketat ndërtohen për transmetim. VoIP përdor “packet-switching” për transmetimin e të dhënave zanore dhe për rrjedhojë bit-ëve të informacionit që do dërgohet ju shtohet informacioni i nevojshëm për rrugëzimin dhe manaxhimin e tyre nëpër rrjet. Informacioni i shtuar njihet si “koka e paketës” (*packet header*) dhe bit-et e informacionit njihen si *payload*. Kjo mënyrë transmetimi krijon një tepriçë informacioni që nga ana e saj rrit nivelin e rendit të transmetimit të të dhënave që duhet arritur për një nivel të caktuar cilësie në transmetim. Kjo bën që madhësia e kokës së paketës të ketë një ndikim të madh në QoS.

4.5 “Jitter buffer”

Në një komunikim VoIP kampionët e zërit duhet të paraqiten tek dekoderi në mënyrë të tillë që kampioni pauses në një rrjedhë informacioni të paraqitet për përpunim në

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

momentin kur dekoderi ka përfunduar me paraardhësin e tij të menjëhershëm. Kjo kërkesë kufizon rreptësisht sasinë e “*jitter*” që mund të tolerohet pa patur boshlliqenë kampionë. Kur *jitter* rezulton në një interval kohe më të madh ndërmjet paketave bartëse të kampjonëve të njëpasnjëshëm se sa koha e nevojshme për të rikrijuar sinjalin analog nga kampioni, dekoderi është i detyruar të vazhdojë funksionimin pa informacionin e kampionit pauses. Kështu efektet e *jitter* do të paqyrohen në një rritje të rendit të paketave të hedhura.

Për të evituar këtë efekt të papëlqyeshëm, dekoduesit janë të pajisur me një *jitter buffer* i cili vendos në rradhë një numër të caktuar segmentesh zëri shifror para dekodimit. Ky *buffer* krijon vonesa të nevojshme qërrjedha e të dhënave të jetë e qëndrueshme.




Figura 4.4: *Manaxhimi i jitter përmes jitter buffer*

Zgjedhja e duhur e tij përcakton marrëdhënien kompromisin ndërmjet rendit të paketave të hedhura dhe rritjes së vonesave në transmetim që përcaktohet nga madhësia se *jitter buffer* (vonesa duhet të jetë Brenda limiteve të toleruara).

4.6 Matja e Cilësisë së VoIP

Cilësia e një thirrjeje zakonisht matet përmes provave subjektive ose monitorimit instrumental. Në metodat e provave subjektive, njerëzve u kërkohet të vlerësojnë cilësinë e shërbimit sipas një procesi të standardizuar dhe të japin një vlerësim, zakonisht 1-5 (vlerësimi MOS), sipas një procesi të standardizuar.

Këto lloj provash kërkojnë shumë kohë si rrjedhojë e numrit të përdoruesve që duhen marë në konsideratë. Kjo është arsyeja pse vitet e fundit i është kushtuar më shumë vëmendje mjeteve të matjeve instrumentale, ku më i përdoruri është Modeli-E, i standardizuar nga ITU-T.

a) *Mean Opinion Score - MOS*

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Bazohet në provat subjektive, ku n jë numri përdoruesish i kërkohet të dëgjojnë një kampion zëri (që i koresponдон një *codec* të caktuar) dhe të japin një vlerësim për informacionin e marë ashtu siç ata e perceptojnë pas transmetimit. Vlerësimi MOS, i përlllogaritur nga mesatarja e vlerësimeve të të gjithë dëgjuesve, lëviz në kufinj të 1 deri në 5 (ku 1 është e papranueshme dhe 5 është shumë e mirë). Një rend tipik i MOS për një thirrje të ranueshme është 3.5 deri në 4.3.

Edhe pse mund të jetë një nga mjetet më të mira të vlerësimit të cilësisë për VoIP, MOS është i vështirë në implementim me që nevojitet ndërhyrja njerëzore. Për këtë arsye, po ITU-T propozoi Modelin-E..

b) Modeli-E

Modeli-E është një mjet planifikimi për vlerësimin e cilësisë së përgjithshme të një rrjeti telefonik. U prezantua nga rekomandimi i ITU G.107 [24] me objektivin për të përcaktuar një vlerësim të cilësisë që përfshin karakteristikat “nga goja-në vesh” të një shtegu fjalimi.

Dalja e një përlllogaritjeje Model-E është një scalar i vetëm, i njohur si faktori R, i derivuar nga vonesat dhe faktorët dobësues të pajisjeve. Pasi ky faktor llogaritet ai mund të lidhet më një vlerësim të përafërt të MOS.

Faktori R llogaritet përmes shprehjes së mëposhtme:

$$R = R_o - I_s - I_d - I_e + A$$

ku R_o përfaqëson raportin sinjali ndaj zhurmës (SNR), I_s përfaqëson kombinimin e gjithë dobësime që ndodhin njëkohësisht në sinjalin zanor, I_d përfaqëson dobësimet e shkaktuara nga vonesat, I_e përfaqëson dobësimet e shkaktuara nga codecs me rend të ulët bitesh, i njohu dhe si faktori i dobësimit të pajisjeve, dhe A është faktori i avantazhit që modelon pritshmëritë e përdoruesit për teknologjinë e përdorur. Për shembull, vlera e A është më e madhe në rrjetat satelitore se sa në ato kabllore me që pritshmëria e klientit për ato satelitore është më e ulët. Vlerat e A lëvizin në intervalin $[0,20]$ dhe vlerat shembull të propozuara nga ITU jepen në tableë si më poshtë, Tabela 3.6:

Tabela 6: Vlerat tipike të faktorit A

Sistemi i komunikimit	Faktori A
Telefonia kabllore	0
Celular në zona me ndërtesa (shumë hope satelitore)	5
Celulari në një makinë në lëvizje	10
Aksesi në zona gjeografike me vështirësi	20

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

arritjeje	
-----------	--

Pas llogaritjes së faktorit R, ekuivalenca midis R dhe MOS mund të përlogaritet si më poshtë:

Tabela 7: Ekuivalenca midis faktorit R dhe MOS

Opinionimi i përdoruesit	Faktori R	Vlerësimi MOS
Shumë i kënaqur	90 - 100	4.3 - 5.0
I kënaqur	80 - 90	4.0 - 4.3
Disa përdorues të kënaqur	70 - 80	3.6 - 4.0
Shumë përdorues të pakënaqur	60 - 70	3.2 - 3.6
Thuajse gjithë përdoruesit të pakënaqur	50 - 60	2.6 - 3.1
Jo e rekomandueshme	0 - 50	1.0 - 2.6

Faktori R do të përdoret për llogaritjen e vlerave të MOS në eksperimentet e simulimit të përshkruara më vonë në këtë tez bazuar në informacionin e mbledhur mbi humbjet dhe vonesat.

Kapitulli V

Ambjenti eksperimental, simulimet dhe rezultatet

5.1 Hyrje

Ky kapitull është kapitull metodologjik sepse këtu do të ngrihet ambienti eksperimental, do të realizohen simulimet dhe merren rezultate. Në këtë tezë, ambienti eksperimental do të realizohet përmes mjeteve dhe mundësive që ofron simulatori i rrjetit Ns-2 duke shfrytëzuar kështu të gjitha të mirat që vijnë nga eksperimentimi përmes simulimit. Për të ngritur këtë ambient nevojitet shkarkimi i kodit burim për Ns-2 dhe të moduleve përkatëse të tij për implementimin e BGP dhe VoIP, si dhe instalimi i tyre. Qëllimi i krijimit të këtij ambienti është që të improvizohet sjellja e këtij protokollit në rrjet për ta përshkallëzuar atë në përmasa më të mëdha reale. Këtu synohet që të krijohet perceptimi se si kryhen proceset e simulimit, si kryhet transferimi i të dhënave dhe se si ndikojnë rifreskimet e kryera të protokollit BGP në performancën e rrjetit. Kodi burim për Ns-2 i përshtatur sëbashku me modulet respektive për vlerësimin e rrjetit për protokollin BGP ku domeini modelohet me nyje që shkëmbejnë komunikimin BGP me njëra tjetrën. Këto nyje janë rutura kufitarë (edge). AS tranzit është e organizuar me një *cluster* dhe me reflektues rrugësh që janë nyjet përkatëse. Kjo topologji gjenerohet nga skedari në hyrje të GT-ITM. Për AS fundor është zgjedhur llogjika e paraqitjes së tyre me nga një nyje. Skema e adresimit është përzgjedhur në trajtën 10.0.\$i.1 për ruterat brenda AS tranzit, ku \$i është numrin nyjes dhe 10.\$j.\$i.1 për ruterat në AS stub, ku \$j përkon me numrin e AS dhe \$i me numrin e nyjes. Konfigurimi i rrjetit realizohet kur agjentët BGP konfigurohen në sejcilën prej nyjeve. Vlerat e intervaleve të *hold timer* dhe *keep-alive timer* janë ato default, agjentët UDP konfigurohen në nyjet dhe trafiku nëpër këto dy nyje kalon sipas tabelave të ndërtuara të rrugëzimit. Pasi bëhet konfigurimi i nyjeve, hapi pasues është përcaktimi i ngjarjeve të skeduluara. Në këtë simulim duam të shikojmë kohët e konvergencës të tre ruterave të përfshirë në komunikim që janë n15, n3 dhe n2. Ngjarjet skedulohen. Ngjarja e fundit është realizuar me synimin për të parë sjelljen e sistemit në një situatë kur një rrugë shfaqet dhe shkëputet vazhdimisht brenda një kohe të shkurtër (rute flapping).

Në këtë mënyrë do të vërehet në se ka humbje apo vonesa në paketa gjatë momentit të rifreskimit të tabelave të rrugëzimit BGP. Pas përfundimit të simulimeve elementi i parë që merret në konsideratë është numri i paketave të humbura para se të skedulohet ngjarja e paqëndrueshmërisë dhe pas skedulimit të kësaj ngjarjeje.

5.2 Simulimet

Modelimi i sistemit i referohet veprimit të paraqitjes të një sistemi aktual në mënyrë të thjeshtëzuar. Ekzistojnë dy mënyra kryesore për të realizuar një modelim sistemi: mënyra analitike dhe ajo me simulime.

Në modelimin analitik synohet të arrihet një përshkrim matematik i sistemit. Në se zbatohet saktë, ky modelim mund të jetë efektiv nga kostoja dhe të sigurojë një vështrim abstrakt të komponentëve që ndërveprojnë me njëritjetrin në sistem.

Në modelimin me simulator kërkohet më pak abstraksion në model (dhe më pak supozime thjeshtëzuese) me që pothuajse çdo detaj i sistemit mund të përfshihet në simulim. Ky lloj modelimi është i përshtatshëm për sistemet e mëdha ku një formulim i drejtpërdrejtë matematik nuk mjafton. Si dhe modelimi analitik, modelimi me simulatorë mund të lërë pa përfshirë disa detaje me që në të kundërt do kishim një simulim të pamanxhueshëm dhe do kërkohej aftësi e lartë përpunimi.

Një simulim mund të mendohet si një proces rrjedhes të entiteteve të rrjetit (psh. Nyjet, paketat etj.) Ndërsa entitetet lëvizin nëpër sistem, ato ndërveprojnë me entitete të tjera, i bashkohen disa aktiviteteve, trigerojnë ngjarje, i shkaktojnë disa ndryshime gjendjes së sistemit dhe dalin nga procesi. Herë pas here ato garojnë ose presin për një burim të caktuar. Kjo implikon që duhet të ketë një sekuencë llogjike ekzekutimi që të shkaktojë ekzekutimin e këtyre veprimeve në mënyrë të kuptueshme dhe të manaxhueshme. Një sekuencë ekzekutimi luan një rol të rëndësishëm në supervizimin e simulimit dhe ndonjëherë përdoret dhe për të karakterizuar tipin e simulimit.

5.2.1 Elementet e simulimit

Elementet kryesore të simulimit janë si më poshtë:

- *Entitetet* – Objektet që ndërveprojnë me njëritjetrin në një program simulimi për të shkaktuar ndryshime të gjendjes të sistemit. Entitetet dallojnë nga atributet që i vihen në përkatësi.
- *Burimet* – Këto janë zakonisht burimet që ndahen mes një grupi burimesh
- *Aktivitetet dhe ngjarjet* – Herë pas here entitetet përfshihen në disa aktivitete që krijojnë ngjarje dhe trigerojne ndryshime në gjendjen e sistemit (psh. Aktiviteti i pritjes në rradhë)
- *Skeduleri* – skeduleri mban listën e ngjarjeve dhe kohën e ekzekutimit të tyre
- *Variablat globalë* - Janë të kapshme nga çdo funksion ose entitet në sistem dhe mbajnë informacion mbi dia nga vlerat e përgjithshme të simulimit (psh. Numri total i paketave të transmetuara, gjatësia e rradhës së paketave etj.)

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

- *Gjeneratori* i numrave të rastësishëm (RNG – Random Number Generator) – Shërben poëpr të krijuar procese random përmes variablave random dhe marrjen kështu të të dhënave statistikore.
- *Mbledhësi i statistikave* – ka si qëllim kryesor mbledhjen e të dhënave nga simulimet.

5.2.2 Simulimet që varen nga koha

Janë simulime që vijnë në mënyrë kronologjike me ndihmën e një ore simulimi. Simulimi vazhdon deri sa ora arrin një vlerë të caktuar limit. Këto simulime mund të ndahen më tutje në: Simulime që drejtohen nga koha dhe Simulime që drejtohen nga ngjarjet.

Simulimet që drejtohen nga koha - Koha e simulimit avancon ekzaktësisht me një interval fiks njësisht kohe. Pas çdo avancimi të orës kontrollohet në se ka patur një ngjarje në këtë interval, në se po atëhere kjo ngjarje konsiderohet sikur ka ndodhur në fund të intervalit. Kjo përbën një problem në rastin kur ndodh më shumë se një ngjarje për interval me që duhet një procedurë për të përcaktuar se kush ngjarje duhet të ndodhi e para. Për lëtë arsye lëto simulime nuk këshillohen në rastet kur ngjarjet ndodhin në periudha të rastësishme kohore.

Simulimet që drejtohen nga ngjarjet - Ndryshe nga e para, avancimi I simulimeve bëhet nga një ngjarje në tjetrën dhe jo nga një interval në tjetrin. Ngjarjet zhvillohen sipas një rendi dhe koha midis dy ngjarjeve nuk është e njëjtë. Ndërkohë që simulimi avancon, një ngjarje mund të shkaktojë një ngjarje tjetër e cila do përfshihet në mënyrë kronologjike në zinxhirin e ngjarjeve ekzistuese. Simulimi vazhdon deri sa të përfundojë gjithë lista e ngjarjeve të përcaktuara ose deri sa të mbarojë koha e ekzekutimit.

5.3 Simulatori i Rrjetit 2 (Network Simulator 2 – ns2)

Ns-2 [25] është një simulator i drejtuar nga ngjarjet që mundëson studimin e natyrës dinamike të rrjetave kompjuterike. Falë fleksibilitetit dhe modularitetit ka fituar një popullaritet të madh në komunitetin kërkimor të rrjetave që nga lindja në 1989. Që nga atëhere janë bërë shumë rishikime të këtij mjete simulimi dhe ndër kontribuesit kryesorë mund të përmendim University of California dhe Cornell University të cilët zhvilluan bazat e këtij simulatori. Në këtë tezë është implementuar ns-BGP si një shtesë ndaj versionit të parafundit të simulatorit të rrjetit ns2-2.34. Duhet theksuar se mbi këtë shtesë është aplikuar një shtesë e dytë me emër ns-2.34-bgp 2.0 fild mrai. Kjo e fundit i shton funksionalitetin e Route Flap Damping si dhe Adaptive Minimal Route Advertisement Interval. Ns-2 është zhvilluar fillimisht në ISI (Universitetin e Kalifornisë së Jugut). Qëllimi kryesor i krijimit ishte si një shtesë ndaj simulatorit të rrjetit REAL. Ns-2 është

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

momentalisht pjesë e projektit VINT duke përfshirë USC/ISI, Xerox PARC, LBNL dhe UC Berkeley.

Si një nga simulatorët e eventeve diskretë më popullore, ns-2 suporton simulimin e TCP, rrugëzimeve dhe protokolleve *multicast* mbi rrjete me kabëll ose satelitorë. Ns-2 është shkruar si në C++ ashtu edhe në OTcl dhe suporton modelet e orientuara nga objekti. C++ përdoret për implementimin në nivel të ulët të procesimit të orientuar të paketave, ku performanca është më e rëndësishmja. OTcl është një gjuhë skriptimi për implementim të një niveli të lartë, ku fleksibiliteti është më i rëndësishëm. Një animator grafik i quajtur *nam* përdoret për të vizualizuar rezultatet e simulimit. Ai i kryen simulimet falë NAM dhe gjuhës së skriptimit AWK.

-NAM përfaqëson interpretuesin vizual të topogjisë së rrjetit duke kryer ekzekutime të drejtpërdrejta të skripteve Tcl.

-AWK nga ana tjetër është gjuhë programimi procesimi testesh.

5.3.1 Arkitektura e NS2

Arkitektura bazë për NS2 jepet në **Figura 5.1**. NS2 i ofron përdoruesve një komandë ekzekutimi ns e cila mer si argument një skript simulimi Tcl.

NS2 konsiston në dy gjuhë kryesore: C++ dhe *Object-oriented Tool Command Language* (OTcl). Ndërsa C++ përcakton mekanizmat e brendëshëm të objekteve të simulimit, Otcl ngre simulimin përmes assemblimit dhe konfigurimit të objekteve si dhe skedulimit të ngjarjeve diskrete. C++ dhe Otcl lidhen me njëra tjetrën përmes TclCl. Kur lidhen me një objekt C++, variablat në fushën OTcl njihen si 'doreza' (handle). Nga aspekti konceptual një 'dorezë' (psh n si doreza e Nyjes) është thjesht një stringë në fushën OTcl dhe nuk përmban asnjë funksionalitet. Funksionaliteti është i përcaktuar në objektin C++ të lidhur me të (psh. klasa Lidhës). E thënë në një gjuhë më të thjeshtë 'doreza' në fushën e OTcl mund të konsiderohet si pjesa e përparme (frontend) që ndërvepron me përdoruesit dhe objektet e tjera OTcl. Ajo mund të përcaktojë procedurat dhe variablat e veta për të lehtësuar ndërveprimin.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 5.1: Arkitektura Bazë e ns-2

Pas simulimit NS2 nxjerr rezultatet në format teksti ose të animuar. Për ti interpretuar këto të dhëna grafikisht janë krijuar mjete si NAM (Network Animator) dhe *XGraph*. Për të analizuar një sjellje të caktuar të rrjetit, përdoruesit mund të nxjerrin një nënbashkësi të të dhënave në format teksti dhe ti transformojnë ato në një format më të kuptueshëm.

Klasat ns-BGP janë derivuar nga hierarkia ekzistuese e klasave ns-2. Si fillim do japim një përshkrim për strukturën e rrugëzimit *unicast* të simulatorit ns-2. Bazuar në këtë strukturë, do të përshkruajmë strukturën e ns-BGP së bashku me funksionalitet e tjera që ajo suporton. Për të rritur cilësinë e shërbimit (QoS), disa prej skedarëve janë modifikuar për të suportuar RFD. Kjo ndikon: 1) rrit stabilitetin dhe 2) rrit konvergencën e rrjetit.

5.3.2 Direktoritë e NS-2

Le të supozojmë se NS2 është instaluar në direktorinë *nsallinone-2.34*. **Figura 5.2** tregon strukturën e direktorive nën direktorinë *nsallinone-2.34*. Direktoria *nsallinone-2.34* është në nivelin e parë. Në nivelin e dytë, direktoria *tclcl-1.1.19* përmban klasat në TclCL (psh. Tcl, TclObject, TclClass).

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 5.2: *Struktura e direktorive të ns2*

Në nivelin e tretë, modulet në hierarkinë e interpretuar janë nën direktorinë tcl. Më të përdorurit mes këtyre moduleve janë ns-lib.tcl, ns-node.tcl, ns-link.tcl etj. nën direktorinë lib të nivelit 4.

Modulet e simulimit në hierarkinë e kompiluar janë të klasifikuara në direktoritë e nivelit 2. Psh. Direktoria Tools mban klasa të ndryshme ndihmëse si gjeneratorët e variablave të rastësishëm. Direktoria Common, përmban modulet bazë që lidhen me avancimin e paketaave si simulatori, skeduleri, lidhësi dhe paketa.

5.3.3 Përdorimi i ns2

Përdorimi i ns2 kalon nëpër disa faza që përshkruhen dhe në figurën e mëposhtme:

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 5.3: Hapat e përdorimit të ns2

Siç duket dhe nga figura hapi i parë është ai i përcaktimit në mënyrë të qartë të problemit që do trajtohet përmes simulimeve.

Në rastin konkret synohet të tregohet se momentet e rifreskimit të BGP vërtet mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit të thirrjeve VoIP. Për të zgjidhur këtë problem, hapi është evidentimi i modelit të simulimit. Ky model, si çdo ta trajtojmë dhe më vonë, përfshin modelimin e topologjisë, trafikut, të dhënave dhe skenarëve të simulimit. Secili nga këto modele mund të kërkojë implementimin e moduleve të reja në ns2. Paketa bazë e ns2 jo gjithmonë i përgjigjet kërkesave tona për simulim.

Pasi të jenë evidentuar modelet përkatëse dhe modifikimet e nevojshme për ns2 mund të kalohet në hapin pauses që ka të bëjë me realizimin e simulimeve. Siç kemi thënë dhe më sipër, kjo nënkupton krijimin e skedarëve përkatës tcl dhe ekzekutimin e tyre në ndprfaqen e ns2 përmes komandës `ns <skedar.tcl>`.

Për të parë rezultatet e simulimit gjenerohen skedarë me prapashtesën `.nam` që ekzekutohet përmes si një mjet grafik për vizualizimin e rezultateve të simulimit. Gjithashtu gjenerohen skedarët `.tr` (*trace file*) të cilët mundësojnë informacion më të plotë mbi simulimin, sipas figurës më poshtë:




Figura 5.4: Objektet e regjistrimit në një link

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Tipi i fundit i skedarëve përbën një bazë shumë të mirë për nxjerrjen e rezultateve në kontekstin e vonesave dhe humbjes së paketave.

5.4 Modeli i simulimit

Kërkuesit që kërkojnë që përmirësojnë disa aspekte të funksionimit të Internetit shpesh i provojnë hipotezat e tyre duke përdorur disa forma simulimi por, të simulosh Internetin, nuk është aspak e thjeshtë. Diversiteti në administrimin teknik të tij, rritja e vazhdueshme dhe ndryshimet e vazhdueshme në kohë për sa i përket përdorimit të aplikacioneve, paraqesin vështirësi të pafundme për simulimin.

Analiza e aplikacioneve specifike është gjithashtu kuptimpolotë për ambjentet inter-domain, veçanërisht aty ku fokusi është në sjelljen e aplikacioneve që QoS ju varet nga ngarkesa inter-domain dhe vonesat. Kjo lloj analize në simulime nënkupton nevojën për modelim strukturor të aplikacionit dhe analiza në varësi të ngarseës e vonesave (modeli i të dhënave). E thënë ndryshe, kjo lloj analize kërkon përcaktimi i skenarëve për një simulim në kohë reale.

Të gjitha këto sa janë thënë më sipër mund të përmbliken në paragrafin e mëposhtëm:

Ambjenti i modelimit dhe simulimit bazohet në abstraksionin e përgjithshëm për trafikun inter-domain, QoS, topologjinë dhe rrugëzimin dhe teknika të ndryshme simulimi që përzgjidhen në përputhje me kërkesat.

Siç është përmendur në kapitullin e mëparshëm, studimet përmes simulimeve (në astin konkret në ambjentin e simulatorit të rrjetit ns2) kërkojnë ndjekjen e disa hapave themelorë, në funksion të një zhvillimi normal të studimit.

Pasi përcaktohet qartë problem që do trajtohet nevojitet të kalohet në fazën e modelimit dhe më pas të simulimit.

Në figurën më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur hapat që do të ndiqen për të realizuar procesin e modelimit dhe simulimit:

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 5.5: Diagrama rrjedhëse e metodologjisë së simulimeve

Sipas kësaj diagrame, hapi i parë është pikërisht modeli i cili përfshin:

- Modelimi i rrjetit – Ndërtimi i topologjisë së rrjetit dhe rrugëzimit
- Modelimi i të dhënave – Përcaktimi i karakteristikave të trafikut

Me të përcaktuar këto modele, marrëdhëniet ndërmjet elementeve të rrjetit dhe të dhënave përkatëse për çdo element, përftohet gjendja e rrjetit. Nga këtu, hapi pausës është vlerësimi i performancës, që përllorarit vlerat e QoS për rrjetin në studim.

Me të gjeneruar një pamje të performancës për një gjendje të caktuar rrjeti, realizohet një analizë e tipit “çfarë ndodh në se”, kjo analizë synon të evidentojë ndryshimet në vlerat e QoS kur ndryshohen komponentet e modelit të rrjetit ose të të dhënave.

5.5 Ndërtimi i modelit të rrjetit

Një rrjet karakterizohet nga dytribute kryesore: Topologjia dhe Rrugëzimi. Vetë rrjeti mund të paraqitet si një bashkësi nyjesh që ndërlidhen me njëra-tjetrën përmes linjave të komunikimit (link). Topologjia i referohet ndërlidhjes së nyjeve me njëra-tjetrën ndërsa rrugëzimi i referohet shtegjeve që ndiqen nga pëaketat për të kaluar nga një burim në atë destinacion. Përcaktimi i topologjisë dhe algoritmit të përshtatshëm të rrugëzimit kanë një ndikim të madh mbi performancën e shumë algoritmeve.

5.5.1 Topologjia e rrjetit

Simulimet e rrjetit ndikohen nga topologjitë e përdorura në simulim. Ky fakt qëndron he për simulimet e BGP ku forma dhe përmasat e topologjisë ndikojnë direkt në sjelljen e simulatorit. Përdorimi i topologjive të rrjetit BGP sa më reale është një element i rëndësishëm që ndikon në sjelljet e BGP në rast paqëndrueshmërisht.

Në pjesën më të madhe të simulatorëve të BGP topologjitë e përdorura janë ofrojnë abstraksion në nivel **Sistemi Autonom**. Nyjet e këtyre topologjive përfaqësojnë AS dhe topologjia komplekse e ruterave brenda AS-ve abstragohet në një ruter të vetëm që manaxhon komunikimin në këtë AS. Kjo lloj topologjie përftohet nga informacionet e nxjerra nga tabelat e rrugëzimit të BGP. Përpunime të mëtejshme mund ta ndajnë AS në AS të ndryshme llogjike të cilat do të përdoren për të paraqitur kompleksitetin e rrjetit brenda AS fillestare.

Modeli i topologjisë që do të përdoret në këtë punim synon që të riprodhojë sa më shumë të jetë e mundur paqëndrueshmëritë reale të internetit të sotëm. *Për këtë arsye është zgjedhur të përdoret një tip topologjie më afër realitetit, që mundëson paraqitje në nivel ruteri.*

Kjo lloj topologjie përdor ruterat (folësit BGP) si nyje elementare të të çdo AS-je. Këta folësa janë të lidhur me njëri tjetrin dhe sigurojnë lidhje ndërmjet AS-ve. Në këtë mënyrë nuk ka nevojë të krijojmë AS logjike. Topologjia është më reale. **Figura 5.2.1** më poshtë ilustron dallimin ndërmjet këtyre dy topologjive.




Figura 5.6: *Topologjia në nivel AS dhe topologjia në nivel ruteri*

Duke iu referuar kapitullit të dytë në këtë punim, Interneti përfaqësohet nga një hierarki që në dy nivelet kryesore të saj paraqitet përmes domain fundor dhe atyre tranzit. Topologjia e përzgjedur bazohet pikërisht në paraqitjen e këtyre dy niveleve kryesore të hierarkisë. Për të parë ndikimet që kanë rifreskimet e BGP në cilësinë e shërbimit të rifreskimeve VoIP fokusi kthehet tek folësit BGP që bëjnë të mundur komunikimin e

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

domaineve fundore me ato tranzit, të domaineve tranzit me njëri tjetrin apo domaineve fundore me njëri tjetrin.

Në vitet e fundit janë zhvilluar mjete të ndryshme që mundësojnë zhvillimin e modeleve për topologjinë e Internetit (gjeneratorë topologjie) dhe që përpiqen të paraqesin karakteristikat kryesore (nyjet dhe rrugëzimin) në mënyrë që të sigurojnë një ambient eksperimental sa më afër realitetit. Një gjenerator i mirë topologjie duhet të jetë i aftë të përfaqësojë këto karakteristika në mënyrë që topologjia e gjeneruar të jetë e ngjashme me atë të Internetit dhe rrugët të jenë të ngjashme në natyrë me ato të përshkuara në Internet.

Për të modeluar topologjinë në këtë punim do të përdoret gjeneratori i topologjive GT-ITM i cili i përbëhet nga specifikimeve të përmendura më sipër.

5.5.2 Struktura njëdrejtimore e rrugëzimit ns-2

Struktura e rrugëzimit *unicast* përbëhet nga dy plane: 1) atë të kontrollit dhe 2) atë të *forward*-imit. Në figurën 3.1 komponentët e planit të kontrollit janë të përfshira nga një trapezoid, ndërsa ata të planit të *forward*-imit janë qarkuar me një elips.

Plani i kontrollit ka për detyrë përlllogaritjen e rrugës, krijimin dhe mirëmbajtjen e tabelës së rrugëzimit. Gjithashtu, ajo implementon edhe algoritme specifike rrugëzimi. Komponentët kryesorë të planit të kontrollit janë: 1) llogjika e rrugës (*route logic*), 2) objekti i rrugës (*route object*), 3) entiteti i rrugës (*route peer*) dhe 4) protokollin e rrugës (*route protocol*).

1) Llogjika e rrugës është tabela qendrore e krijuar dhe që mirëmbahet për rrugëzim.

2) Objektet e rrugës përdoren vetëm në rastet e simulimit të rrugëzimeve dinamike. Objektet e rrugës që i shoqërohen një nyjeje sillen si koordinatorë për instancat e rrugëzimit të nyjes.

3) Një objekt i entitetit të rrugës vepron si një objekt mbajtës nga *protokolli i rrugëzimit*: ai ruan adresën e entitetit, metrikën si dhe preferencën për çdo rrugë të lajmëruar nga entiteti.

4) Protokollin e rrugëzimit implementon algoritme specifike rrugëzimi, si psh algoritmat vektor distance (*Distance Vector*) ose gjëndja e lidhjes (*Link State*).

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 5.7 – Struktura njëdrejtimore e rrugëzimit në ns-2

Plani i *forward*-imit është përgjegjës për klasifikimin dhe *forward*-imin e paketave drejt nyjeve destinacion. Ai përfshin tipe të ndryshëm të klasifikuesve të lidhur si dhe të moduleve të rrugëzimit. Klasifikuesit (*classifier_*) dërgojnë paketat hyrëse ose në agjentin e duhur dalës ose drejt linjës dalëse. Moduli i rrugëzimit menaxhon klasifikuesin e nyjes dhe siguron një ndërfaqe për planin e kontrollit. Klasifikuesi i adresës (*classifier_*) dhe klasifikuesi i portës (*dmux_*) janë dy tipe të klasifikuesve në nyjen unicast të ns-2. Një *classifier_* ekzaminon adresën destinacion të paketës hyrëse dhe e çon përpara drejt *dmux_* nëse nyja është paketa destinacion. Në të kundërt, *classifier_* e dërgon paketën në një nyje më tutje. *dmux_* çon përpara paketën tek një agjent korrespondues me numrin e portës të paketës destinacion.


5.6 Struktura njëdrejtimore e rrugëzimit ns2-BGP

Nyja ns-BGP është bazuar në strukturën njëdrejtimore të rrugëzimit ns-2 si dhe në modelin SSF.OS.BGP4 të simulatorit SSFNet. Është importuar modeli SSF.OS.BGP4 në ns-2 dhe i janë shtuar funksionalitete si: shtresën *socket*, adresimin IPv4 dhe skemat e *forward*-imit të paketave.

Në mënyrë që të sigurojë mbështetje në nivel *socket* dhe në të njëjtën kohë të ruajë strukturën e SSF.OS.BGP4, gjithashtu u importua ns-2 *TcpSocket*, implementimi në nivel *socket* i SSFNet. Në mënyrë që të suportojë adresimin IPv4 dhe tejçimin përpara të paketave, klasifikuesi bazik i adresave është zëvendësuar me një të ri me emër *IPv4Classifier*. Për të suportuar transmetimin e të dhënave user, u modifikua *FullTcpAgent*, i cili është agjenti TCP për *TcpSocket*.

Në figurën 3.2 shfaqet struktura njëdrejtimore e rrugëzimit për ns-BGP. Klasifikuesi i adresave *classifier_* është *IPv4Classifier*. Një modul i ri rrugëzimi *rtModule/BGP* menaxhon *IPv4Classifier* dhe shërben si një zëvendësues për modulin bazë të rrugëzimit *rtModule/Base*. *TcpSocket* është shtuar tek *FullTcpAgent* i modifikuar, duke përfshirë shërbimet TCP në një ndërfaqe *socket*. Një protokoll i ri rrugëzimi *rtProtoBGP* bazohet në *TcpSocket* për transmetimin e paketave. *rtProto/BGP* ka nga një *PeerEntry* për çdo entitet. *PeerEntry* hap edhe mbyll një sesion komunikimi ndërmjet entiteteve si dhe shkëmben mesazhe BGP ndërmjet tyre.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri



Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Figura 5.8 – Struktura njëdrejtimore e rrugëzimit në ns2-BGP

Çdo instancë e *PeerEntry* përmban një *AdjIn*, një *AdjOut* dhe një variabël *BGP_Timer*. *LocRIB*, *AdjIn* dhe *AdjOut* korrespondojnë me tre pjesët e Rrugëzimit të Bazës së Informacionit (RIB) të BGP: *Loc-RIB*, *Adj-RIBs-In* dhe *Adj-RIBs-Out*. *BGP_Timer* siguron mbështetje për veçoritë e kohës BGP. Pesë klasat më të rëndësishme të ns-BGP janë: *TcpSocket*, *IPv4Classifier*, *rtModule/BGP*, *rtProtoBGP* dhe *BGP_Timer*.

5.6.1 Klasifikuesi IPv4

Ky klasifikues derivohet nga *Classifier*. Është implementuar si një nga klasat duale të ns-2, si në C++ ashtu edhe në OTcl. Klasifikuesi IPv4 përdor *map* nga libraria standarte e etaloneve të C++, për të ruajtur dhe kërkuar tabelën e rrugëzimit. Për të klasifikuar një paketë të pakompletuar, klasifikuesi IPv4, si fillim ekzaminon adresën destinacion të paketës dhe më pas përkon këtë adresë në tabelën e rrugëzimit të klasifikuesit në mënyrë që të gjejë rrugën me prefiksin më të gjatë të përputhjes.

5.6.2 rtModule/BGP

RtModule/BGP, një modul i ri rrugëzimi i implementuar në Tcl, siguron një ndërfaqe regjistrimi. Kur një nyjë është krijuar, modelet e rrugës aktive duhet të rregjistrohen së bashku me nyjen. Ky rregjistrim zëvendëson objektet klasifikuese ekzistuese në nyje.

5.6.3 rtProtoBGP

Klasa *rtProtoBGP* ose më saktë *Agent/rtProto/BGP* është implementuar si një klasë duale në ns-2. Një pjesë e kësaj klase implementon BGP-4 në një nyje. Ky protokoll i ri rrugëzimi kryen të gjitha operacionet e BGP, si psh: vendosjen e sesioneve ndërmjet entiteteve BGP, mësimi i rrugëve të ndryshme nëpërmjet folësve BGP të brendshëm dhe të jashtëm, zgjedhja e rrugës më të mirë dhe ruajtja e saj në tabelën e *forward*-imit të IP (*IPv4Classifier*) dhe menaxhimi i makinës me gjëndje të fundme BGP.

5.6.4 TcpSockets

Një *socket* është një Ndërfaqe e Programimit të Aplikacionit (API) e përdorur në komunikimin e rrjetave. Aplikacionet *socket* trajtojnë lidhjet e rrjeteve si përshkrues

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

skedarësh UNIX. Njëlloj me skedarët, nyjet fundore të komunikimit mund të shkruhet në to, të lexohen nga to dhe të fshihen.

Klasa *TcpSocket* është një implementim i API të *socket*, njëlloj me implementimet UNIX. Funkzionet kryesore të saj janë: *bind*, *listen*, *connect*, *close*, *read* dhe *write*. Ndërfaja e *TcpSocket* ka përfshirë implementime të thirrjeve bllokuese duke përdorur thirrjet Vazhduese (*Continuation*), një klasë që konsiston në dy funksione rithirrëse: *Success* dhe *Failure*. Struktura të dhënash dhe klasa të nevojshme, si klasat e rradhëve që ruajnë të dhëna dhe klasa *TcpData* që përmban të dhënat që transmetohen të përdoruesve, janë shtuar gjithashtu në ns-2. *FullTcpAgent* u modifikua duke marrë dhe dërguar paketa të dhënash që përmbajnë të dhënat e përdoruesve dhe për të informuar *Tcpsocket*-in korrespondues për ndryshimet në statusin e TCP.

U implementuan thirrjet bllokuese duke përdorur thirrjen *Continuation*, e cila është një mbajtëse e 2 thirrjeve prapavepruese: *Success* dhe *Failure*. Thirrjet e funksioneve bllokuese janë të përdorura gjërësisht në mjediset e programimit të rrjeteve. Për shembull, nëse një funksion përdoruesi është duke dërguar një paketë të dhënash duke përdorur shërbimet *socket*, thirrësi do të bllokohet derisa lidhja me *socket* të arrihet (kthen *Success* te funksioni thirrës) ose dështon (kthen *Failure* te funksioni thirrës). Performanca e rrjetit është shpesh e paparashikueshme, për shkak të bllokimit të trafikut. Në këto raste, thirrësi *Continuation* mund të sinkronizojë funksionin thirrës me atë që thirret.

Strukturat e mëposhtme të të dhënave dhe klasat janë shtuar për të suportuar *TcpSocket* të jetë i aftë me transmetimin e të dhënave të përdoruesve: klasa *SendQueue* që ruan të dhënat të cilat janë kërkuar për tu dërguar nga dërguesi agjenti TCP, klasa *ReceiveQueue* e cila ruan të dhënat e mara nga dërguesi si dhe klasën *TcpData* e cila përmban të dhënat e transmetuara nga përdoruesi.

5.6.5 BGP_Timer

Si klasë *BGP_Timer* është derivuar nga klasa tjetër në ns-2 e cila quhet *TimeHandler*. Kjo klasë ofron suport për veçoritë e kohës të BGP, siç janë kohësi *start-up*, kohësi *keep-alive*, kohësi *hold*, kohësi *Minimum Route Advertisement Intervali* (MRAI). Gjatë procesit të auto-konfigurimit, kohësi *start-up* është skeduluar për çdo agjent BGP. Kur kohësi *start-up* skadon, do të sjellë agjentin BGP (*rtProtoBGP*) që të përpiqet të krijojë lidhje me entitetet fqinjë të BGP. Kur një kohës *keep-alive* skadon, ai do të aktivizojë një agjent BGP që të dërgojë mesazhe të tilla tek entitetet e tjera. Skadencia e një kohësi *hold* tegon për dështimin e një agjenti BGP që të marrë një mesazh gjatë intervalit të kohës *hold* nga një entitet. Në këtë rast, agjenti BGP do të raportojë gabimin tek entiteti fqinj duke dërguar një mesazh të tipit *notification*. Kohësi MRAI përdoret për të zhvendosur me M sekonda (vlera standarte është 30 sekonda) përditësimet të njëpasnjëshme drejt të njëjtit destinacion.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

5.6.6 VecRoutes

Kjo klasë është pjesë përbërëse e shtesës që i ofrohet ns-BGP për ta shndërruar në ns-BGP-rfd. Qëllimi kryesor i saj përfshin krijimin e një vektori me rrugët që gjendet si dhe një grupi me metoda, të cilat do të veprojnë mbi të. Një pjesëtar i kësaj klase përmban një *route* si dhe një numër që i përkon rendit që ze në tabelën e rrugëzimeve *counts*. Funksionet kryesore të implementuara nga ky funksion janë:

1) *add (Route* r)* e cila shton një rrugë të re në tabelë si dhe inkrementon me 1 numrin e *counts*.

2) *clear()* e cila fshin të gjitha *route* nga tabela si dhe reseton *counts* në zero.

3) *find (Route* r)* kjo e fundit kërkon nëse *route-i* i kërkuar ndodhet në tabelën e rrugëzimit dhe nëse ky kusht përmbushet kthen rrugën së bashku me *counts*.

5.6.7 damp_reuse_timer

Qëllimi i kësaj klase është krijimi i një kohësi duke u bazuar në 3 elementë: *rtProtoBGP*, *DampInfo* dhe një kohe *t*, e cila quhet *suppressTime*. Kjo klasë përmban një funksion me të njëjtin emër, i icli thirret kur *suppressTime* skadon dhe përditëson statusin e rrugës që do të shënjohe si e papërdorshme. Në rast se *suppressTime* arrin maksimumin e lejuar atëherë ekzekutohet edhe njëherë procesi i vendimmarrjes për të përcaktuar nëse kjo rrugë do përdoret më apo jo. Dy funksionet e tjera që përmban kjo klasë janë *reset()* e cila e kthen vlerën e këtij kohësi në vlerën 0, si dhe *scheduled()* që tregon nëse kohësi është skeduluar që më parë dhe në këtë rast kthen *true* ose jo dhe kthen *false*.

5.6.8 dampInfo

Kjo klasë përmban një funksion me të njëjtin emër, i cili krijon informacion për heqjen e rruge. Nga parametrat kryesorë që nfikojnë në këtë vendim mund të përmend: *withdrawPenalty*, *changePenalty*, *suppressLimit*, *reuseLimit*, *half_Life* dhe *maxSuppressTime*. Për të parë sesi përdoren këto parametra mund të shohim një shembull si më poshtë:

1) \$bgp_agent0 dampening 0 0 3000 750 900 1000 500 3600

2) \$bgp_agent0 dampening

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Më sipër tregohen 2 komanda konfigurimi që mund të përdoren për të aktivizuar veçorinë *Route Flap Damping* (RFD), për një folës të veçantë BGP. Opsioni 1 do të aktivizojë RFD për një folës të veçantë BGP duke përdorur 8 parametrat e mëposhtëm:

- Parametri i parë shërben për të përcaktuar se cili algoritëm *Damping* përdoret (vetëm 5 vlera mund të përdoren: 0, 1, 2, 3 dhe 4 përkatësisht për *original RFD*, *selective RFD*, *RFD+*, *modified RFD* dhe *combined RFD*)
- Parametri i dytë shërben për të përcaktuar nëse rilajmërimi pas tërheqjes duhet të penalizohet (vetëm dy vlera mund të lejohen këtu: 0, e cila implikon që “rilajmërimi pas tërheqjes NUK penalizohet” dhe 1, e cila implikon që “rilajmërimi pas tërheqjes penalizohet”)
- Parametri i tretë është *suppressLimit* (3000 në rastin tonë)
- Parametri i katërt është *reuseLimit* (750 në rastin tonë)
- Parametri i pestë është *halfLife_dc* (900 sekonda në rastin tonë)
- Parametri i gjashtë është penaliteti për çdo tërheqje rruge (1000 në listën tonë të parametrave)
- Parametri i shtatë është penaliteti për çdo ndryshim në atributet e rrugës (500 në rastin tonë)
- Parametri i tetë është *maxSuppressTime* (3600 sekonda në listën tonë të parametrave)

Opsioni i dytë do të aktivizojë RFD tek një folës i veçantë BGP duke përdorur vlerat standarte. Vlerat standarte për të tetë parametrat janë si më poshtë: 0, 0, 2000, 750, 900, 1000, 500 dhe 3600. Këto më sipër janë vlerat standart të CISCO. Në këtë mënyrë komanda e konfigurimit: “\$bgp_agent0 dampening” është ekuivalente me “\$bgp_agent0 dampening 0 0 2000 750 900 1000 500 3600”.

5.7 Gjeneratori i topologjisë GT-ITM

GT-ITM (Georgia Tech Internet topology models) siç e përshkruan dhe emri, është një gjenerator topologjish për Internetin. Ai implementohet mbi SGB (Stanford Graph Base), një koleksion fleksibël strukturash të dhënash dhe algoritmesh për krijimin, ruajtjen dhe manipulimin e grafeve abstrakte. GT-ITM mbështet krijimin e grafeve rastësorë me disa lloje strukturash si dhe ruajtjen e këtyre grafeve në një format të transportueshëm. Modeli *transit-stub* i GT-ITM synon të krijojë topologji realiste me dy nivele hierarkie dhe pesha të përshtatëshme të ruterave kufitarë në mënyrë që të implementohet një politikë rrugëzimi standarde ndërmjet *domaine-ve*.

GT-ITM lejon që parametrat e grafit të specifikohen në një skedar konfigurimi. Përmes këtij skedari përcaktohen përmasat e grafit si dhe parametra të tjerë që përcaktojnë karakteristikat e grafit. Më poshtë paraqiten parametrat e konfigurueshëm:

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

- *Metoda e gjenerimit të tabelave të rrugëzimit:* Përdoruesi mund të specifikojë modelin e grafit rastësor që gjeneroet (psh. Në rastin konkret ky do të jetë modeli *transit-stub*).
- *Numri i grafeve:* Numri i grafeve që do të gjenerohen (me që grafet e ndërtuara janë rastësore dhe me që modeli i grafit ka një rëndësi të madhe në rezultatin përfundimtar, shpesh lind nevoja të gjenerohet më shumë se një model grafi) .
- *Burimi fillestar:* burimi për gjenerimin e numrave rastësorë për krijimin e grafit
- *Numri i stub domains për çdo transit domain:* Numri mesatar i domein-eve të tipit fundorë që do I lidhen një të tipit transit.
- *Lidhjet rastësore transit-stub:* Lidhje ekstra që shtohen ndërmjet domein-eve transit dhe atyre fundorë.
- *Lidhjet rastësore stub-stub:* Lidhje ekstra që vendosen ndërmjet domeineve fundorë.
- *Probabiliteti i lidhjeve të dyfishta ndërmjet domein-eve tranzit:* Nqs. ky parametër është 1, do të ketë lidhje të dyfishta ndërmjet AS-ve tranzit të lidhura. Çdo numër ndërmjet 0 dhe 1 do të tregojë probabilitetin që një lidhje e dyfishtë të ekzistojë.
- *Numri domein-eve tranzit:* Numri i domeineve që do të shërbejnë si tranzit.
- *Metoda e lidhjes:* Ky parametër specifikon mënyrën e vendosjes së lidhjeve ndërmjet domeine-ve transit (mund të jetë tërësiht rastësore, Waxman 1, Waxman 2, Doar Leslie, Eksponenciale dhe kolakiteti).
- *Dendësia e lidhjeve ndërmjet domein-eve tranzit:* Përcakton dendësinë e lidhjeve të domeineve tranzit. Nqs. Ky parametër merr vlerën një, atëherë çdo domein tranzit është e lidhur me gjithë të tjerët.
- *Numri mesatar i nyjeve në domein tranzit*
- *Metoda e lidhjes:* Ky parametër specifikon mënyrën e vendosjes së lidhjeve ndërmjet nyjeve të domeine-ve transit
- *Dendësia e lidhjeve ndërmjet nyjeve të domein-eve tranzit:*
- *Numri mesatar i nyjeve në domein fundorë*
- *Metoda e lidhjes:* Ky parametër specifikon mënyrën e vendosjes së lidhjeve ndërmjet domeine-ve fundorë
- *Dendësia e lidhjeve ndërmjet nyjeve të domein-eve fundorë*

Grafi i gjeneruar ruhet në formatin e skedarit Stanford Graph Base i cili më vonë mund të konvertohet në format të lexueshëm nga ns2 (kod tcl) përmes konvertuesit përkatës.

5.7.1 Modelimi i rrugëzimit

Përdorimi i gjeneratorit të topologjisë ofron mundësinë e përfimit të topologjive sa më afër me realitetin si dhe përbën një mjet praktik. Problemi qëndron në faktin se gjeneratorë si GT-ITM sigurojnë topologjinë e rrjetit por nuk mundësojnë modelimin e mënyrës se si paketat transmetohen në këtë rrjet. Për këtë arsye nevojitet që kjo pjesë të implementohet vetë nga përdoruesi.

Në rastin konkret, interesi bie mbi ruter-at që bëjnë të mundur komunikimin mes Sistemeve Autonome dheqë implementojnë protokollin e rrugëzimit BGP. Ajo që duhet modeluar është pikërisht mënyra se si këto rutera komunikojnë me njëri tjetrin përmes sesioneve eBGP, tabelat e rrugëzimit që ndërtojnë dhe mënyrën se si e shkëmbejnë informacionin.

Për fat të keq, BGP nuk ofron një modul të gatshëm për implementimin e BGP. Si rrjedhojë, duke ju referuar **Figura 4.3.3**, nevojitet të bëhen disa modifikime në kodin e ns2, në mënyrë që të instalohet moduli përkatës. Moduli i BGP për ns2, i njohur si ns-BGP, është përshtatur për ns2 në vitin 2004 [14] nisur nga modulet e BGP dhe TcpSocket nga SSFNet [26] dhe implementon versionin 4 të këtij protokollit (BGP-4). SSFNet është një simulator rrjeti i bazuar në Java që mundëson simulimet përmes një gjuhe konfigurimi të njohur si DML (*Domain Modeling Language*). Me që SSFNet është i bazuar në gjuhë Object Oriented, moduli i tij i BGP përbënte një pikë të mirë nisjeje për modulin e ns2.

Në ns2, rrugëzimi *unicast* arrihet duke përdorur planet e përcjelljes dhe të kontrollit. Plani i parë bën klasifikimin dhe përcjelljen e paketave në destinacion duke përdorur klasifikues dhe module rrugëzimi. Moduli i rrugëzimit manaxhon klasifikuesin e nyjes dhe ofron një ndërfaqe për planin e rrugëzimit. Klasifikuesit janë dy llojesh: klasifikues adrese dhe klasifikues porte. Klasifikuesi kontrollon adresën e paketës dhe e dërgon atë tek *dmux* nëse nyja është vetë destinacioni i paketës ose ja përcjell atë nyjes në vijim. *dmux* ja kalon paketën një egjenti në përputhje me portën destinacion të specifikuar. Ndërsa plani i dytë mundëson krijimin e rrugës, përpunimin, algoritmat e rrugëzimit dhe manaxhimin e tabelave të rrugëzimit. **Figura 5.2.3** ilustron strukturën unicast të ns-BGP bazuar në strukturën fillestare të unicast për ns2.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 5.9: *Struktura unicast e ns-BGP*

Siç tregohet në figurë, modulet e klasifikimit si klasifikuesit e portës dhe të adresës, i dërgojnë paketat hyrëse në agjentin respektiv ose në një link dalës. Këto module në vetvete manaxhohen nga moduli i rrugëzimit.

Plani i kontrollit përbëhet nga componentët në vijim: llogjika e rrugës, objekti rrugëzimit, pala e rrugës dhe protokollin e rrugëzimit. Tabela qëndrore e rrugëzimit mirëbahet nga llogjika e rrugëzimit ndërsa objektet rrugëzimit përdoren në simulimet me rrugëzim dinamik. Objektet e palës së rrugëzimit enkapsulojnë protokollin e rrugëzimit duke kapur dhe mbajtur atributet e çdo rruge të lajmëruar. Së fundmi, nga componentët e protokollit të rrugëzimit janë implementuar dhe disa algoritma specifike rrugëzimi.

Për më tepër, me që nyja BGP derivon nga një nyje unicast ns, **Figura 5.2.3** parqet dhe përfshirjen e moduleve specifike të BGP dhe TcpSocket. Moduli rtModule/BGP manaxhon objektin IPv4Classifier ndërsa protokollin e ri rtProto/BGP, është vendosur në modulet e TcpSocket për transmetimin e paketave.

Për çdo pale komunikimi BGP alokohet një objekt i përdorur për të vendosur lidhjen, shkëmbyer mesazhe BGP dhe mbyllur sesionin.

Katër klasa kyçe të përdorura në implementimin e BGP janë:

TcpSockets

Një socket është një *Application Programming Interface* (API) e përdorur në komunikimet në rrjet. Aplikacionet socket i trajtojnë lidhjet në rrjet si përshkrues

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

skedarësh në UNIX. Në mënyrë të ngjashme me skedarët, skajet e komunikimit mund të shkruhen duke ofruar mundësi leximi ose fshirjeje.

Klasa *TcpSocket* është shtuar si një implementim i API të socket, e ngjashme me implementimet në UNIX. Funkzionet kryesore të saj janë *bind*, *dëgjo*, *lidhu*, *mbyll*, *lexo*, dhe *shkruaj*.

IPv4Classifier

IPv4Classifier derivohet nga klasa *Classifier*. çështë e implementuar sin një klasë e dyfishtë në ns2 (në C++ dhe OTcL). Kjo klasë përdor atë *map* nga libraritë standard të modeleve të C++ për të ruajtur dhe kërkuar në tableën e rrugëzimit. Për të klasifikuar një paketë në hyrje *IPv4Classifier* kontrollon adresen e destinacionit të paketës dhe përdor informacionin në tableën e rrugëzimit për të identifikuar rrugën.

rtModule/BGP

rtModule/BGP, është një modul i ri rrugëzimi i implementuar në Tcl që ofron një ndërfaqe regjistrimi. Kur një nyje krijohet informacioni duhet të regjistrohet dhe objektet ekzistuese *classifier* në nyje duhen zëvendësuar.

rtProtoBGP

Klasa *rtProtoBGP* (*Agent/rtProto/BGP*) implementohet si klasë e dyfishtë në ns2. Një instancë e kësaj klase implementon BGP-4 në një nyje. Ky protokoll i ri rrugëzimi realizon pjesën më të madhe të veprimeve të BGP: vendosja e sesionit të komunikimit BGP mes palëve, mësimi i shtegjeve të ndryshëm përmes folësive BGP, përzgjedhja e rrugës më të mirë dhe ruajtja e saj në tabelë (*IPv4Classifier*), dhe manaxhimi i makinës së gjendjeve të BGP.

Përfundimisht mund të thuhet se ns-BGP është në përputhje me RFC 1771.

Ky modul ofron mundësinë e përcaktimit të timer-ave (kohëzuesave) të BGP si dhe mundësinë për të zbatuar reflektuesit e rrugëve.

5.7.2 Ndërtimi i modelit të të dhënave.

Tipi i modelit të trafikut që përdoret për të kuptuar rrjedhën e trafikut në një rrjet, dhe niveli i përafrimit me realitetin, përbëjnë parametra jetësorë për rrjetin.

Analizimi i trafikut siguron informacione të tipit ngarkesa mesatare, kërkesat për gjerësinë e brezit në aplikacione të ndryshme etj. Modelet e trafikut i ndihmojnë projektuesit e rrjetit që të bëjnë supozime mbi rrjetin bazuar në një eksperiencë të kaluar dhe gjithashtu parashikime të performancës në përputhje me kërkesa të së ardhmes.

Në këtë punim është synuar që të evidentohet ndikimi që kanë momentet e rifreskimit të BGP në aplikacionet real-time dhe specifikuat në atë VoIP.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Për fat të keq ns-2 nuk disponon një modul të gatshëm të integruar për VoIP. Një modul i përdorur i VoIP për ns2 është Ns2Voip++, implementuar në Universitetin e Pizës [12]. Për fat të keq ekziston shumë pak informacion mbi përdorimin e këtij moduli. Gjithashtu, në përputhje me dokumentacionin ekzistues, ky modul ofron mundësinë e vlerësimit të performancës së thirrjeve VoIP në nivel përdoruesi, çka shkon përtej qëllimit të këtij punimi.

Në rastin konkret është përzgjedhur mënyra më e thjeshtë për modelimin e një trafiku në kohë reale, nisur dhe nga skema e mëposhtme për trafikun VoIP.

Struktura e një moduli VoIP jepet më poshtë, si në **Figura 5.3**.




Figura 5.10: *Struktura e moduli të VoIP*

Në se do ta thjeshtonim këtë skemë, në nivel ns2, mund të themi semënyra më e thjeshtë për gjenerimin e trafikut VoIP është duke krijuar një agjent UDP të cilit i vihet në përkatësi trafik njëagjent në nivel aplikimi, CBR.

Për të përcaktuar parametrat e CBR përdoret **Tabela 5.3** e karakteristikave të koduesve të ndryshëm të VoIP.

Tabela 8: *Parametrat për koduesit e ndryshëm të VoIP*

Parameteat	G.711	G.723.1	G.729
Bit rate (Kbps)	64	6.3	8
Intervali mes frame (ms)	20	30	10
Sasia e të dhënave (Bytes)	160	24	10
Packeta/s, N_p	50	33	100

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Përfundimisht mund të dhemi së për qëllimet e këtij punimi trafiku VoIP modelohet sin jë rrjedhë të dhënash me një madhësi të caktuar pakëtë dhe rend transmetimi.

5.7.3 Gjendja e rrjetit dhe vlerësimi i performancës

Nisur nga diagram në **Figura 5.1**, pasi përcaktohet modeli i rrjetit dhe të dhënave, mund të përftojme gjendjen e rrjetit.

Ns2 është një simulator që varet nga koha dhe drejtohet nga ngjarjet. Për këtë arsye gjendja e rrjetit përftohet duke përcaktuar një moment fillimi dhe përfundimi të simulimeve, si dhe ngjarjet që do ndodhin në këtë kohë.

Në simulimet e këtij punimi është përzgjedhur që koha mesatare e ekzekutimit të një simulimi të jetë 80s. Simulimet fillojnë në çastin 0 dhe më pas zhvillohen me rradhë ngjarjet e ndryshme.

Grupi i parë i ngjarjeve është pikërisht shkëmbimi i informacionit të rrugëzimit mes nyjeve. Pasi nyjet shkëmbejnë informacionet me njëra-tjetrën, fillon transmetimi i trafikut CBR. Ky trafik do vazhdojë të dërgohet deri në përfundimin e kohës së simulimit.

Grupi i dytë i ngjarjeve është shfuqizimi dhe lajmërimi i vazhduesëm i një rruge tënjë ruteri. Kjo normalisht do të shoqërohet me një rifreskim të tabelave të rrugëzimit dhe do krijojë vonesa në rrjet si rrjedhojë e kohës së konvergencës të ruterave. Ky është dhe moment ku do të kontrollohen dy nga parametrat kryesorë të cilësisë: humbja e paketave dhe vonesat, pra realizohet vlerësimi i performancës.

5.7.4 Ndryshimet në model

Në mënyrë që të vlerësohet sa më saktë performanca, në përputhje me problemin e parashtruar, lind shpesh nevoja që disa nga parametrat e modeleve të ndryshohen.

Kjo nënkupton ndryshimin e numrit të nyjeve (simulimet fillestare kryhen gjithmonë me një numër shumë të kufizuar nyjesh në mënyrë që të testohen fillimisht skriptet e krijuara), skenarit të simulimit (psh. numrin e ngjarjeve dhe kohën e ekzekutimit të tyre), parametrat e koduesve etj.

5.8 Simulime dhe rezultate

Rezultatet e simulimit për arkitekturën e krijuar vlerësohen përmes skedarëve të ndryshëm që gjenerohen. Software i përdorur është Network Simulator version 2.34 (ns 3.34) mbi sistemin operativ Ubuntu 8.10.

5.8.1 Verifikimi i modelit të përzgjedhur të rrugëzimit

Për të verifikuar sjelljen e protokollit të implementuar të rrugëzimit kryhet një provë e thjeshtë me specifikimet në vijim.

Figura 5.11 tregon topologjinë e rrjetit të përdorur për simulim. Rrjeti përbëhet nga tre AS ku secila përfaqësohet nga një nyje: AS 0, AS 1, dhe AS 2 (nyjet 0,1 dhe 2 respektivisht). Adresa IP e çdo nyje tregohet në **Tabela 5.1**. Skema e adresimit është: 10.(AS nr).(numërnije).1.




Figura 5.11: Topologjia e rrjetit

Tabela 9 : Adresat IP

node 0 10.0.0.1	10.0.0.1
node 1 10.1.1.1	1 10.1.1.1
node 2 10.2.2.1	2 10.2.2.1

Agjentët BGP konfigurohen në secilën prej tre nyjeve (0, 1, dhe 2). Për nyjet 0 dhe dy vlerat e intervaleve të *hold timer* dhe *keep-alive timer* janë ato default të specifikuara në RFC 1771 [15] (*hold time*: 90 s, *keep-alive* : 30 s). Për të parë sjelljen në situatë rilidhjeje, intervali i *keep-alive timer* për agjentin BGP në nyjen 1 mbahet në vlerën 200 s. Në këtë mënyrë, agjenti BGP në nyjen 0 nuk do të marrë mesazhin “mbaje lidhjen gjallë” brenda kohës dhe do kërkojë rivendosjen e lidhjes.

Në 0.25 s agjenti BGP në nyjen 0 lajmëron një rrugë të re për adresën IP 10.0.0.0/24. Në 0.35 s, agjenti BGP në nyjen 1 lajmëron një rrugë të re për adresën IP 10.1.1.0/24. Në 0.45 s, agjenti BGP në nyjen 2 lajmëron një rrugë për adresën IP 10.2.2.0/24. Në 28 s, 90.38 s, dhe 119.0 s, ns2 tregon tabelat e rrugëzimit për agjentët BGP. Simulimi përfundon më 120.0 s. Skedari *tcl* për këtë simulim është bashkangjitur në **Shtojca 1**.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

koha: 28

dump routing tables in all BGP agents:

BGP routing table of node0

BGP table version is 10, local router ID is 10.0.0.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

**> 10.0.0.0/24 self - - -*

**> 10.1.1.0/24 10.1.1.1 - - - 1*

**> 10.2.2.0/24 10.2.2.1 - - - 2*

BGP routing table of node1

BGP table version is 16, local router ID is 10.1.1.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

**> 10.0.0.0/24 10.0.0.1 - - - 0*

**> 10.1.1.0/24 self - - -*

**> 10.2.2.0/24 10.0.0.1 - - - 0 2*

BGP routing table of node2

BGP table version is 10, local router ID is 10.2.2.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

**> 10.0.0.0/24 10.0.0.1 - - - 0*

**> 10.1.1.0/24 10.0.0.1 - - - 0 1*

**> 10.2.2.0/24 self - - -*

koha: 90.38

dump routing tables in all BGP agents:

BGP routing table of node0

BGP table version is 23, local router ID is 10.0.0.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

**> 10.0.0.0/24 self - - -*

**> 10.2.2.0/24 10.2.2.1 - - - 2*

BGP routing table of node1

BGP table version is 42, local router ID is 10.1.1.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

**> 10.1.1.0/24 self - - -*

BGP routing table of node2

BGP table version is 23, local router ID is 10.2.2.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

**> 10.0.0.0/24 10.0.0.1 - - - 0*

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

```
*> 10.2.2.0/24 self - - -
```

Koha: 119

dump routing tables in all BGP agents:

BGP routing table of node0

BGP table version is 30, local router ID is 10.0.0.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

```
*> 10.0.0.0/24 self - - -
```

```
*> 10.1.1.0/24 10.1.1.1 - - - 1
```

```
*> 10.2.2.0/24 10.2.2.1 - - - 2
```

BGP routing table of node1

BGP table version is 56, local router ID is 10.1.1.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

```
*> 10.0.0.0/24 10.0.0.1 - - - 0
```

```
*> 10.1.1.0/24 self - - -
```

```
*> 10.2.2.0/24 10.0.0.1 - - - 0 2
```

BGP routing table of node2

BGP table version is 30, local router ID is 10.2.2.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

```
*> 10.0.0.0/24 10.0.0.1 - - - 0
```

```
*> 10.1.1.0/24 10.0.0.1 - - - 0 1
```

```
*> 10.2.2.0/24 self - - -
```

Siç duket nga tabelat e rrugëzimit çdo agjent BGP mëson mbi agjentët e tjerë në sekondën e28-të. Në sekondën e 39.0 bie sesioni mes nyjes 0 dhe 1 dhe nyjet 0 dhe 2 e heqin rrugën për tek rrjeti 10.1.1.0/24 nga tabelat e tyre. Gjithashtu nyja 1 fshin rrugët që kishte për tek 0 dhe 2. Pasi rivendoset sesioni nyjet 0 dhe 1 shkëmbejnë gjithë informacionin që kishin në tabelat e rrugëzimit dhe konvergjojnë për herë të dytë. Ky testim verifikon korrektësinë e modelimit të protokollit të rrugëzimit.

5.8.2 Simulimi i topologjisë Stub-Domain me trafik CBR

Topologjia e përdorur në simulim jepet në figurën si më poshtë:

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 5.12: Topologjia e rrjetit sipas modelit stub-domain

Sic e kemi përmendur më sipër topologjia është gjeneruar përmes GT-ITM sipas modelit Transit-Stub të Internetit. Moduli i rrugëzimit nuk ofron shumë mundësi përshatjeje në rast numri të madh nyjesh dhe si rrjedhojë kemi zgjedhur opsionin e modelimit të një nëngrafi të Internetit.

Ky nëngraf përbëhet nga një *domein* tranzit që përbëhet nga katër nyje (rutera BGP) dhe nga 12 *domein* fundorë që modelohen me nga një ruter secili (përkufizimi për sistemin autonom përcakton se aim und të përbëhet nga 1 ose më shumë rutera).

Tabela 10 : Karakteristikat e grafit

Lloji i AS	Numri i AS	Numri i nyjeve	Nyjet
AS tranzit	1	4	0,1,2,3
AS fundorë	12	12	4,5,6,..15

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Kjo topologji gjenerohet nga skedari në hyrje të GT-ITM që është bashkëlidhur në **Shtojca 2**.

Në total kemi 16 nyje. Siç e tregon Tabela 6.2 domein tranzit është modeluar me 4 nyje që shkëmbejnë komunikimin BGP me njëra tjetrën. Të katërt këta janë ruterat kufitarë (edge). AS tranzit është e organizuar me një *cluster* dhe me dy reflektues rrugësh që janë nyjet 2 edhe 3. Kjo topologji gjenerohet nga skedari në hyrje të GT-ITM që është bashkëlidhur në **Shtojca 2**. Për AS fundor është zgjedhur llogjika e paraqitjes së tyre me nga një nyje. Kjo është në përputhje me përkufizimin që kemi thënë për AS i cili mund të përbëhet nga 1 ose më shumë nyje.

Skema e adresimit është përzgjedhur në trajtën 10.0.\$i.1 për ruterat brenda AS tranzit, ku \$i është numrin nyjes (0,1,2 apo 3) dhe 10.\$j.\$i.1 për ruterat në AS stub, ku \$j përkon me numrin e AS dhe \$i me numrin e nyjes (4,5..15).

Konfigurimi i rrjetit realizohet si më poshtë:

- Agjentët BGP konfigurohen në sejcilën prej nyjeve. Vlerat e intervaleve të *hold timer* dhe *keep-alive timer* janë ato default (*hold time*: 90 s, *keep-alive* : 30 s).
- Agjentët UDP konfigurohen në nyjet 0 (burimi) dhe 1 pusi. Trafiku nëpër këto dy nyje kalon përmes nyjes 2, sipas tabelave të ndërtuara të rrugëzimit.
- Trafiku CBR modelohet me këto karakteristika: *packetSize_ 160*, *interval_ 0.02* dhe *rate_ 64kb* sipas koduesit G.117 (referoju Tabela 4 dhe Shtojca 3).

Pasi bëhet konfigurimi i nyjeve, hapi pasues është përcaktimi i ngjarjeve të skeduluara. Në këtë simulim duam të shikojmë kohët e konvergencës të tre ruterave të përfshirë në komunikim që janë n15, n3 dhe n2. Ngjarjet skedulohen si më poshtë:

Në 5.0 fillon transmetohet trafiku CBR

Në 6.0 agjenti 15 tregon tabelën e rrugëzimit

Në 30.0 agjenti 3 tregon tabelën e rrugëzimit

Në 30.0 agjenti 2 tregon tabelën e rrugëzimit

Në 35.0 agjenti 15 lajmëron rënien e rrjetit 10.12.15.0/24"

Në 36.0 agjenti 15 tregon tabelën e rrugëzimit

Në 36.0 agjenti 3 tregon tabelën e rrugëzimit

Në 36.0 agjenti 2 tregon tabelën e rrugëzimit

Në 36.0 agjenti 15 network 10.12.15.0/24"

Në 55.0 agjenti 15 no-network 10.12.15.0/24"

Në 62.0 agjenti 3 tregon tabelën e rrugëzimit

Në 62.0 agjenti 2 tregon tabelën e rrugëzimit


Ngjarja e fundit është realizuar me synimin për të parë sjelljen e sistemit në një situatë kur një rrugë shfaqet dhe shkëputet vazhdimisht brenda një kohe të shkurtër (rute flapping).

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Në këtë mënyrë do të vërehet në se ka humbje apo vonesa në paketa gjatë momentit të rifreskimit të tabelave të rrugëzimit BGP.

5.8.3 Rezultatet e simulimit

Përmes ambientit vizual Nam, shohim që paketa e parë CBR gjenerohet në



sekondën 5.0:

Figura 5.13-a: Dërgohet paketa e parë CBR

Në sekondën 35.0 shohim që dërgohet informacioni për rënien e një rruge nga nyja 15.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 5.13-b: Dërgohet informacioni i rrugëzimit

Nyja 3 mëson për rënien e nyjes 15 dhe ia përcjell informacionin fqinjëve të saj:




Figura 5.13-c: Shpërndahet informacioni rrugëzimit

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Gjatë ekzekutimit në ekran na shfaqen të dhënat e mëposhtme për tabelat e rrugëzimit:

Nyja 2 lajmëron nyjen 13 për ndryshimet në rrugëzimit si në figurën më poshtë:




Figura 5.13-d: Shpërndahet informacioni rrugëzimit nga nyja 2

Ndërkohë tabelat e rrugëzimit në moment të ndryshme na paraqiten si më poshtë:

Koha: 30

BGP routing table of n3

BGP table version is 14, local router ID is 10.0.3.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

Network Next Hop Metric LocPrf Weight Path

```

10.0.0.0/24 self - - -
10.1.4.0/24 10.0.0.1/32 - - -1 i
10.2.5.0/24 10.0.0.1/32 - - -2 i
10.3.6.0/24 10.0.0.1/32 - - -3 i
10.4.7.0/24 10.0.0.1/32 - - -4 i

```

.....

```

10.10.13.0/24 10.0.2.1/32 - - -10 i
10.11.14.0/24 10.0.2.1/32 - - -11 i
10.12.15.0/24 10.12.15.1/32 - - -12

```

BGP routing table of n2

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

BGP table version is 12, local router ID is 10.0.2.1

*Status codes: * valid, > best, i - internal.*

<i>Network</i>	<i>Next Hop</i>	<i>Metric</i>	<i>LocPrf</i>	<i>Weight</i>	<i>Path</i>
<i>10.0.0.0/24</i>	<i>self</i>	-	-	-	
<i>10.1.4.0/24</i>	<i>10.0.0.1/32</i>	-	-	- 1	<i>i</i>
<i>10.2.5.0/24</i>	<i>10.0.0.1/32</i>	-	-	- 2	<i>i</i>
.....					
.....					
<i>10.10.13.0/24</i>	<i>10.10.13.1/32</i>	-	-	- 10	
<i>10.11.14.0/24</i>	<i>10.11.14.1/32</i>	-	-	- 11	
<i>10.12.15.0/24</i>	<i>10.0.3.1/32</i>	-	-	- 12	<i>i</i>

Nga këto të dhëna shohim se në sekondën e 30, agjentët 3 dhe 15 kanë konvergjuar dhe kanë një informacion të qartë për rrjetin.

Në sekondën 35 është lajmëruar rënia e rrjetit 10.12.15.0/24. Nyjet 2 dhe 3 e heqin rrugën për tek ky rrjet nga tabelat e rrugëzimit.

Në sekondën 36 rruga ngrihet prapë dhe nyjet 2 dhe 3 duhet të konvergjonin në sekondën 60 por në sekondën 55 rruga bie sërish. Nyja 15 e lajmëron përsëri rrjetin që rruga u ngrit. Të gjitha këto rënie dhe ngritje të shpeshta të rrugës shkaktojnë dërgim të shpeshtë paketash që nga ana e tyre konsumojnë gjerësinë e brezit dhe aftësitë përpunuese të nyjeve. Me që moduli i programuar nuk ka mekanizma për “route flap damping” rrjeti kalon në një gjendje divergjence që nuk arrin të zgjidhet brenda 80 sekondave të përzgjedhura për simulim.

Pas përfundimit të simulimeve elementi i parë që merret në konsideratë është numri i paketave të humbura para se të skedulohet ngjarja e paqëndrueshmërisë dhe pas skedulimit të kësaj ngjarjeje. Nga skedarët e regjistrimit del se në rastin kur simulimi kryhet pa praninë e ngjarjeve që shkaktojnë luhajtje të rrugës paketat e humbura janë në nivelin 776. Pasi ndodhin ngjarjet e përmendura më sipër ky numër shkon në 797. Kjo do të thotë se niveli i humbjeve në paketa është rritur me 21 brenda 100 sekondave të simulimit.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri




Figura 5.14: Humbjet në paketa

Përfundime

Një simulim mund të mendohet si një proces rrjedhes të entiteteve të rrjetit. Ns-2 [25] është një simulator i drejtuar nga ngjarjet që mundëson studimin e natyrës dinamike të rrjetave kompjuterike. Në këtë tezë është implementuar ns-BGP si një shtesë ndaj versionit të parafundit të simulatorit të rrjetit ns2-2.34. Duhet theksuar se mbi këtë shtesë është aplikuar një shtesë e dytë me emër *ns-2.34-bgp 2.0 fld mrai*. Kjo e fundit i shton funksionalitetin e *Route Flap Damping* si dhe *Adaptive Minimal Route Advertisement Interval*. Ns-2 është shkruar si në C++ ashtu edhe në OTcl dhe suporton modelet e orientuara nga objekti. C++ përdoret për implementimin në nivel të ulët të procesimit të orientuar të paketave, ku performanca është më e rëndësishmja. OTcl është një gjuhë skriptimi për implementim të një niveli të lartë, ku fleksibiliteti është më i rëndësishëm. Pas simulimit NS2 nxjerr rezultatet në format teksti ose të animuar. Për ti interpretuar këto të dhëna grafikisht janë krijuar mjete si NAM (Network Animator) dhe *XGraph*. Për të analizuar një sjellje të caktuar të rrjetit, përdoruesit mund të nxjerrin një nënbashkësi të të dhënave në format teksti dhe ti transformojnë ato në një format më të kuptueshëm. Për të rritur cilësinë e shërbimit (QoS), disa prej skedarëve janë modifikuar për të suportuar RFD. Kjo ndikon: 1) rrit stabilitetin dhe 2) rrit konvergjencën e rrjetit. Përdorimi i ns2 kalon nëpër disa hapa që nisnin fillimisht me identifikimin e problemit, vijon me ndërtimin e modelit të simulimit, kalon me modifikimin e ns2, pasohet nga ekzekutimi i simulimeve dhe përfundon me analizën e rezultateve. Në situatën tonë objektivi është të vihet në dukje se momentet e rifreskimit të BGP vërtet mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit të thirrjeve VoIP. Për të kapërcyer këtë problem, hallka vijuese është evidentimi i modelit të simulimit. Ky model, përfshin modelimin e topologjisë, trafikut, të dhënave dhe

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

skenarëve të simulimit. Secili nga këto modele mund të kërkojë implementimin e moduleve të reja në ns2. Pasi të jenë evidentuar modelet përkatëse dhe modifikimet e nevojshme për ns2 mund të kalohet në hallkën pausese që konsiston me realizimin e simulimeve që nënkupton krijimin e skedarëve përkatës tcl dhe ekzekutimin e tyre në ndërfaqen e ns2 përmes komandës ns <skedar.tcl>. Për të parë rezultatet e simulimit gjenerohen skedarë me prapashtesën .nam që ekzekutohen si një mjet grafik për vizualizimin e rezultateve të simulimit. Gjithashtu gjenerohen skedarët .tr (*trace file*) të cilët mundësojnë informacion më të plotë mbi simulimin.

Kapitulli VI

Realizimi dhe interpretimi i pyetësorit

6.1 Hyrje

Edhe kapitulli i gjashtë konsiderohet si një kapitull metodologjik. Pasi kemi shtjelluar në nivel teorik dhe në kuadrin eksperimental internetin, karakteristikat e tij, aplikacionet në kohë reale dhe protokollin BGP në vazhdimësi do të ndalemi në rastin konkret të një anketë të drejtuar përdoruesve të internetit nga të cilët janë marrë në shqyrtim studentët e UET dhe përjasjen që ata kanë ndaj cilësisë së shërbimit të internetit që ofrohet nga ISP-të në Shqipëri.

Nga të dhënat empirike të studimit të shtrirë në plotëaimin e anketave nga 524 studentë.

Analiza jep një studim të lidhjes mes variablave të varur e atyre të pavarur që janë respektivisht cilësia e shërbimit dhe teknologjia, shërbimi ndaj klientit e kompania shpërndarëse e internetit.

Dimë që anketat ndahen në dy kategori:

Në anketa përgjigjet e të cilave janë numra dhe në anketa përgjigjet e të cilave janë fjalë.

Në tipin e dytë ku përgjigjet janë fjalë bën pjesë dhe anketa jonë. Në këtë rast variablat konsiderohen variabla kategorikë dhe duke qenë se i përkasin këtij tipi mund të analizohen tre çështje sikurse janë:

1-numri i elementeve që përfshin frekuencën e përgjigjeve për një kategori të caktuar

2-përqindja që shpreh numrin e elementeve të pikës paraardhëse

3-grafikët përkatës që pasqyrojnë këto përgjigje


Nisur nga këto rezultate jemi në gjendje të përcaktojmë dhe variablat e kushtëzuar nëse janë apo jo të pranishëm si edhe të gjykojmë mbi prezencën e pavarësisë midis variablave, pra a ndikon një variabël në një tjetër apo jo.

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Rezultatet e pyetësorit i kemi si më poshtë ku japim një tablo të përgjithshme të rezultateve të përfuara duke sjellë te tre pikat shtjelluese për këto variabla si dhe kalojmë më pas në nivelin e dytë ku bëjmë një përballje të të dhënave të marra nga dy ekstremitetet e qëndrimeve të përdoruesve kundrejt QoS së internetit në Shqipëri.

Në lidhje me pyetjet e parastruara kemi si në vijim përmbledhjet:

1-Si ndiheni me shërbimin e ISP tuaj si ofrues interneti?



Pra përgjigjet respektive në këtë rast do të qenë:

Tabela ,11

Kategoria	Përqindje	Niveli
Shkelqyer	5.95%	31
Shume mire	36.28%	189
Kenaqshem	46.64%	243
I/e pakenaqur	11.13%	58
Total		521

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri


Këtu shohim që përdoruesit në pjesën më të madhe janë mesatarisht të kënaqur nga ofruesit e tyre të shërbimit të internetit. Pra nga 524 përdorues interneti 243 ishin mesatarisht të kënaqur duke përbërë kështu edhe 46.64% të përdoruesve.

Në vazhdim përdoruesat e internetit për nga përqindja e lartë e përgjigjeve janë shprehur shumë të kënaqur duke përbërë kështu edhe 36.28% të përdoruesve, pra në total 189 përdorues.

Të pakënaqur vërejmë që kemi 11.13% të përdoruesve pra e shprehur në numër total janë 58 përdorues interneti nga 524 në total.

Nga ana tjetër më të paktë kanë qenë ata që kanë qenë maksimalisht të kënaqur duke përbërë 5.95% të përdoruesve dhe e shprehur në numër janë 31 përdorues.

2-Si do ta kategorizonit ISP-në tuaj në bazë të (besueshmërisë, shpejtësisë, shkeputjeve të sinjalit)?



Pra përgjigjet respektive në këtë rast do të qenë:

Tabela.12

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Shkelqyer	3.29%	17
Shume mire	29.40%	152
Kenaqshem	49.90%	258
I/e pakenaqur	17.41%	90
Total		517


Këtu shohim që përdoruesit në pjesën më të madhe janë mesatarisht të kënaqur nga cilësia e tyre e internetit. Pra nga 524 përdorues interneti 258 ishin mesatarisht të kënaqur duke përbërë kështu edhe 49.90% të përdoruesve pra gati gjysma e përdoruesve.

Në vijim përdoruesat e internetit për nga përqindja e lartë e përgjigjeve janë shprehur shumë të kënaqur duke përbërë kështu edhe 29.40% të përdoruesve, pra 152 përdorues.

Të pakënaqur vërejmë që kemi 17.41% të përdoruesve pra e shprehur në total janë 90 përdorues interneti nga 524 të anketuar.

Nga ana tjetër më të paktë kanë qenë ata që kanë qenë maksimalisht të kënaqur duke përbërë 3.29% të përdoruesve dhe e shprehur në numër janë 17 përdorues.

3-Si do ta vlerësonit software-in e instalimit si lehtësi në montim dhe në përdorim?



Pra përgjigjet respektive në këtë rast do të qenë:

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Tabela .13

Shkelqyer	10.96%	56
Shume mire	44.03%	225
Kenaqshem	42.27%	216
I/e pakënaqur	2.74%	14
Total		511

Këtu shohim që përdoruesit në pjesën më të madhe janë mesatarisht të kënaqur nga teknologjia e internetit. Pra nga 524 përdorues interneti 225 ishin mesatarisht të kënaqur duke përbërë kështu edhe 44.03% të përdoruesve të anketuar.


Në vijim përdoruesat e internetit për nga përqindja e lartë e përgjigjeve janë shprehur shumë të kënaqur duke përbërë kështu edhe 42.27% të përdoruesve, pra 216 përdorues.

Nga ana tjetër ata që kanë qenë maksimalisht të kënaqur duke përbërë 10.94% të përdoruesve dhe e shprehur në numër janë 56 përdorues.

Përgjigjet më të pakta janë për përdoruesit të pakënaqur e vërejmë që kemi 2.74% të përdoruesve pra e shprehur në total janë 14 përdorues interneti nga 524 të anketuar.

4-Në lidhje me operatorët e shërbimit të klientit, si do ti vlerësonit?

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri



Pra përgjigjet respektive në këtë rast do të qenë:

Tabela .14

Kategoria	Përqindje	Numër
Plotesisht te gatshem	41.65%	207
Mjaftueshem te gatshem	56.54%	281
Indiferent	1.81%	9
Total		497


Përsa i përket shërbimit ndaj klientit dhe konkretisht gatishmërisë për të ardhur në ndihmë përdoruesve shohim që përdoruesit në pjesën më të madhe janë mjaftueshëm të kënaqur nga cilësia e tyre. Pra nga 524 përdorues interneti 281 ishin mesatarisht të kënaqur duke përbërë kështu edhe 56.54% të përdoruesve

Në vazhdim të analizës së përgjigjeve shohim se përdoruesat e internetit janë shprehur plotësisht të kënaqur duke përbërë kështu edhe 41.65% të përdoruesve, pra 207 përdorues.

Të pakënaqur vërejmë që kemi 1.81% të përdoruesve pra e shprehur në total janë 9 përdorues interneti nga 524 të anketuar pra një numër shumë i vogël.

5-Sa profesionalë do t'i vlerësonit operatorët e shërbimit ndaj klientit?

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri



Pra përgjigjet respektive në këtë rast do të qenë:

Tabela.15

Shume profesionale	32.16%	164
Mjaftueshem profesionale	66.67%	340
Aspak profesionale	1.18%	6
Total		510


Në lidhje me profesionalizmin e operatorëve të shërbimit ndaj klientit shohim që përdoruesit në pjesën më të madhe janë mesatarisht të kënaqur nga cilësia e tyre e internetit. Pra nga 524 përdorues interneti 340 ishin mesatarisht të kënaqur duke përbërë kështu edhe 66.67% të përdoruesve..

Në vijim përdoruesat e internetit për nga përqindja e lartë e përgjigjeve janë shprehur shumë të kënaqur duke përbërë kështu edhe 32.16% të përdoruesve, pra 164 përdorues.

Të pakënaqur vërejmë që kemi 1.18% të përdoruesve pra e shprehur në total janë 6 përdorues interneti nga 524 të anketuar.

6- U zgjidh problemi juaj pas telefonatës me operatorin e shërbimit?

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri



Pra përgjigjet respektive në këtë rast do të qenë:

Tabela.16


Po	90.76%	452
Jo	9.24%	46
Total		498

Në vazhdim pyetja pasuese konsiston në lidhje me gjendjen e problemit pas telefonatës me operatorin e shërbimit dhe gati pjesa më e madhe u përgjigj pozitivisht pra 90.76% treguan se problemi i tyre mori zgjidhje duke përbërë kështu rreth 452 të anketuar.

Nga ana tjetër shumë më të paktë në numër janë ata, përgjigjja e të cilëve ishte negative duke dëshmuar se nuk kishin gjetur zgjidhje të problemit të ndeshur dhe ishin pikërisht 9.24% e të anketuarve, pra 46 prej tyre.

7-Krahasuar me teknikët e ISP-ve të mëparshme që keni pasur kontratë shërbimi është më cilësor apo jo?

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri



Pra përgjigjet respektive në këtë rast do të qenë:


Tabela.17

Po	73.58%	362
Jo	26.42%	130
Total		492

Në vazhdim pyetja pasuese e pyetësorit lidhet me krahasimin midis teknikëve të ISP-ve të mëparshme dhe atyre aktualë nëse e kanë përmirësuar shërbimin apo jo dhe pozitivisht janë përgjigjur 73.58% pra 362 përdorues nga 524 të tillë. Negativisht, ndërkaq janë përgjigjur 26.42% e përdoruesve që do të thotë 130 prej tyre.

8-Cilën ISP keni zgjedhur për tu ofruar internet në ambientet tuaja?

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri



Pra përgjigjet respektive në këtë rast do të qenë:

Tabela.18

Vodafone	9.47%	48
AMC	2.17%	11
ABcom	21.10%	107
Abissnet	10.65%	54
Tring	13.02%	66
Adanet	1.58%	8
tjeter	42.01%	213
Total		507

Së fundmi në lidhje me kategoritë e ISP-ve të përzgjedhura për ofrim të shërbimit të internetit përdoruesit janë përgjigjur kryesisht për ISP të tjera të papërfshira në listë

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

(sikurse Albtelecom etj) duke përbërë kështu rreth 42.01% të përgjigjeve të të anketuarve pra 213 përdorues në total nga 524.

Në vazhdim për nga renditja e përgjigjeve 21.10% e përdoruesve kishin zgjedhur si ISP operatorin ABCOM duke përfshirë 107 përdorues.

Në vijim përdoruesit më së shumti kanë zgjedhur shërbimin e internetit nga operatori Tring duke përbërë 13.02% të përdoruesve e shprehur në vlerë numerike 66 përdorues.

Operatori Abissnet mban një kuotë përgjigjesh të të anketuarve prej 10.65% ose 54 përdorues nga 524 në total.

Nga ana tjetër operatori Vodafone përfshin 9.47% të përgjigjeve të të anketuarve, pra 48 përdorues në total nga 524 të tillë duke u pasuar nga operatori Amc me 2.17% të përgjigjeve të të anketuarve që i korrespondojnë 11 përdorues.

Së fundmi me më pak të abonuar qëndron operatori Adanet me 1.58% pra 8 përdorues nga 524 në total.

6.2. Analiza e përgjigjeve për rastin e përdoruesve të cilët e konsiderojnë QoS maksimale në Shqipëri.

Tabela.19

Si ndiheni me shërbimin e ISP tuaj si ofruer interneti?	Si do ta kategorizonit ISP-ne tuaj në baze të (besueshmërisë, shpejtësisë, shkeputjeve të sinjalit)?	Si do ta vlerësonit software-in e instalimit si lehtësi në montim dhe në përdorim?	Ne lidhje me operatorët e shërbimit të klientit, si do ti vlerësonit ?	Sa profesional do ti vlerësonit operatorët e shërbimit ndaj klientit	U zgjidh problemi juaj pas telefonates me operatorin e shërbimit?	Krahasuar me teknikat e ISP-ve të mëparshme që keni pasur kontrate shërbimi është me cilësor apo jo?	Cilen ISP keni zgjedhur për tu ofruar internet në ambientet tuaja?
Shkëlqyer	Shumë mire	Shumë mire	Plotësisht të gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	ABcom
Shkëlqyer	Shumë mire	Shkëlqyer	Plotësisht të gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	ABcom
Shkëlqyer	Shumë mire	Shumë mire	Plotësisht të gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	ABcom
Shkëlqyer	Shumë mire	Shkëlqyer	Plotësisht të gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	Tring
Shkëlqyer	Shumë mire	Shkëlqyer	Plotësisht të gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	Vodafone
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht të gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	Vodafone
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht të gatshëm	Shumë profesionalë		Po	ABcom
Shkëlqyer	Shumë mire	Shkëlqyer	Plotësisht të gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	Vodafone
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht të gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	tjetër

Studimi i trafikut interdomain bazuar në protokollin BGP, rast studimor në Shqipëri

Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht te gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	ABcom
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht te gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	tjetër
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht te gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	tjetër
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht te gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	ABcom
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht te gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	Vodafone
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shumë mire	Plotësisht te gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	ABcom
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht te gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	Vodafone
Shkëlqyer	Shkëlqyer	Shkëlqyer	Plotësisht te gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	ABcom
Shkëlqyer	Shumë mire	Shumë mire	Mjaftueshëm te gatshëm	Mjaftueshëm profesionalë	Po	Po	Vodafone
Shkëlqyer	Kënaqshëm	Shkëlqyer	Plotësisht te gatshëm	Shumë profesionalë	Po	Po	Tring
